

**AGJENCIA KOMBETARE E ARSIMIT DHE FORMIMIT
PROFESIONAL**

**Sektori i Skeletkurikulave dhe Standardeve të
Trajnimit të Mësuesve të Arsimit dhe Formimit Profesional**

BROSHURE INFORMATIVE

Nr. 1

Tiranë, 2009

Përmbajtja

Hyrje

Pjesa e parë:

Materiale që i referohen aspekteve të kurikulave të Arsimit dhe Formimit Profesional
Raport për "Monitorimin e zbatimit të Kurikulave të AFP - Modeli i CARDS"
Raport i Studimit "Modelet Kurikulare të AFP në botë".
Raport i Studimit "Gjendja e Kurikulave të AFP publik në Shqipëri"
Propozim për një model unik të Kurikulave të AFP publik në Shqipëri
Propozim për krijimin e Departamenteve Mësimore në Shkollat Profesionale

Pjesa e dytë:

Materiale që i referohen aspekteve të trajnimit të mësuesve të AP në lidhje me skeletkurikulat e reja të Arsimit dhe Profesional
Programi i Trajnimit: Hartimi i kurikutit shkollor në Arsimin profesional
Zhvillimet e Arsimit të mesëm Profesional dhe Teknik, objektivat dhe reformimi
Hartimi i elementeve të kurikutit shkollor në AP
Struktura e Programit të detajuar të lëndës profesionale, për nivelin shkollor (shembull)
Struktura e Planit të mësimdhënies së modulit, për nivelin shkollor (shembull)
Udhëzues përmbushjeje për hartimin e Programit të detajuar të lëndës profesionale
Udhëzues përmbushjeje për hartimin e Planit të mësimdhënies së modulit profesional
Zhvillimi i materialeve mësimore për modulet e praktikës profesionale

HYRJE

Kjo “Broshurë informative“ botohet nga Sektori i Skeletkurikulave dhe Standardeve të Trajnimit të Mësuesve të AFP-së (SSTM), në Agjencinë Kombëtare të AFP-së dhe është botimi i parë i serisë së broshurave informative që do të botojë ky sektor në vijim të punës së tij në mbështetje të zhvillimeve reformuese të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) në Shqipëri.

Broshura përmban kryesisht materiale pune të Sektorit të SSTM, por edhe materiale të tjera që i referohen funksioneve dhe veprimtarisë së këtij sektori. Këto materiale janë grupuar në dy pjesë kryesore:

- (i) materiale që i referohen aspekteve kurikulare të AFP-së,
- (ii) materiale që i referohen aspekteve të trajnimit të personelit të AFP-së.

“Broshura informative Nr. 1“ e Sektorit të SSTM, si dhe broshurat e tjera informative në vazhdim, do t’i shërbejnë një game të gjerë aktorësh të angazhuar në zhvillimet e AFP-së në Shqipëri, kryesisht mësuesve dhe instruktorëve të AFP-së, por edhe specialistëve të tjerë të AFP-së (në dikasteret përgjegjës për AFP-në, në Agjencinë Kombëtare të AFP-së, në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, në Drejtoritë dhe Zyrat Arsimore, në shkollat profesionale dhe qendrat e formimit profesional, publike dhe private, në organizatat dhe në projektet e ndryshme zhvillimore, etj.).

Seria e Broshurave informative të Sektorit të SSTM në Agjencinë Kombëtare të AFP-së do të vazhdojë të ofrojë materiale të ndryshme referuar kryesisht aspekteve kurikulare dhe të trajnimit të personelit të AFP-së, por edhe aspekteve të tjera të reformës së AFP-së në Shqipëri. Pavarësisht se aty do të përmbliidhen kryesisht punime të vetë këtij Sektori, të gjithë të interesuarit janë të ftuar të kontribuojnë me materiale të ndryshme për reformën e AFP-së, si dhe me komente e propozime për përmirësimin e kësaj serie botimesh.

Përgjegjësi i Sektorit të SSTM

Alqi Mustafai

Pjesa e parë

**Materiale që i referohen aspekteve të kurikulave të
Arsimit dhe Formimit Profesional**

RAPORT PËR

“Monitorimin e zbatimit të Kurikulave të AFP – Modeli i CARDS”

Nëntor 2007

Sektori i SSTM

Monitorimi i zbatimit të kurikulave të AFP-së (modeli i CARDS) u krye nga Sektori i Skeletkurikulave dhe Standardeve të Trajnimit të Mësuesve të AFP-së, në përputhje me Platformën e monitorimit të miratuar nga Drejtoria e AKAFP-së.

1. Informacion i përgjithshëm për monitorimin

Qëllimi i monitorimit: Të analizojë ecurinë e zbatimit të kurikulave të AFP-së (modeli i CARDS) dhe të ofrojë argumente për përmirësime të mundshme.

Grupi që realizoi monitorimin:

Drejtues i grupit: Alqi Mustafai

Anëtarë të grupit: Albina Buci, Edlira Popa dhe Marsela Robo.

Kohëzgjatja e kryerjes së monitorimit: Shtator – Nëntor 2007

Metodologjia/hapat e monitorimit:

- Përcaktimi i procedurës për të kryer monitorimin (*shih Aneksin 1-Platforma e monitorimit*)
- Hartimi i Planit të monitorimit: (përcaktimi i shkollave/qendrave ku zbatohet modeli kurikular i CARDS, përzgjedhja e ofruesve që do të monitorohen, përcaktimi i datave për vizitat e monitorimit dhe i monitoruesve).
- Ndërtimi i instrumenteve të monitorimit (përcaktimi i kategorive të personave që do të monitorohen për zbatimin e kurikutit, konceptimi dhe përgatitja e instrumenteve të monitorimit për secilën kategori).
- Mbledhja e informacionit për monitorimin (kryerja e vizitave të ofruesit të AFP-së dhe intervistimi i kategorive të personave të përfshirë në monitorim, konsultimi i dokumentacionit kurikular).
- Përpunimi i informacionit të mbledhur (analiza dhe sistemimi i informacionit të mbledhur nga pyetësorët, konsultimi i dokumentacionit kurikular dhe burime të tjera).
- Përgatitja e Raportit të monitorimit.
- Prezantimi dhe diskutimi i rezultateve të monitorimit me stafin e AKAFP-së dhe të interesuar të tjerë.

Ofruesit e AFP të përfshirë në monitorim:

1. Shkolla e Ndërtimit “Karl Gega”, Tiranë – Profili “Ndërtues, 3+2 vjeçar”.
2. Shkolla Teknike Pyjore “Kolë Margjini”, Shkodër – Profili “Përpunues druri, 3+2 vjeçar”.
3. Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional (DRFP), Korçë – Kursi “Mobilieri”.

Shënime:

- Përgatitja e Planit të monitorimit dhe e Instrumenteve të monitorimit u krye në bashkëpunim me ekspertin e CARDS, Zj. Lise Wichmann-Hansen).
- Pjesa e kulturës së përgjithshme të kualifikimeve profesionale të monitoruara, nuk ka qenë subjekt i procesit të monitorimit.

2. Rezultatet e monitorimit.

Bazuar në analizën e informacionit të mbledhur në kuadrin e monitorimit të zbatimit të kurikulave pilot sipas modelit të CARDS në ofruesit e AFP të renditur në sipër, grupi monitorues paraqet **rezultatet** sipas rubrikave të mëposhtme:

a) Rezultate që kanë të bëjnë me aspekte të përgjithshme të ofruesve të AFP të monitoruar:

Kurikuli i ri sipas modelit të Programit CARDS ka rreth dy vite që ka filluar të zbatohet në ofruesit e AFP të monitoruar. Rreth 35% e nxënësve në 2 shkollat profesionale të monitoruara i nënshtrohen procesit mësimor me kurikulin e ri (në profilet “Ndërtues” dhe “Përpunues druri”), ndërsa në DRFP-në e monitoruar, ishin realizuar 3 kurse me rreth 10 pjesëmarrës secili, për “Mobilier” sipas kurikullit të ri.

Mësuesit dhe instruktorët që zbatojnë këtë kurikul, përgjithësisht janë të familjarizuar me të, veçanërisht ata që janë përfshirë dhe në procesin e hartimit të kurikullit në nivel qendror. Përveç mbështetjes direkt nga ekspertët lokalë të CARDS, këta mësimdhënës janë trajnuar nga Programi CARDS për metodologjinë e hartimit dhe zbatimit të kurikulave shkollore. Mësimdhënësit e tjerë, të cilët nuk janë përfshirë në procesin e zërthimit të kurikullit, janë informuar për këtë model nga kolegë dhe drejtorja e shkollës ose qendrës përkatëse. I njëjti konkluzion mund të thuhet edhe për stafet drejtuese të këtyre ofruesve të AFP-së të monitoruar (një pjesë e tyre ishin përfshirë dhe në procesin e hartimit të kurikulave në nivel qendror).

Shkalla e realizimit të praktikave profesionale ishte e ndryshme: në profilin “Ndërtues” mundësia e realizimit të praktikave ishte rreth 40%, dhe kjo vetëm në poligonin e shkollës, ndërsa në profilin “Përpunues druri” dhe kursin “Mobilieri”, kjo shkonte deri në 100% dhe kryhej kryesisht në ndërmarrje.

Nxënësit e shkollave profesionale të monitoruara e kanë marrë informacionin në lidhje me këto shkolla dhe ofertat e tyre (për profilet që zbatojnë kurikulin e ri) kryesisht nga prindërit, rrethi familjar dhe shoqëror i tyre, si dhe nga nxënësit e klasave më të larta. Ata mendojnë se përzgjedhja e këtyre profileve do tu mundësojë punësim të garantuar si dhe arsimim të lartë në të njëjtin profil. Ndërsa kursantët e DRFP-së janë informuar kryesisht nga Zyra Rajonale e Punës por edhe nga burime të tjera, si dhe mendojnë që kryerja e kursit do tu rritë shanset për punësim.

b) Rezultate që kanë të bëjnë me aspekte strukturore të kurikulave të monitoruara.

Nga informacioni i mbledhur gjatë monitorimit si dhe nga analiza e dokumentacionit kurikular rezultoi se:

- o Nga pikëpamja e natyrës së organizimit të përmbajtjes, zbatohen dy modele strukturore kurikulare:
 - (a) **I kombinuar** (modular dhe lëndor), që zbatohet në shkollat profesionale;
 - (b) **Modular**, që zbatohet në DRFP-të.

- Nga pikëpamja e niveleve të përgjegjëse në procesin kurikular, zbatohen kurikula dynivelëshe:
 - (a) Kurikula të **nivelit qendror**;
 - (b) Kurikula në **nivel shkolle dhe qendre**.
- Nga pikëpamja e elementeve ndërtimore, modeli kurikular i kombinuar, paraqitet i ndërtuar nga elementet e mëposhtme:
 - **Skeletkurikuli** (në nivel qendror), i referohet tri niveleve të kualifikimit (ndihmës, punëtor i kualifikuar, teknik) dhe përbëhet nga këto rubrika kryesore: qëllimet e përgjithshme të kualifikimit profesional për të tri nivelet e kualifikimit, profili profesional i kualifikimit për të tri nivelet e kualifikimit (karakteristikat kryesore të nxënësve në mbarim të secilit nivel kualifikimi, pozicioni i kualifikimit në sistemin arsimor, mundësitë e punësimit dhe kualifikimit të mëtejshëm), kërkesat e përgjithshme të pranimit sipas niveleve, të dhëna për kohëzgjatjen dhe shpërndarjen kohore sipas niveleve (struktura e viteve shkollore dhe afatet, shpërndarja kohore gjatë vitit, struktura e vitit shkollor në javë), kriteret për vlerësimin dhe provimet sipas niveleve, llojet e certifikatave që fitohen në kualifikimin profesional sipas niveleve, plani mësimor për kualifikimin përkatës, synimet dhe përmbajtjet e përgjithshme të lëndëve të përgjithshme profesionale, përshkruesit e moduleve teorike-praktike, udhëzime të përgjithshme didaktike për të tri nivelet.
 - **Kurikuli shkollor** (në nivel shkollor), që përbëhet nga: programet analitike për çdo lëndë (synimet e përgjithshme të lëndës, temat mësimore, çështjet mësimore, objektivat mësimore, metodat e të mësuarit, instrumentet e vlerësimit dhe bazën materiale të nevojshme për çdo temë), si dhe nga planet e instruksionit për çdo përshkrues moduli (titulli i modulit, kohëzgjatja e modulit, rezultatet e të mësuarit (RM), si dhe kohëzgjatja, çështjet mësimore, veprimtaritë mësimore, vendi i realizimit dhe baza materiale e nevojshme për çdo RM.
- Nga pikëpamja e elementeve ndërtimore, modeli kurikular modular, paraqitet i ndërtuar nga elementet e mëposhtme:
 - **Programi i kursit** (në nivel qendror), i referohet shkallëve të kualifikimit (1 - 3 shkallë) dhe përbëhet nga këto rubrika kryesore: argumentimi i hapjes së kursit, grupi që do të përfshihet në kursin përkatës, profili profesional i kursantit në mbarim të kursit (karakteristikat kryesore, mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e tij), objektiva të përgjithshme të kursit, kohëzgjatja e kursit, kriteret e pranimit, informacion për modulet e kursit (lista e moduleve, kodet, kohëzgjatjet dhe rezultatet mësimore për çdo modul), radha e trajtimit të moduleve, vlerësimi dhe certifikimi. Programi i kursit përmban gjithashtu edhe përshkruesit e moduleve. Një përshkrues moduli përmban: titullin dhe kodin, qëllimin, kohëzgjatjen dhe raportet kohore të veprimtarive, kërkesat e pranimit, RM-të, përmbajtjet dhe procedurat e vlerësimit për çdo RM, metodat e rekomanduara të të mësuarit dhe bazën materiale të domosdoshme.
 - **Planet e instruksionit** (në nivel qendre formimi), për secilin modul, që përbëhen nga: titulli i modulit, kohëzgjatja e modulit (në kredite dhe orë mësimore), rezultatet e të mësuarit (RM), orët për çdo RM, çështjet mësimore për çdo RM, veprimtaritë mësimore për çdo çështje, vendin e realizimit dhe bazën materiale e nevojshme për çdo RM.

Nga analiza e dokumentacionit kurikular, vihet re që përshkruesit e moduleve kanë të njëjtin format si për shkollat profesionale ashtu edhe për DRFP-të. Vihet re, gjithashtu, që ka një mungesë vazhdimësie në paraqitjen e RM-ve (dhe përmbajtjeve të tyre) me Procedurat përkatëse të vlerësimit (instrumentet e vlerësimit dhe kriteret e realizimit).

c) **Rezultate që kanë të bëjnë me aspekte metodologjike të zbatimit të kurikulave të monitoruara.**

Gjatë monitorimit u mblodh informacion vetëm për metodologjinë e zbërthimit të kurikulave qendrore në kurikula shkollë/qendre dhe zbatimit të tyre në procesin mësimor.

Në shkollat profesionale:

- Përgjithësisht, vihet re punë në grupe në nivel shkollë (mësuesit dhe instruktorët hartojnë së bashku programet shkollë dhe planet e instruksionit). Në ndonjë rast vihet re që mësuesit ose instruktorët i jepet program/plan instruksioni “i gatshëm”, i hartuar nga ekspertët lokalë të CARDS.
- Fillimisht, procesi i hartimit të kurikut shkollë është drejtuar nga ekspertët lokalë të CARDS dhe drejtuesit e grupeve në shkollë, të cilët ndanin përgjegjësitë, jepnin detyrat dhe monitoronin zbatimin e tyre.
- Nuk kishte evidencë të përfshirjes së përfaqësuesve nga bota e punës në procesin e hartimit të kurikulave shkollë.
- Gjatë këtij procesi, analizohej skeletkurikuli përkatës dhe konsideroheshin edhe faktorë të tjerë, si kushtet konkrete të shkollës dhe drejtimet e zhvillimit rajonal.
- Draftet fillestare të programeve shkollë dhe planeve të instruksionit ishin objekt i diskutimit në grup, deri në përgatitjen e dokumenteve përfundimtare.
- Programet shkollë dhe planet e instruksionit miratoheshin nga “kryetari i komisionit të kurikut” dhe drejtori i shkollës.
- Nuk ka një metodologji “unike” për hartimin e kurikulave në nivel shkollë/qendre.
- Në mbledhjet e rregullta të stafit mësimdhënës dhe të departamenteve lëndore, janë trajtuar edhe probleme të zbatimit të kurikut në shkollë.
- Shkollat ruajnë në version elektronik të gjitha programet shkollë dhe planet e instruksionit, të cilat mund të rishikoheshin kur të shihej e nevojshme (zakonisht në fillim të vitit shkollor).
- Përgjithësisht, vihet re një ndarje e dukshme midis mësimeve të teorisë profesionale dhe atyre të praktikave profesionale (instructorëve). Pasojat negative të kësaj ndarjeje ishin më të dukshme në rastin e zbatimit të moduleve teoriko-praktike.
- Në ndonjë rast, mësues ose instruktorë të veçantë vazhdonin të përdornin programet tradicionale (tematike) me të cilat ishin të familjarizuar prej vitesh.
- Për shkak të kërkesave të inspektorëve të DAR-ve përkatëse, paralelisht me hartimin e programeve shkollë dhe planeve të instruksionit sipas modelit të CARDS, shumë mësues dhe instruktorë hartonin “plane mësimore” sipas formatit të kërkuar prej tyre.

Në DRFP-të:

Në vija të përgjithshme, pavarësisht nga ndryshimet strukturore të formateve kurikulare, nga pikëpamja e procedurave të ndjekura, formave të veprimit dhe përgjegjësi, ka mjaft ngjashmëri me përshkrimet e mësipërme për shkollat profesionale. Vihet re që, për shkak të numrit të vogël të instruktorëve të DRFP për një kurs të dhënë, në procesin kurikular janë përfshirë dhe instruktorë të DRFP-ve të tjera, në rolin e konsulentëve. Trajtimi i një moduli të caktuar bëhet nga i njëjti instruktor (për pjesët teorike dhe praktike njëkohësisht).

d) Rezultate që kanë të bëjnë me aspekte të përgjegjësi në lidhje me zbatimin e kurikulave të monitoruara.

Përsa i përket aspekteve kurikulare, në shkollat profesionale dhe DRFP ka ndarje të detyrave dhe përgjegjësi, si më poshtë:

- Drejtoritë zakonisht mbajnë (në version elektronik dhe të printuar) të gjithë dokumentacionin kurikular të miratuar (skeletkurikulin, programet shkollore, programet e kurseve dhe planet e instruksionit). Ka raste kur këto dokumente zotërohen edhe nga kryetarët e komisioneve të kurikulave (drejtuesit e departamenteve mësimore në DRFP).
- Drejtorët e shkollave dhe qendrave miratojnë dokumentet kurikulare të nivelit të shkollës/qendrës. Njëkohësisht ata ndjekin ecurinë e zbatimit të kurikulit.
- Kryetarët e komisioneve të kurikulave në shkolla dhe DRFP (në kuadrin e pilotimit) janë përgjegjës për drejtimin e procesit të hartimit të kurikulave në nivel shkolle/qendre, si dhe për miratimin e tyre, së bashku me drejtorin.
- Mësuesit dhe instruktorët (në kuadrin e “komisioneve të kurikulave” ose të “bërthamave shkencore”) janë përgjegjës për hartimin e programeve shkollore dhe planeve të instruksionit, duke bashkëpunuar edhe me mësuesit dhe instruktorët e tjerë, si dhe për zbatimin e tyre në procesin mësimor.
- Në kuadrin e Programit CARDS, në procesin kurikular të përmendur më lart janë angazhuar dhe aktorë të tjerë (ekspertët ndërkombëtarë dhe lokalë), por që nuk kanë përgjegjësi zyrtare për këtë proces.

Ndërtimi dynivelësh i kurikulit të CARDS (skeletkurikul dhe kurikul në nivel shkolle/qendre), si dhe ndarja e përgjegjësive për secilin nivel, i jep një pavarësi relative mësimdhënëve (si individë dhe në grup) për të rritur fleksibilitetin dhe shkallën e përshtatjes së kurikulit në nivel shkolle/qendre ndaj kushteve konkrete të shkollave/qendrave dhe kërkesave të tregut rajonal.

Duhet theksuar se disa nga përgjegjësitë e mësipërme ushtrohen vetëm në kuadrin e pilotimit që drejtohet nga Programi CARDS. Komisionet e kurikulave (ose bërthamat shkencore) si dhe kryetarët e tyre, nuk janë të formalizuara (nuk kanë një status zyrtar). Shkollat dhe DRFP-të nuk kanë mbështetje financiare për proceset kurikulare (p.sh. kryetarët e komisioneve nuk kanë pagesa shtesë ose pakësim të ngarkesës mësimore për këtë funksion shtesë). Për këtë arsye edhe angazhimi i konsulentëve të jashtëm bëhet i vështirë.

e) Rezultate që kanë të bëjnë me aspekte përmbajtësore të kurikulave të monitoruara.

Nga informacioni i mbledhur nëpërmjet monitorimit në lidhje me aspektet përmbajtësore të kurikulit sipas modelit të CARDS, rezulton se:

- Pjesa e praktikës profesionale ka një vend relativisht të konsiderueshëm në kurikul, sidomos në kurset e formimit.
- Vihet re një prirje për rritjen e shkallës së integritit të teorisë me praktikën, veçanërisht te kurset e formimit.
- Po kështu, ka një koordinim më të mirë për aspektet ndërlëndore.
- Përmbajtja e kurikulit rezulton të jetë më shumë e përshtatur me kushtet konkrete të shkollave ose DRFP-ve.
- Përmbajtja e kurikulit rezulton të jetë më shumë e orientuar edhe nga veçoritë rajonale të tregut të punës, për kualifikimet përkatëse.
- Në shkollat profesionale, mësimdhënësit mendojnë se objektivat mësimore janë të qarta, të matshme dhe të realizueshme, po kështu, tematikat, shpërndarjet kohore, metodat dhe teknikat e vlerësimit janë përzgjedhur në përputhje me objektivat dhe kushtet e realizimit të procesit mësimor.
- Në DRFP-të, instruktorët ndjehen të familjarizuar me modelin modular dhe mendojnë RM-të janë “të përcaktuara më qartë, më të matshme dhe më shumë në përputhje me kompetencat profesionale të nevojshme për tregun e punës”.

Këto ndryshime pozitive në përbajtjen e kurikut janë kryesisht për arsye të rritjes së pavarësisë së nivelit të shkollës/qendrës për të hartuar kurikulat e këtij niveli. Nga analiza e dokumentacionit kurikular, rezulton se në përshkruesit e moduleve, kriteret e realizimit (KR) për çdo RM, thjesht përsërisin përbajtjet e RM-ve përkatëse (duke ndryshuar formën e foljes, nga emër foljor, në folje kalimtare), dhe rrallëherë paraqesin tregues cilësorë dhe sasiorë të shkallës së përbushjes së tyre.

f) Rezultate që kanë të bëjnë me efektet dhe vështirësitë në zbatimin e kurikulave të monitoruara.

Modeli i ri kurikular sipas CARDS përbën një risi për ofruesit e AFP të monitoruar, duke sjellë pasoja përgjithësisht pozitive, por edhe vështirësi gjatë hartimit dhe zbatimit të tij në nivel shkolle/qendre.

Nisur nga efektet pozitive, kurikuli i ri rezulton të jetë:

- më “i ndryshëm” ndaj ndryshimeve të kërkesave rajonale të tregut të punës.
- më fleksibël për tu përshtatur me kushtet konkrete të shkollave/qendrave.
- më i orientuar kah veprimtaria praktike dhe kompetencat e punës.
- më tërheqës për nxënësit/kursantët.
- më i larmishëm nga pikëpamja e metodave dhe teknikave të mësimdhënies dhe vlerësimit.
- më i hapur për përfshirjen e aktorëve të ndryshëm të interesuar për AFP-në, duke përfshirë dhe partnerë nga tregu i punës.
- më i hapur ndaj futjes së risive përbajtësore dhe metodologjike (kompetencave kyçe, integritimit ndërlëndor, metodave me nxënësin në qendër, vlerësimeve të bazuara në kriteret, etj.).

Procesi i hartimit dhe veçanërisht zbatimi i kurikut të ri sipas CARDS, ka hasur dhe në vështirësi, si më poshtë:

- mungesë përvoja dhe ekspertize në nivel shkolle/qendre për proceset e reja metodologjike të zbatuara në hartimin e kurikut të ri.
- vështirësi e drejtuesve dhe mësimdhënësve për tu shkëputur nga strukturat e mëparshme kurikulare (tradicionale).
- mungesë e trajnimeve të mëparshme të mësimdhënësve për aspekte didaktike, të nevojshme në zbatimin me sukses të modelit të ri kurikular.
- Vështirësi (ose pamundësi) e mësimdhënësve për të përdorur teknologjitë kompjuterike në mbështetje të proceseve kurikulare.
- nivel përgjithësisht i ulët i nxënësve/kursantëve që ndjekin këto kualifikime profesionale.
- “rezistencë” e disa mësimdhënësve për të mos u angazhuar në proceset e reja kurikulare.
- “imponim” nga inspektorët e DAR-eve për të përdorur formate kurikulare në nivel shkolle, të ndryshme nga modeli i CARDS.
- rritje e ngarkesës reale të mësimdhënësve të angazhuar në hartimin dhe zbatimin e kurikut të ri, sidomos atij me strukturë modulare.
- rritje e ngarkesës administrative (më shumë dokumentacion administrativ dhe mësimor).

- mungesë e formalizimit të strukturave institucionale të pilotuara dhe e vazhdimësisë së burimeve financiare mbështetëse për modelin e ri.
- vështirësi nga mësimdhënësit në trajtimin e moduleve që integrojnë teorinë me praktikën (përgjithësisht mësimdhënësit janë të orientuar vetëm nga teoria ose vetëm nga praktika).
- vështirësi në administrimin kohor të moduleve që ka krijuar probleme në shpërndarjen e ngarkesave mësimore të stafit.
- vështirësi në realizimin e praktikave profesionale të shpërndara dhe të grupuara, sipas shpërndarjeve kohore të kërkuara nga skeletkurikuli.
- përfshirje e kufizuar e përfaqësuesve nga bota e punës në proceset e reja kurikulare në nivel shkolle/qendre.
- mungesa në infrastrukturën mësimore (mjedise, mjete, pajisje dhe materiale për mësimin praktik dhe teorik), krahasuar me kërkesat në rritje të kurikulit të ri.
- mungesa të theksuara në tekstet mësimore dhe vështirësi në përgatitjen e materialeve ndihmëse, në mbështetje të procesit mësimor.
- vështirësi në realizimin e praktikave mësimore në mjediset e punës së bizneseve lokale.

Duhet theksuar që pjesa më e madhe e vështirësive të renditura më sipër, nuk janë tipike vetëm për modelin e ri kurikular të CARDS, por kanë penguar realizimin edhe të kurikulit tradicional, të zbatuar më parë (ose që vazhdon të zbatohet për profile mësimore të papërfshira në pilotim) në këto shkolla/qendra.

A. Propozime për ndryshime në modelin kurikular të monitoruar.

Nisur nga analiza e mësipërme e të dhënave të monitorimit të kryer në lidhje me zbatimin e modelit kurikular të CARDS në AFP, duke konsideruar dhe problematikën e hasur, grupi i monitorimit parashtron propozimet e mëposhtme për ndryshime që synojnë përmirësimin e këtij modeli si dhe të kushteve për zbatimin me sukses të tij:

Në lidhje me strukturën e kurikulit:

- Ndryshimi i renditjes së rubrikave të përshkruesit të modulit, në mënyrë që për çdo RM, të paraqiten në një bllok të gjitha rubrikat që lidhen me të (përmbajtja, instrumentet e vlerësimit dhe kriteret e realizimit), për të mënjeluar mosvijimësinë që vihet re në strukturën aktuale të përshkruesve të moduleve.
- Heqja nga tabela e “strukturës së vitit shkollor” (që ndodhet në skeletkurikul) e kolonës që përcakton mënyrën se si shkollat duhet të realizojnë praktikat profesionale (të shpërndara apo të grupuara) dhe krijimi i mundësisë që vetë shkollat ta përcaktojnë këtë duke respektuar vëllimin e përgjithshëm të praktikës të përcaktuar në skeletkurikul.

Në lidhje me përmbajtjen e kurikulit:

- Formulimi i kriterëve të realizimit (KR) në një mënyrë të tillë që të shprehin më mirë, nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, shkallën e përmbushjes së RM-së përkatëse dhe jo thjesht të përsërisin përmbajtjet duke ndryshuar formën e foljes, nga emër foljor, në folje kalimtare.
- Rishikimi i raporteve teori/praktikë të kualifikimeve të monitoruara në shkollat profesionale, për t’i përshtatur më mirë kundrejt kërkesave të profesioneve përkatëse dhe kushteve e mundësive konkrete të shkollave.

- Hartimi i përshkruesve të moduleve me kohëzgjatje të plotë semestrale ose vjetore (dhe jo të ndërmjetme) për të shmangur vështirësitë administrative në shpërndarjen e ngarkesave mësimore të mësimdhënësve dhe përpilimin e orarit mësimor të shkollave.

Në lidhje me metodologjinë e hartimit të kurikut:

- Krijimi i një mekanizmi për analizën e problematikës gjatë zbatimit të kurikut në nivel shkolle/qendre dhe për rekomandimin e ndryshimeve të mundshme në përmbajtjen e skeletkurikut.
- Përfshirja më e madhe e përfaqësuesve nga bota e punës në procesin e hartimit dhe zbatimit të kurikulave në nivel shkolle/qendre për të mundësuar fokusimin e tyre nga nevojat e tregut rajonal të punës.
- Institucionalizimi i metodologjisë së hartimit të kurikut në nivel shkolle/qendre nëpërmjet punimit, me stafet e shkollave/qendrave, të “Manualit për hartimin e kurikulave - CARDS” si dhe ndryshimit të rregullores së shkollave/qendrave për të përfshirë edhe proceset e reja kurikulare. Kjo do të shmangte shumë nga problemet e shfaqura në lidhje me metodologjinë e hartimit të kurikulave në nivel shkolle/qendre.

Në lidhje me procesin e zbatimit të kurikut:

- Organizimi i trajnimeve teorike dhe praktike (të strukturuar) të mësimdhënësve, sidomos atyre që nuk janë përfshirë në trajnime të mëparshme, si dhe i shkëmbimit të përvojës, në lidhje me aspektet e hartimit dhe zbatimit të kurikut të ri për shfrytëzimin sa më optimal të autonomisë kurikulare që u jep modeli i ri.
- Përgatitja e mësimdhënësve aktualë si dhe përzgjedhja e mësimdhënësve të rinj që të mund të trajtojnë njëkohësisht aspektet teorike dhe praktike të mësimin (të cilat përmbahen në mënyrë të integruar në modulet mësimore).
- Trajnimi i mësimdhënësve për teknikat e përgatitjes së materialeve mësimore ndihmëse si dhe pajisja e shkollave/qendrave me mjetet, pajisjet dhe materialet e nevojshme për këtë.
- Njohja e inspektorëve të DAR-eve me modelin e ri kurikular dhe koordinimi me ta që në shkollat profesionale të përdoren vetëm formatet e programeve shkollore dhe planeve të instruksionit sipas modelit të CARDS.
- Formalizimi i “komisioneve të kurikulave (ose i departamenteve)” dhe “kryetareve të komisioneve” në shkollat profesionale, si njësi bazë për hartimin e kurikulave në nivel shkolle (dhe për aspekte të tjera përmbajtësore). Kjo do të mundësonte qëndrueshmërinë e modelit kurikular të CARDS edhe pas përfundimit të mbështetjes nga projekti.
- Krijimi në çdo shkollë/qendër i “qendrës burimore” ku stafi i saj të ketë kushte të përshtatshme për të marrë informacione dhe për të punuar për aspekte kurikulare dhe të tjera.
- Krijimi i një zëri në buxhetet e shkollave/qendrave për të mbështetur financiarisht veprimtaritë që kanë të bëjnë me aspektet e hartimit dhe zbatimit të kurikut në nivel shkolle/qendre (si dhe aspekte të tjera përmbajtësore).

Përmbushja e propozimeve të mësipërme do të kishte një ndikim të konsiderueshëm jo vetëm të aspektet kurikulare, por edhe të aspekte të tjera të rëndësishme të reformës së Arsimit dhe Formimit Profesional në Shqipëri.

RAPORT I STUDIMIT

“Modelet Kurikulare të AFP në botë”

Janar, 2008

Sektori i SSTM

Studimi për “Modelet Kurikulare në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP)” u krye nga Sektori i Skeletkurikulave dhe Standardeve të Trajnimit të Mësuesve të AFP-së në përputhje me Platformën e këtij studimi të miratuar nga Drejtoria e AKAFP-së.

1. Informacion i përgjithshëm për studimin.

Qëllimi i studimit:

Të analizojë modele të ndryshme kurikulare të AFP-së në vende të ndryshme Evropiane dhe më gjerë, dhe të propozojë përvoja pozitive për përmirësime të mundshme në modelet kurikulare të AFP-së që zbatohen në Shqipëri.

Grupi që kreu studimin:

Drejtues i grupit: Alqi Mustafai

Anëtarë të grupit: Albina Buci, Edlira Popa, Elda Gega dhe Marsela Robo.

Kohëzgjatja e kryerjes së studimit:

Qershor – Dhjetor 2007

Metodologjia/hapat për kryerjen e studimit:

1. Përcaktimi i procedurës për të kryer studimin (hapat e punës, përgjegjësitë, afatet, produktet).
2. Përcaktimi i instrumenteve për mbledhje informacioni.
3. Mbledhja e informacionit për modelet e ndryshme kurikulare në AFP (për aspektet strukturore, përmbajtësore dhe metodologjike):
 - Grumbullimi i materialeve për kurikulat e AFP-së nëpërmjet internetit.
 - Grumbullimi i literaturës së shkruar dhe dokumentacionit për kurikulat e AFP-së.
 - Grumbullimi i materialeve për kurikulat e AFP-së nëpërmjet kontakteve me individë dhe institucione që zhvillojnë kurikulat e AFP-së.
4. Studimi dhe përpunimi i informacionit të mbledhur.
5. Përgatitja e Raportit të studimit për modelet e kurikulit të AFP-së (me rekomandime për përmirësime në modelet aktuale në Shqipëri).
6. Prezantimi dhe diskutimi i rezultateve të studimit me stafin e AKAFP-së dhe të interesuar të tjerë të sferës së AFP-së.

Disa kritere në të cilat është mbështetur studimi:

Nga studimi, rezulton se sot në botë, ka një shumëllojshmëri modelesh kurikulare të AFP-së, të cilat i referohen formave, mënyrave dhe strukturave karakteristike të ndërtimit dhe funksionimit të sistemeve të AFP-së në këto vende. Për lehtësi studimi, grupi paraprakisht përcaktoi një kuptim për atë që emërtohet “*model kurikular*”, i cili shërbeu si bazë për të kryer analizën. Si elementë karakteristikë të këtij modeli kurikular të pranuar nga grupi studimor, u përzgjedhën: *koncepti i kurikulit; struktura e kurikulit; përmbajtja e kurikulit, metodologjia e hartimit dhe përgjegjësitë.*

Nga ana tjetër, për të shmangur vështirësitë që paraqiste analiza e llojshmërisë së madhe të modeleve kurikulare në këtë fushë, faza fillestare e studimit u fokusua në përzgjedhjen e **dy modeleve bazë**, të cilat qëndrojnë në themel të sistemeve më të njohura të AFP në Evropë dhe më gjerë. Modelet e përzgjedhura janë:

- Modeli kurikular i arsimit profesional në **Gjermani** (referuar **sistemit dual** dhe që ka gjetur zbatim të plotë në Austri, Zvicër dhe pjesërisht në shumë vende të tjera).
- Modeli kurikular i arsimit dhe formimit profesional në **Skoci** (referuar **sistemit modular**, që ka gjetur zbatim të plotë në Britani, Irlandë, Danimarkë, Holandë, Australi, etj., si dhe zbatim të pjesshëm në shumë vende të tjera, përfshirë dhe Shqipërinë).

2. Rezultatet e studimit.

Bazuar në analizën e informacionit të mbledhur në kuadrin e studimit të modeleve kurikulare të AFP-së në botë, grupi realizues i studimit paraqet **rezultatet** e mëposhtme, të strukturuar sipas modeleve të përzgjedhura:

A. Në lidhje me modelin kurikular të AP-së në Gjermani (referuar sistemit dual).

Sistemi dual i Arsimit Profesional në Gjermani karakterizohet nga këto tipare të përgjithshme:

- Përgjegjësi e ndarë midis sektorit privat dhe atij publik, në lidhje me Arsimit Profesional.
- Arsimit Profesional realizohet në kompani ose në qendra formimi të specializuara (për pjesën praktike të kurikutit që është rreth 70%) dhe në shkolla profesionale (për pjesën teorike të kurikutit, që është rreth 30%).
- Sistemi-dual është një koncept i zhvilluar në nivel federal (me kuadër ligjor të detyrueshëm për të gjitha landet).
- Partnerët socialë (punëdhënësit dhe punëmarrësit) janë kontribues si për zhvillimin dhe miratimin e kualifikimeve profesionale, ashtu dhe për vlerësimin e certifikimit e nxënësve.
- Nxënësit konsiderohen të punësuar me kontratë në ndërmarrje, për aq kohë sa vazhdojnë kualifikimin në sistemin dual.

Nga përpunimi i informacionit të mbledhur, rezulton që modeli kurikular i këtij sistemi të Arsimit Profesional, karakterizohet nga:

- **Koncept** relativisht i gjerë i kurikutit, si “një tërësi veprimesh që duhen ndjekur kur zhvillon një kualifikim profesional”. Ky kuptim i gjerë është pasqyruar edhe në strukturën dhe përmbajtjen e tij, duke përfshirë një numër të madh dokumentesh kurikulare dhe normative.
- **Strukturë** dynivelëshe e kurikutit: (a) skeletkurikula në nivel qendror (federal), për çdo kualifikim, që janë të detyrueshme si për shkollat profesionale, ashtu dhe për ndërmarrjet e përfshira në sistem, (b) kurikula në nivel ofruesi (në shkollat profesionale dhe në ndërmarrjet) që detajojnë dhe përshtatin skeletkurikulin përkatës. Ndërtimi i skeletkurikulave për kualifikime të ndryshme ka një format unik, ndërsa formati i kurikulave në nivel ofruesi nuk është i detyrueshëm. Struktura e skeletkurikutit i referohet strukturës së kualifikimeve profesionale, të ndara në familje profesionale dhe në disa profesione për çdo familje (specializimet e ngushta janë pjesë e çdo profesioni).

- **Përmbajtje** përgjithësisht komplekse e kurikutit. Skeletkurikuli, për një kualifikim specifik, që është njëkohësisht edhe akt normativ, përmban:
 - aspekte normative, të detyrueshme, që bëjnë të mundur zbatimin e kurikutit dhe vlerësimin përfundimtar të nxënësve;
 - fushat profesionale (kompetencat) të punësimit të nxënësit me mbarimin e suksesshëm të shkollimit. Në përgjithësi këto fusha detajohen nga pikëpamja e (i) njohurive, (ii) shprehive dhe (iii) kompetencave kyçe;
 - përshkrimin e familjes profesionale ku bën pjesë kualifikimi përkatës (pjesën e përbashkët, që përmban kompetencat e përgjithshme);
 - përshkrimin e kualifikimit që përmban kompetencat specifike të tij, tërësinë e arritjeve minimale të nxënësve për çdo kompetencë (që do të verifikohen nëpërmjet provimeve), si dhe shpërndarjen kohore përkatëse. Këto janë të detyrueshme për çdo ofrues;
 - informacion për provimet përfundimtare, për metodat mësimore dhe për kushtet e nevojshme për zbatimin e kurikutit, si dhe kërkesat për mësimdhënësit.

Shkollat profesionale dhe ndërmarrjet kanë pavarësi për të hartuar kurikulat në nivel ofruesi, bazuar në skeletkurikulat përkatëse. Përgjithësisht, kurikuli i shkollave profesionale përmban kompetencat e pritshme, objektivat mësimore, temat, përmbajtjet mësimore dhe shpërndarjet kohore përkatëse, rekomandimet didaktike dhe mjetet mësimore të nevojshme. Në mënyrë të ngjashme, edhe kurikuli i ndërmarrjeve ofruese të arsimit profesional dual përmban profilin profesional përkatës, njohuritë, shprehitë dhe kompetencat e përgjithshme të kualifikimit, si dhe kohëzgjatjet e trajnimit për çdo kompetencë profesionale (vend pune).

Nga pikëpamja përmbajtësore, në fazat e para të shkollimit mbizotëron formimi i përgjithshëm profesional dhe më tej vazhdohet me formim profesional më të specializuar. Tradicionalisht, kurikuli në sistemin dual gjerman është i ndërtuar me “lëndë mësimore”, por vitet e fundit ka një prirje për modularizim duke përdorur “kompetencat” si bazë për ndërtimin e tij, që krijojnë mundësi të integritimit ndërlëndor.

- **Metodologji** (procedura) dhe përgjegjësi që i referohen specifikisht skeltkurikutit dhe kurikutit në nivel ofruesi (shkolle profesionale dhe ndërmarrjeje).
Procedura (hapat) për hartimin e skeletkurikutit për një kualifikim profesional paraqitet në tabelën e mëposhtme:

| Hapat proceduralë | Aktorët dhe rolet |
|---|---|
| Përcaktimi i nevojës për një kualifikim profesional të ri | Partnerët socialë (biznesi) në bashkëpunim me BIBB (Instituti Federal për Arsimin Profesional) dhe të tjerë, formulojnë kërkesën. |
| Marrëveshje e partnerëve socialë | Organizatat e partnerëve socialë të sektorit përkatës. |
| Aplikim te BMBF (Ministria Federale e Arsimit dhe Kërkimit). | Formulesit e aplikimit (kërkesës). |
| Shqyrtim dhe miratim i aplikimit | BMBF |
| Hartimi i draftit të skeletkurikutit së bashku me elementet normative (rregulloren) | Ekspertët e BIBB, qeverisë federale dhe të landeve, në bashkëpunim me partnerët socialë |

| | |
|---|---|
| Seancë bashkërendimi për elementet e rregullores dhe skeletkurikulit. | BMBF, BIBB, anëtarët e Konferencës së Ministrave të Arsimit/Kulturës së Landeve (KMK), partnerët, ekspertë. |
| Përgatitja e draftit final të skeletkurikulit (rregullores). | Komiteti Federal i BIBB, Komitetit i Përhershëm i BIBB, Komiteti Koordinues. |
| Dekretim dhe shpallje e rregullores dhe skeletkurikulit përkatës. | Ministria Federale që përgjigjet për kualifikimin përkatës. |

Nga tabela e mësipërme, vihet re që **proces** i hartimit të skeletkurikulave të sistemit dual në Gjermani është relativisht i gjatë (normalisht dy vite), me procedura të shumta administrative dhe normative dhe angazhon shumë aktorë në role të ndryshme (BIBB është në rolin e moderatorit). Pothuaj e njëjta procedurë ndiqet edhe për rishikimin e skeletkurikulave ekzistuese.

Përsa i përket **procedurave** (hapave) për zhvillimin e mëtejshëm të skeletkurikulave, për t'i shndërruar ato në programe të nivelit të ofruesit (shkollave dhe ndërmarrjeve), **nuk ka** një metodologji të zyrtarizuar, të detyrueshme për zbatim. Institucione të ndryshme (përfshirë dhe BIBB) japin rekomandime metodologjike (p.sh, të punojnë në grup, të angazhojnë partnerët socialë, të integrojnë teorinë me praktikën, të integrojnë projekte në kurikula) dhe ofruesit zhvillojnë procedurat e tyre.

Modelet kurikulare të arsimit profesional të Zvicrës dhe Austrisë janë shumë të ngjashme me atë të Gjermanisë, të përshkruar më sipër. Kjo ngjashmëri buron nga fakti që të gjithë këto sisteme janë **duale**, pra të bazuara në ndërmarrjen për pjesën e praktikës, dhe në shkolla profesionale, për pjesën e teorisë. Sigurisht që kanë dhe veçori të cilat nuk e prekin thelbin e modelit kurikular të përshkruar më sipër.

B. Në lidhje me modelin kurikular të AFP-së në Skoci (referuar sistemit modular).

Sistemi modular i AFP në Skoci karakterizohet nga këto tipare të përgjithshme:

- Nuk ka ndarje të prerë midis arsimit profesional, formimit profesional dhe arsimit të lartë.
- Trajnimi profesional ofrohet nga ofruesit privatë, organizatat vullnetare sipas sektorëve, autoritetet lokale, kolegjet e arsimit të mëtejshëm dhe punëdhënësit, që pranojnë nxënës me kohë të plotë ose të pjesshme (për module të veçanta ose grup modulesh).
- Arsimi profesional realizohet kryesisht në “kolegje të arsimit të mëtejshëm” me karakter profesional, duke filluar nga mosha 16 vjeçare (pa kufizime në moshë). Oferta për trajnime profesionale është shumë e larmishme, p.sh, një numër i madh programesh trajnimi financohen nga Qeveria dhe realizohen nga rrjeti i Local Enterprise Companies (LECs).
- Baza e arsimit dhe formimit profesional të Skocisë janë “kualifikimet profesionale”.
- Nga pikëpamja e dokumentacionit, nuk ka një ndarje të prerë midis “kualifikimit” dhe “kurikulit” përkatës. Shumë dokumente (p.sh, përshkruesi i modulit) mund të konsiderohen edhe pjesë e kualifikimit, por edhe element i kurikulit përkatës.
- Ka një Kornizë Kombëtare të Kualifikimeve (me 12 nivele) në të cilën bën pjesë dhe Korniza e Kualifikimeve Profesionale (me 5 nivele).
- Sistemi i kualifikimeve profesionale në Skoci menaxhohet nga Autoriteti Skocez i Kualifikimeve (SQA) i cili është një organizëm publik jo-qeveritar (i sponsorizuar

nga qeveria) që është përgjegjës për zhvillimin, akreditimin, vlerësimin dhe certifikimin e kualifikimeve profesionale (përjashtuar ato të arsimit të lartë).

- Kualifikimet profesionale kanë strukturë modulare, me akumulim dhe transferim kreditesh.
- Vlerësimi i nxënësve është i brendshëm (nga vetë kolegjet) dhe i bazuar në kriteret e përcaktuara në modulet përkatëse.
- Veprojnë mekanizmat e “verifikimit të brendshëm” dhe të “verifikimit të jashtëm” që garantojnë cilësinë e vlerësimit të nxënësve.
- Partnerët socialë (të organizuar në Komitete Sektoriale) japin një kontribut të konsiderueshëm në hartimin, “validimin” dhe miratimin e kualifikimeve profesionale.

Nga përpunimi i informacionit të mbledhur për modelin skocez, rezulton që modeli kurikular i këtij sistemi të AFP, karakterizohet nga:

- **Koncept** relativisht i gjerë i kurikulit, si “përshkrim i hollësishëm i një kursi ose lënde (moduli) që tregon të gjitha përvojat e të nxënësve të cilave i nënshtrohet nxënësi”. Ky koncept i gjerë pasqyrohet në tërësinë e dokumenteve kurikulare (me bazë modulare) të hartuara dhe miratuara në nivel kombëtar dhe në nivel ofruesi.
- **Strukturë** dynivelëshe e kurikulit modular (me format unik):
 - (a) kurikul modular në nivel qendror, që përbëhet nga:
 - module bazë, të detyrueshme, të përbashkëta për të gjitha kualifikimet e të njëjtit nivel;
 - module të detyrueshme, specifike për drejtimin e kualifikimit;
 - module me zgjedhje, në përputhje me kërkesat e nxënësve dhe ofertat e ofruesve.
 - (b) kurikulat në nivel ofruesi (p.sh. te kolegjet), që i zbërthejnë modulet qendrore dhe i përshtatin ato duke ndërtuar programet mësimore për mësimdhënësit, për të cilat nuk ka format unik.

Baza e ndërtimit të kurikulit të AFP skocez është “moduli/njësia” mësimor/e. Përshkruesi i modulit/njesisë mund të konsiderohet si një minikurikul për to. Ai, përgjithësisht përbëhet nga elementet e mëposhtëm:

- Titulli, niveli dhe kodi.
- Vlera e kreditit (kohëzgjatja).
- Qëllimi (kompetenca të cilës i referohet).
- Kriteret e hyrjes (pranimi).
- Rezultatet e synuara të të mësuarit (RM).
- Përmbajtja dhe konteksti (kushtet) për çdo RM.
- Procedurat e vlerësimit (instrumentet e vlerësimit dhe kriteret e realizimit) për çdo RM.
- Udhëzime metodologjike për zbatimin e modulit.

Pavarësisht nga çka përmendet më sipër, kurikulat skoceze të AFP dhe modulet janë të shumëllojshme nga pikëpamja strukturore, në vartësi të nivelit të kualifikimit që ofrohet.

- **Përmbajtja** e kurikulit për një kualifikim kombëtar karakterizohet nga këto tipare kryesore:
 - Përmbajtje me fleksibilitet të lartë, në përputhje me nevojat konkrete të tregut.
 - Përmbajtje relativisht e “ngushtë”, e fokusuar te kompetencat specifike të kualifikimit.
 - Ekzistenca edhe e moduleve detyruese për “kompetenca kyçe (të gjera)”, të përbashkëta për shumë kualifikime.

- Raporte të ndryshueshme midis moduleve specifike dhe atyre të gjera, që variojnë sipas natyrës dhe specifikave të kualifikimit përkatës.
 - Fokusim më të madh te “arritjet e nxënësve dhe procedurat e vlerësimit” se sa te detajimi i përmbajtjeve mësimore.
 - Shkalla e thellimit përmbajtësor varet nga niveli (pozicioni) i kualifikimit përkatës në kornizën skoceze të kualifikimeve.
 - Përmbajtje e kualifikimit e “copëzuar” në një numër relativisht të madh njësisish mësimore.
- **Metodologji** (procedura) dhe përgjegjësi që i referohen specifikisht dokumenteve të kualifikimit kombëtar (në nivel qendror) dhe dokumenteve të po këtij kualifikimi në nivel ofruesi. Procedura (hapat) për hartimin dhe miratimin e një kualifikimi profesional kombëtar kryhet si më poshtë:

| Hapat proceduralë | Aktorët dhe rolet |
|--|---|
| Analiza dhe përcaktimi i nevojës për një kualifikim profesional të ri | Ofrues të AFP ose të interesuar të tjerë. |
| Paraqitja te SQA-ja e kërkesës dhe argumentimit për kualifikimin e ri. | Ofrues të AFP ose të interesuar të tjerë. |
| Konceptimi i kualifikimit të ri. | Ofrues të AFP ose të interesuar të tjerë. |
| Përzgjedhja e moduleve ekzistuese ose hartimi i moduleve të reja për kualifikimin. | Ofrues të AFP ose të interesuar të tjerë në bashkëpunim me SQA. |
| “Validimi” i kualifikimit të ri (verifikimi i vlefshmërisë). | SQA me partnerët socialë. |
| Miratimi i kualifikimit të ri profesional (përfshirja në kornizën skoceze të kualifikimeve). | SQA |
| Përfshirja e moduleve të reja të miratuara në katalogun e moduleve të SQA. | SQA |
| Zbatimi i kualifikimit të ri profesional të miratuar. | Ofrues të kualifikimit të ri profesional. |
| Rishikimi (nëse është e nevojshme) i kualifikimit. | Ofrues të AFP ose të interesuar të tjerë. |

Nga tabela e mësipërme, vihet re që procesi i institucionalizimit (në nivel qendror) të kualifikimeve të reja profesionale dhe i hartimit të kurikulave (moduleve) përkatëse është **ciklik**, me jetëgjatësi të papërcaktuar, e cila varet nga nevojat. Në këtë proces përfshihen shumë aktorë, ku rolin kryesor hartues e kanë ofruesit (të akredituar nga SQA), rolin validues e kanë partnerët ndërsa SQA përmbush role teknike/administrative dhe bën miratimin përfundimtar. Pavarësisht se cili do të jetë konceptuesi i kualifikimeve dhe hartuesi i moduleve përkatëse, ai është i detyruar të zbatojë rregulloret, udhëzimet dhe modelet standarde të ofruara nga SQA.

Përsa i përket metodologjive për zberthimin e mëtejshëm në nivel ofruesi të moduleve të kualifikimeve kombëtare, nuk ka një metodologji të zyrtarizuar, të detyrueshme për zbatim. Vetë modulet përmbajnë rekomandime metodologjike për zbatimin e tyre.

Ky model kurikular i AFP që zbatohet në Skoci, njihet si “modeli Anglo-Sakson” dhe është i përhapur në Britaninë e Madhe, në Irlandë dhe vende të tjera të ndikimit britanik.

Gjithashtu, vitet e fundit, shumë vende anëtare ose jo të Bashkimit Evropian janë duke pilotuar skema të ndryshme të modelit kurikular modular.

3. Konkluzione dhe rekomandime për modelin kurikular të AFP-së në Shqipëri.

Nisur nga informacioni i mësipërm si dhe nga gjendja reale e modeleve kurikulare (pilote ose jo) që zbatohen sot në AFP-në shqiptar, grupi studimor parashton konkluzionet dhe propozimet e mëposhtme për ndryshime që synojnë përmirësime të mundshme në modelet kurikulare të AFP-së në Shqipëri:

A. Konkluzione të përgjithshme për modelet kurikulare të studiuara:

- Kanë një **koncept kurikular** relativisht të gjerë, që nuk kufizohet vetëm me trajtimin e përmbajtjeve mësimore (programet lëndore apo modulet), por konsiderohet si një projekt pedagogjik i plotë, duke përfshirë dhe mjaft elemente të tjera kurikulare. Gjithashtu, hartimi i kurikulit shihet si një proces i vazhdueshëm dhe jo si një akt i vetëm, me përfshirje të shumë aktorëve dhe faktorëve.
- Kanë **strukturë** kurikulare **dynivelëshe**: (a) nivelin qendror që përfaqësohet nga dokumente kurikulare të standardizuara dhe normative, dhe (b) nivelin e ofruesit që bazohet në nivelin qendror, si dhe e zërthen/përshtat atë sipas kërkesave dhe kushteve specifike.
- Kanë një **referencë** të fuqishme ndaj nevojave për kualifikime profesionale si dhe zhvillimeve në tregun e punës. Kjo pasqyrohet te përmbajtja e këtyre kurikulave që është e orientuar nga kompetencat e punës dhe nga veprimtaria praktike, si dhe mbështetet në **standarde**.
- Synojnë njëkohësisht si formimin profesional, ashtu edhe formimin e përgjithshëm të nxënësve për të përballuar sfidat e jetës, nëpërmjet zhvillimit të **“kompetencave kyçe”**.
- Vihet re një **kalim gradual**, nga formimi profesional bazë në nivele të ulëta, drejt formimit profesional më të specializuar në nivele të larta.
- Kanë **fleksibilitet** kurikular të konsiderueshëm, pra krijojnë mundësi të gjera përzgjedhjeje dhe **mobiliteti** vertikal dhe horizontal në strukturat e sistemit të AFP.
- Kanë **përshtatshmëri** kurikulare të lartë, pra, bazuar në dokumentet kurikulare standarde të nivelit qendror, ofruesit e AFP-së kanë **pavarësi** që të hartojnë programe në përputhje me nevojat lokale dhe me kushtet reale për zbatim.
- Në nivelin qendror, kanë fokusim të theksuar te **arritjet** e nxënësve dhe te procedurat e **vlerësimit** të tyre dhe bëjnë pasqyrim më të zbehtë të aspekteve përmbajtësore dhe metodologjike të procesit mësimor. Struktura **modulare** e kurikulit e ka më të theksuar këtë tipar.
- Ndërtohen mbi bazën e një procesi kurikular **ciklik**, të bazuar në **analizën e profesionit**, ku rolin kryesor në përcaktimin e arritjeve të nxënësve e luajnë **përfaqësuesit e botës së punës** dhe në përcaktimin e aspekteve përmbajtësore dhe didaktike e luajnë **përfaqësuesit e sferës së arsimit**.

- Kanë **formate unike** (standarde) të dokumenteve kurikulare në nivel qendror dhe formate të **shumëllojshme** të atyre në nivel ofruesi të AFP-së.

B. Propozime për ndryshime në modelin kurikular të AFP-së në Shqipëri.

Nisur nga informacionet e mësipërme, parashtrohen **propozimet** e mëposhtme për ndryshime që synojnë përmirësimin e modelit (konceptual, metodologjik dhe strukturor) kurikular të AFP-së, si dhe të kërkesave për zbatimin me sukses të tij:

- Zgjerimin e **konceptit** të kurikulit, nga thjesht një dokument statik që përshkruan përmbajtjet mësimore, drejt një “projekti pedagogjik” dinamik.
- Rritjen e **autonomisë** kurikulare të ofruesve (shkollave dhe qendrave) të AFP-së nëpërmjet:
 - (i) qartësimin të përgjegjësiive kurikulare të nivelit qendror (ministrive dhe institucioneve mbështetëse),
 - (ii) dhënies më tepër përgjegjësi kurikul-hartuese nivelit të ofruesve.
- Unifikimin e modeleve ekzistuese kurikulare të AFP-së në një **model metodologjik** dhe strukturor me format standard në nivel qendror, duke respektuar edhe veçoritë e secilit sektor.
- Rritjen e shkallës së referimit ndaj **nevojave** aktuale dhe perspektive të tregut lokal për kompetenca pune nëpërmjet bazimit të përmbajtjes së kurikulit te “**analiza e profesionit**” dhe te **standartet** përkatëse.
- Fokusimin më të madh të përmbajtjes së kurikulit kah **veprimtaria praktike, kompetencat “kyçe”** dhe **kompetencat profesionale** nëpërmjet rishikimit të raporteve teori/praktikë dhe kulturë e përgjithshme/kulturë profesionale, për t’i përshtatur ato më mirë kundrejt kërkesave të profesioneve përkatëse sipas zhvillimeve rajonale, si dhe **kushteve e mundësive** konkrete të shkollave.
- Fokusimin më të madh të kurikulave kah **arritjet** e nxënësve dhe **procedurat e vlerësimit** të tyre nëpërmjet përfshirjes më të detajuar në dokumentet kurikulare të kriterëve dhe instrumenteve të vlerësimit të arritjeve të nxënësve.
- Përfshirjen më të madhe të përfaqësuesve nga **bota e punës** në procesin e hartimit të kurikulave në nivel qendror dhe sidomos në hartimin dhe zbatimin e tyre në nivel ofruesi të AFP-së, për të mundësuar orientimin kah nevojat e tregut rajonal të punës.
- Institucionalizimin e një **metodologjie** të hartimit të kurikulave të AFP-së në nivel qendror, e cila të respektojë disa **parime** themelore të tilla si bazimi te analiza e profesionit, orientimi nga nevojat, fokusimi te kompetencat e pritshme dhe te praktika, përfshirja e të interesuarve në proces dhe ndarja e roleve e përgjegjësiive të tyre, fleksibiliteti, rishikimi ciklik, mbështetja te rekomandimet didaktike bazë, etj.
- Dhënien e një **autonomie** metodologjike dhe përmbajtësore në nivelin e ofruesve të AFP-së si dhe krijimin e kushteve dhe mbështetjen e tyre për ta realizuar me sukses këtë autonomi.

Përmbushja e propozimeve të mësipërme do të kishte një ndikim të konsiderueshëm jo vetëm te aspektet kurikulare, por edhe te aspekte të tjera të rëndësishme të reformës së Arsimit dhe Formimit Profesional në Shqipëri.

4. Referencat:

- Bejtja.P, Mustafai.A – “*Metoda modulare e të mësuarit*” – Gazeta “Mësuesi”, Tiranë, 1996
- Bejtja.P, Mustafai.A – “*Metoda modulare në arsimin dhe formimin profesional*” – “Revista Pedagogjike”, Tiranë, 1996.
- Curtis.F, Crunkilton.J - “*Curriculum development in vocational and technical education*”, 1999.
- Instituti i Kurikulave dhe Standardeve - Buletinet “*Arsimi dhe Formimi Profesional*”, Nr. 1 – 10 – Tiranë, 2003 – 2007.
- Instituti i Studimeve Pedagogjike – “*Reformimi i Kurikut të Arsimit dhe Formimit Profesional*” - Tiranë, 2000.
- Scottish Vocational Education Council - “*A Guide for Teachers*”, Glasgow, 1992.
- Scottish Vocational Education Council - “*Guide to unit Writing*”, Glasgow, 1993.
- <http://www.bibb.com>
- <http://www.sqa.org.uk>
- <http://www.scotland.gov.uk>
- <http://www.sfeu.ac.uk>
- <http://www.fetac.ie>
- <http://www.etf.europa.eu>

RAPORT I STUDIMIT

“Gjendja e Kurikulave të AFP-së publik në Shqipëri”

Janar 2008

Sektori i SSTM

Studimi “Gjendja e Kurikulave të AFP-së publik në Shqipëri” u krye nga Sektori i Skeletkurikulave dhe Standardeve të Trajnimit të Mësuesve të AFP-së në përputhje me Platformën e këtij studimi të miratuar nga Drejtoria e AKAFP-së.

1. Objekti i studimit.

Ky studim i referohet modeleve të ndryshme kurikulare që veprojnë në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) publik në Shqipëri, **duke u përqendruar vetëm në aspektin “profesional” të këtyre modeleve**, dhe duke mos marrë në konsideratë “kulturën e përgjithshme” të tyre. Njëkohësisht, në këtë studim nuk merren në konsideratë **“tekstet mësimore”** të AFP-së, megjithëse ato përbëjnë një element të rëndësishëm kurikular.

2. Qëllimi i studimit.

Të analizojë gjendjen e produktit dhe të procesit kurikular në AFP publik në Shqipëri dhe të ofrojë argumente për përmirësime të mundshme.

3. Nevoja për studimin

Gjatë 10-15 viteve të fundit, në Arsimin Profesional publik shqiptar, me mbështetjen e donatorëve të ndryshëm, janë pilotuar dhe vazhdojnë të pilotohen disa modele kurikulare. Këta modele kanë struktura të ndryshme, hartohen sipas metodologjive të ndryshme dhe zbatohen në profile mësimore dhe kurse trajnimi, si dhe shkolla profesionale e qendra formimi profesional të caktuara. Llojshmëria relativisht e madhe e modeleve kurikulare që veprojnë në AFP publik ka krijuar vështirësi në krijimin e një sistemi unik kombëtar të AFP-së. Ky realitet ndërlikon edhe veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të AFP-së dhe posaçërisht të Sektorit përkatës të saj, që do të hartojë skeletkurikulat e AFP-së në nivel kombëtar.

Ky studim do të qartësojë gjendjen dhe problematikën përse i përket modeleve kurikulare të AFP dhe do të lehtësojë procesin e unifikimit të këtyre modeleve nga pikëpamja strukturore dhe metodologjike. Ai do të kontribuojë, njëkohësisht, për rritjen e efektivitetit dhe eficiencës së Sektorit të Skeletkurikulave në AKAFP në kuadrin e përmbushjes së detyrës për përgatitjen e një numri të madh të skeletkurikulave të AFP-së, në periudhën 2007-2009.

4. Të dhëna për studimin.

Drejtues i grupit: Alqi Mustafai

Anëtarë të grupit: Albina Buci, Edlira Popa, Elda Gega dhe Marsela Robo.

Kohëzgjatja e studimit: Prill 2007 - Janar 2008

5. Metodologjia e studimit.

Për lehtësi studimi, kurikulat e AFP-së janë analizuar të grupuara në dy ndarje kryesore:

- (a) Kurikulat e Arsimit Profesional (AP) publik, që i referohen kualifikimeve profesionale afatgjata, 2 - 5 vjeçare dhe që janë nën përgjegjësinë e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH).
- (b) Kurikulat e Formimit Profesional (FP) publik, që i referohen kualifikimeve profesionale afatshkurtra, 1- 9 mujore dhe që janë nën përgjegjësinë e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB).

Për realizimin e studimit, u ndoqën hapat e mëposhtëm:

1. Përcaktimi i procedurës për të kryer analizën (hapat e punës, përgjegjësitë, afatet, produktet).
2. Përcaktimi dhe përgatitja e instrumenteve për mbledhje informacioni (tryezat e rrumbullakëta me shkollat profesionale, qendrat e formimit profesional, institucione të tjera; bisedat e strukturuar; analiza e dokumentacionit kurikular për AFP-në; etj).
3. Mbledhja e informacionit për aspektet strukturore, përmbajtësore dhe metodologjike të kurikulave të AFP-së:
 - Grumbullimi i materialeve për modelet e ndryshme kurikulare në AKAFP-në, MASH, IKS, shkollat profesionale dhe qendrat e formimit profesional.
 - Tryezë e rrumbullakët në Shkollën Profesionale “B.Çela”, Shkozet.
 - Tryezë e rrumbullakët në Shkollën Bujqësore, Golem
 - Tryezë e rrumbullakët në Teknike të Ndërtimit, Tiranë.
 - Tryezë e rrumbullakët në Shkollën Elektrike, Tiranë.
 - Tryezë e rrumbullakët në Shkollën e Fermerëve, Shkodër.
 - Tryezë e rrumbullakët në Shkollën e Agrobiznesit, Korçë.
 - Tryezë e rrumbullakët në Shkollën Profesionale “D. Progri”, Korçë.
 - Tryezë e rrumbullakët në Qendrën e Formimit Profesional Nr .1, Tiranë.
 - Tryezë e rrumbullakët me përfaqësues të Sektorit të AP/MASH dhe Sektorit të AFP/IKS.
4. Përpunimi i informacionit të mbledhur.
5. Përgatitja e Raportit të analizës së gjendjes së kurikutit të AFP-së në Shqipëri.
6. Prezantimi dhe diskutimi i rezultateve të analizës me stafin e AKAFP-së dhe të interesuar të tjerë.

6. Rezultatet e studimit.

A. Rezultate të përgjithshme për pjesën profesionale të kurikutit të AFP-së:


- Në lidhje me **Strukturën** e dokumenteve kurikulare të AFP-së:
 - Kurikulat e AP-së kanë si elemente ndërtimore bazë (a) programet tematike (lëndore), teorike ose praktike; (b) modulet mësimore, teorike ose praktike. Ndërsa në FP, baza ndërtimore e kurikulave është **moduli mësimor**. Nga kombinimi i këtyre dy elementeve bazë strukturorë, përcaktohet edhe modeli strukturor që i jep emrin kurikulave përkatëse (shih më poshtë).
 - Kurikulat e AP-së pasqyrojnë tri ndarje kryesore: (a) kulturën e përgjithshme (akademike); (b) kulturën profesionale teorike, dhe (c) kulturën profesionale praktike. Ndërsa në kurikulat e FP-së, struktura modulare e ka zbehur këtë ndarje (të paktën në dokumentet e shkruara kurikulare).

- Kurikulat e AP-së i referohen strukturës së sistemit të AP (kohëzgjatjeve: 3 vjeçare; 5 vjeçare dhe 3+2 vjeçare). Ndërsa kurikulat e FP-së i referohen niveleve të kualifikimeve profesionale (formalisht tri nivele).
- Në lidhje me **Përmbajtjen** e dokumenteve kurikulare të AFP-së:
 - Pas vitit 1993 e në vazhdim, janë rishikuar përmbajtjet e kurikulave për të gjitha kualifikimet profesionale në AP (rishikim të përmbajtjeve të lëndëve ose shtim, pakësim, ndarje apo integrim të tyre). Ndërsa në FP publik, të gjitha kurikulat janë hartuar të reja.
 - Në përputhje me ndryshimet në nevojat rajonale të tregut të punës, si dhe me mundësitë e shkollave dhe qendrave për oferta në AFP, janë hapur disa kualifikime profesionale të reja, si dhe janë mbyllur disa të tjera.
 - Ndryshimet kryesore në përmbajtjen e kurikulit të AFP-së kanë ardhur si pasojë e ndryshimeve në strukturën dhe përmbajtjen e sistemit të punësimit, dhe e ristrukturimit të vetë sistemit të arsimit profesional (duke kaluar nga një, në dy nivele kualifikimi).
 - Këto ndryshime janë bërë si në rrafshin “horizontal”, ashtu dhe në atë “vertikal”. Në rrafshin “horizontal”, janë hartuar dhe po zbatohen kualifikime profesionale të reja, si dhe janë rishikuar përmbajtjet e disa kualifikimeve profesionale për t’i përshtatur ato me ndryshimet e tregut të punës. Në rrafshin “vertikal”, për të gjitha kualifikimet profesionale afatgjata, përmbajtja është diferencuar në dy nivele kualifikimi: (i) niveli i punonjësit të kualifikuar (3 vjeçar) dhe (ii) niveli i teknikut (5 vjeçar ose 3+2 vjeçar). Ndërsa kualifikimet profesionale afatshkurtra, janë strukturuar në tri nivele.
 - Për disa kualifikime profesionale (pilotime të CARDS), përmbajtja është diferencuar në tri nivele kualifikimi: ndihmës punëtori, punëtori i kualifikuar dhe tekniku/menaxheri.
 - Ndarja e përmbajtjes së kurikulave të AFP-së në nivele kualifikimi është bërë në mungesë të listës zyrtare të profesioneve, si dhe të përshkrimeve për nivelet përkatëse.
 - Përmbajtja e kurikulit në AFP ka pësuar ndryshime në drejtim të përfshirjes në të, të transformimeve përmbajtësore të tregut të punës, por pa arritur të shkëputet plotësisht nga pasqyrimi i karakteristikave të tregut të mëparshëm të punës.
 - Përgjithësisht, vihet re që volumi i kulturës profesionale, sidomos i pjesës praktike të saj, rritet gradualisht gjatë kalimit në nivele më të larta për profile të ndryshme të AP-së.
 - Përgjithësisht, në AP, kualifikimet janë të gjera (për degë ose familje profesionale) dhe vetëm në raste të veçanta, fillon specializimi në vite të larta të shkollimit.
- Në lidhje me **Metodologjinë** për hartimin e dokumenteve kurikulare të AFP-së:
 - Procedura formale e realizimit të kurikulit të AFP-së publik paraqitet si më poshtë:
 - a) Porosi në nivel qendror.
 - b) Hartim në nivel të ndërmjetëm (ose në nivel ofruesi për FP).
 - c) Miratim në nivel qendror.
 - d) Zhvillim i mëtejshëm dhe zbatim në nivel shkolle/qendre.
 - Përgjithësisht, shfrytëzimi i informacionit nga bota e punës ka ardhur vazhdimisht në rritje, si nga hartuesit e kurikulave të AP-së, ashtu dhe nga ata të FP-së.
 - Vihet re një delegim (në shkallë të ndryshme) i përgjegjësive për hartim kurikulash të AFP-së, nga niveli qendror dhe ndërmjetës, drejt atij të shkollës/qendrës.
 - Miratimi i kurikulave, në nivel qendror kryhet formalisht dhe përgjithësisht nuk mbështetet në një proces verifikimi (validimi) të plotë kundrejt kriterëve të paracaktuara. E njëjta gjë vihet re dhe për miratimin e kurikulave të AFP-së në nivele më të ulëta.

- Mësuesit dhe instruktorët janë përfshirë në procesin e zhvillimit të mëtejshëm të kurikulave të reja, por ata vazhdojnë t'i referohen kryesisht programeve dhe teksteve të mëparshme.
- Mungon mekanizmi i vlerësimit (validimit) të kurikulave të hartuara kundrejt kërkesave të profesionit përkatës.
- Mungon (pothuajse fare) monitorimi i zbatimit të kurikulave, në të gjitha nivelet.

Nga analiza e tipareve të kurikulave të AFP, nisur nga kritere strukturore dhe metodologjike, ato mund grupohen në disa modele kurikulare, si më poshtë:

1. Kurikul tradicional (lëndor).
2. Kurikul me dy nivele lëndore.
3. Kurikul me dy nivele modulare.
4. Kurikul me dy nivele i kombinuar (lëndor e modular).]



Modelet Kurikulare të AFP-së

B. Rezultate të veçanta, për secilin model kurikular në AFP.

Përveç tipareve të përgjithshme, të përmendura më lart, secili prej modeleve të ndryshme kurikulare të AFP-së, kanë edhe tipare të veçanta:

1. Kurikuli tradicional

Ky kurikul zë një hapësirë relativisht të madhe zbatimi në shkollat profesionale, ndërsa në qendrat e formimit profesional, zyrtarisht nuk është në zbatim.

a) Në lidhje me **strukturën** e pjesës profesionale të kurikullit tradicional:

- Përbëhet nga dy pjesë kryesore: Kurikuli qëndror (zyrtar) dhe Kurikuli shkollor.
- Kurikuli qëndror zë peshën më të madhe në dokumentacionin kurikular dhe përbëhet nga: Informacioni i përgjithshëm për kualifikimin, plani mësimor, programet e lëndëve të teorisë profesionale dhe programet e praktikave profesionale.
- Planu mësimor (në formë tabelore) përmban listën e lëndëve (të përgjithshme dhe profesionale) dhe të praktikave sipas viteve mësimore, si dhe shpërndarjen e ngarkesës kohore për secilën prej tyre.

- Programet e lëndëve dhe praktikave profesionale janë tematike (analitike), kanë strukturë të ngjashme dhe përmbajnë këto rubrika: emërtimin e lëndës/praktikës; klasën së cilës i referohet; kohëzgjatjet e përgjithshme sipas veprimtarive dhe sipas temave; synimet e lëndës; temat dhe nëntemat; kërkesat ndaj nxënësit për çdo temë dhe bazën materiale të nevojshme për çdo temë.
- Kurikuli shkollor zë një peshë të vogël në dokumentacionin kurikular. Ai përbëhet nga: (a) “Plani mësimor i lëndës” (lista e temave dhe nëntemave sipas orëve mësimore për çdo program mësimor), dhe (b) Ditari i mësuesit, me struktura të shumëllojshme.

b) Në lidhje me **përmbajtjen** e pjesës profesionale të kurikullit tradicional:

- Raportet e pjesëve të lëndëve akademike/lëndëve profesionale/praktikave profesionale janë pothuaj të njëjta për kualifikime të ndryshme të të njëjtit nivel: (a) Për nivelin e parë (3 vjeçar) këto raporte janë respektivisht: 33%/34%/33%, ndërsa (b) Për nivelin 5 vjeçar kanë më tepër variacion dhe janë afërsisht 40%/35%/25%.
- Ka mangësi në evidentimin e qartë të elementeve përmbajtësorë të materialit përkatës kurrkular.
- Raportet teori/praktikë nuk janë të ekuilibruara, i jepet përparësi teorisë.
- Vëllimet kohore të përmbajtjeve mësimore ekzistuese jo gjithmonë janë të përshtatshme.
- Shkalla e vështirësisë së përmbajtjeve mësimore është e lartë në krahasim me modelet e tjera.
- Ka pak hapësire për përditësimin e informacionit të ri bashkohor në lidhje me profesionin përkatës.

c) Në lidhje me **metodologjinë** e pjesës profesionale të kurikullit tradicional:

Hapat proceduralë dhe metodologjikë për realizimin e kurikullit tradicional janë:

- Porosi zyrtar nga SAP (Sektori i Arsimit Profesional në MASH) për hartimin e programeve të një me anë të së cilës jepet dhe plani mësimor i kualifikimit përkatës, që zakonisht hartohet në MASH.
- Punonjës shkencorë të DAP (Departamenti i Arsimit Profesional në IKS) angazhojnë grupet e punës, të përbëra nga mësues dhe instruktorë të përzgjedhur kryesisht nga shkollat më të mira profesionale.
- Këto të fundit udhëzohen për detyrën që u jepet dhe u ofrohen modele të programit mësimor. Herë pas here organizohen konsulta dhe diskutime të anëtarëve me punonjës shkencorë dhe specialistë të tjerë për të përgatitur draftet e para të programeve mësimore.
- Pasi draftet e para të programeve kontrollohen nga punonjësi shkencor dhe korrektohen/redaktohen në IKS, ato shtypen, shumëfishohen dhe dërgohen zyrtarisht në MASH për miratim.
- Komisionet përkatëse në MASH i miratojnë formalisht programet (ose i risjellin në IKS për përmirësime).
- Më pas, materialet kurikulare (planet dhe programet) shpërndahen në shkolla ku mësuesit, mbështetur në to, bëjnë zbatimin e tyre në nivel shkolle.

2. Kurikuli me dy nivele

Ky kurikul zë një hapësirë të madhe zbatimi në shkollat profesionale e sidomos në qendrat e formimit profesional dhe gjendet në tri nënmodele (forma): **(1) me dy nivele lëndor;** **(2) me dy nivele modular** dhe **(3) me dy nivele i kombinuar.**

a) Në lidhje me **strukturën** e pjesës profesionale të kurikullit me dy nivele në AP:

- Përbëhet nga dy pjesë kryesore: Kurikuli në nivel qendror (zyrtar) dhe Kurikuli në nivel ofruesi (shkolle profesionale dhe qendre formimi profesional).

- Kurikuli qendror zë një pjesë të konsiderueshme në dokumentacionin kurikular.
- Në rastin e **kurikutit lëndor me dy nivele**, që zbatohet në disa shkolla profesionale pilot, **kurikuli qendror**, që emërtohet si “skeletkurikul”, përbëhet nga: Informacioni i përgjithshëm për kualifikimin (qëllimet e përgjithshme të kualifikimit, profili profesional i kualifikimit, struktura e viteve shkollore, kriteret e përgjithshme të pranimit, plani mësimor, vlerësimi përfundimtar dhe certifikimi, synimet dhe përmbajtjet e përgjithshme të lëndëve profesionale e praktikave profesionale dhe udhëzime të përgjithshme didaktike). Plani mësimor (në formë tabelore) përmban listën e lëndëve (akademike dhe profesionale) dhe të praktikave profesionale sipas viteve mësimore, si dhe shpërndarjen e ngarkesës kohore për secilën prej tyre.
- Në rastin e **kurikutit modular me dy nivele**, kemi dy lloje që kanë ndryshime strukturore midis tyre:
 - (1) Që zbatohet në qendrat e formimit profesional, **me kurikul qendror** i cili përbëhet nga: (i) Programi i kursit me këto elemente: emërtimi dhe kodi i kursit, profili profesional i profesionistit përkatës, mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale, objektivat e përgjithshme të kursit, kohëzgjatja e kursit, kërkesat e pranimit, informacion për modulet e kursit, radha e trajtimit të moduleve dhe vlerësimi e certifikimi. (ii) Përshkruesit e moduleve të kursit, me këto elemente: titulli dhe kodi i modulit, qëllimi, kohëzgjatja e modulit, raporti kohor i veprimtarive, kërkesat e pranimit, rezultatet e të mësuarit dhe përmbajtja, procedurat e vlerësimit (instrumentet e vlerësimit dhe kriteret e realizimit), metodat e të mësuarit të rekomanduara dhe baza materiale e domosdoshme.
 - (2) Që zbatohet vetëm në Shkollën e Fermerëve në Shkodër, me kurikul qendror i cili përbëhet nga (i) Plani mësimor modular (lista e lëndëve akademike dhe e moduleve profesionale, ngarkesat kohore dhe shpërndarjet e tyre në vite mësimore). (ii) Përshkruesit e moduleve mësimore, me strukturë të ngjashme me ato që përdoren në kurikulat modulare të formimit profesional.
- Në rastin e **kurikutit të kombinuar me dy nivele**, kurikuli qendror (skeletkurikuli) përbëhet nga të njëjtat elemente sikurse skeletkurikuli i kurikutit lëndor me dy nivele. Por, duke qenë i kombinuar (lëndor dhe modular), ai përmban edhe synimet e përmbajtjet e përgjithshme të lëndëve të përgjithshme profesionale, si dhe përshkruesit e moduleve teorike-praktike. Të gjitha këto elemente janë të hartuara dhe të grupuara sipas tri niveleve të kualifikimit. Plani mësimor (në formë tabelore) të ky lloj kurikuli qendror përmban listën e lëndëve akademike, të lëndëve të përgjithshme profesionale dhe të moduleve teorike-praktike, si dhe shpërndarjen e ngarkesës kohore të tyre.

Përsa i përket **kurikutit në nivel ofruesi** (shkollë/qendre), në tri modelet e mësipërme vihen re elemente ndërtimore të përbashkëta por edhe të veçanta. Kështu, te kurikuli lëndor me dy nivele kemi:

(i) Programet shkollore të lëndëve dhe praktikave profesionale të cilat janë tematike (analitike), kanë strukturë të ngjashme dhe përmbajnë këto rubrika: emërtimin e lëndës teorike/praktike; klasën së cilës i referohet; synimet e lëndës; kohëzgjatjet e përgjithshme dhe sipas temave/veprimtarive; temat dhe nën temat; kërkesat ndaj nxënësit, metodat e të mësuarit, teknikat e vlerësimit dhe bazën materiale të nevojshme për çdo temë.

(ii) Ditarët e mësuesve, me strukturë të pa zyrtarizuar.

Ndërsa te kurikuli modular me dy nivele, si për shkollat ashtu edhe për qendrat, programet shkollore zëvendësohen nga “planet e instruksionit”, që kanë rubrika dhe struktura të pa zyrtarizuara.

Në mënyrë të ngjashme, edhe te kurikuli i kombinuar me dy nivele, hasen programe shkollore për lëndët teorike profesionale, plane instruksioni për modulet teorike/praktike, si dhe ditarë të mësuesit, me struktura të ngjashme si te nën-modelet e mësipërme.

Në shkollat profesionale, haset edhe një dokument tjetër kurikular i nivelit shkollor, i ashtuquajtur “plan mësimesor”, i cili është një listë temash mësimore me kohëzgjatjet përkatëse, sipas një modeli të kërkuar nga DAR-et ose ZA-të.

b) Në lidhje me përmbajtjen e pjesës profesionale të kurikullit me dy nivele në AP:

Nisur nga fakti që të gjitha modelet kurikulare me dy nivele të zhvilluara dekadën e fundit në Shqipëri kanë qenë pilotime të mbështetura edhe nga donatorët e ndryshëm, në to janë zbatuar metodologji kurikulare më të përparuara se sa te kurikuli tradicional. Ato kanë angazhuar më shumë aktorë, si dhe kanë pasqyruar më mirë realitetin profesional dhe kushtet reale të ofruesve të AFP. Për pasojë edhe përmbajtja e tyre, me ndryshime të vogla nga nënmodeli në nënmodel, ka tiparet e mëposhtme të cilat janë më të theksuara te kurikulat dynivelëshe modulare:

- Raporte të pranueshme dhe të individualizuara midis kulturës së përgjithshme dhe asaj profesionale, si dhe midis teorisë dhe praktikës.
- Shkallë relativisht të lartë integrimi lëndor dhe teori/praktikë.
- Referim më të madh ndaj kompetencave të punës së profesionit përkatës duke shmangur trajtimin tradicional të koncepteve të vështira shkencore.
- Përfaqësim më të madh të “kompetencave kyçe”.
- Mundësi të mira për përshtatje të përmbajtjeve dhe të vëllimeve kohore të tyre ndaj kërkesave lokale të tregut dhe mundësive reale të ofruesve.

Pavarësisht nga sa më sipër, mundësitë për përshtatje përmbajtësore që modeli kurikular dynivelësh i ka dhënë ofruesve të AFP-së, jo gjithmonë janë shfrytëzuar me efektivitet nga këta të fundit.

c) Në lidhje me metodologjinë e pjesës profesionale të kurikullit me dy nivele

Në përgjithësi, kurikulat dynivelëshe janë hartuar në kuadrin e projekteve pilote të mbështetura nga donatorët dhe hapat e ndjekura për hartimin e tyre janë:

- Vendimmarrje në MASH për kualifikimin dhe për modelin me të cilin do të hartohet kurikuli përkatës, pas propozimit nga projekti dhe shkollat ku do të zbatohet.
- Hartim të kurikullit qendror në kuadrin e projektit pilot, me angazhim të MASH, ISP/IKS dhe mësuesve të shkollave.
- Miratim të kurikullit qendror nga MASH.
- Hartim të kurikullit shkollor nga vetë shkollat, mbi bazën e kurikullit qendror (ka raste kur kurikuli shkollor hartohet nga mësuesit e një shkolle dhe u dërgohet edhe shkollave të tjera për të njëjtin kualifikim).
- Miratim i kurikullit shkollor në nivel shkolle (nga drejtori dhe kryetari i komisionit të kurikullit).
- Rishikim dhe miratim i përvitshëm i kurikullit në nivel shkolle.

Mbështetja me ekspertizë dhe ajo financiare e donatorëve ka bërë që metodologjia e hartimit të kurikulave dynivelëshe të vijë vazhdimisht duke u përmirësuar krahasuar me ato tradicionale. Pavarësisht nga veçoritë strukturore dhe metodologjike të nën-modeleve dynivelëshe, grupet e punës për kurikulat qendrore janë bërë më të gjera, me ndarje rolesh dhe me përfaqësim edhe të aktorëve nga bota e profesionit. Pothuaj gjithmonë, pikënisja e kurikullit ka qenë analiza e profesionit përkatës. Edhe për kurikulat shkollore ka pasur zhvillime metodologjike pozitive, ku ka mbizotëruar puna në grup, e drejtuar nga kryetarët e komisioneve të kurikulave në shkolla, specialistë të projekteve, të ISP/IKS ose të institucioneve të tjera.

Në të gjitha këto raste, kjo metodologji e pilotuar akoma nuk është institucionalizuar nga pikëpamja zyrtare.

7. Rekomandime për modelin kurikular të AFP-së në Shqipëri

Bazuar në analizën e mësipërme të modeleve kurikulare që veprojnë sot në AFP publik në Shqipëri, rekomandojmë sa më poshtë:

- ***Të konceptohet një model kurikular*** kombëtar për AFP publik. Për të pasqyruar dallimet që kanë midis tyre Arsimit Profesional dhe Formimit Profesional, propozohet që modeli kurikular të strukturohet në ***dy nënmodele***. Ato do të kenë të përbashkëta aspektet metodologjike, por do të ndryshojnë nga pikëpamja strukturore dhe përmbajtësore. Ky rekomandim bazohet në faktin se pilotimi dhe ekzistenca e shumë modeleve dhe nënmodeleve me karakteristika të ndryshme, ka sjellë konfuzion sidomos në nivelin e ofruesve të AFP-së.
- ***Të kalohet nga faza e pilotimit, në atë të institucionalizimit*** (zyrtarizimit) të dy nënmodeleve të reja kurikulare.
- Dy nënmodelet e reja kurikulare të AFP-së ***duhet të mbartin aspektet pozitive të modeleve të pilotuara më parë***, aspekte të cilat njëkohësisht duhet të jenë të harmonizuara midis tyre dhe në përshtatje me veçoritë e sektorit përkatës të AFP-së.
- Dy nënmodelet e reja ***duhet të kenë një koncept të gjerë kurikular***, pra të përmbajnë një tërësi elementesh kurikulare, si dhe të angazhojnë të gjithë aktorët e interesuar dhe partnerët nga bota e punës. Kjo do të mundësojë që kurikuli të shërbejë realisht si një “projekt pedagogjik” mbi bazën e të cilit ndërtohen të gjitha proceset e tjera mësimore.
- Dy nënmodelet duhet të kenë një ***strukturë dynivelëshe*** të përcaktuar qartë, me role dhe përgjegjësi të ndara, ku nivelit të ofruesit t’i jepet një hapësirë vendimmarrjeje dhe veprimi të konsiderueshme. Kjo do të rrisë autonominë dhe fleksibilitetin kurikular në nivel ofruesi. Kurikuli në nivel qendror (skeletkurikuli) për çdo kualifikim (drejtim/profil dhe nivel) do të shërbejë si standard kombëtar dhe si bazë për hartimin e kurikulit në nivel ofruesi (shkolle/qendre).
- Rekomandohet që njësia bazë e ndërtimit të kurikulave afatshkurtër të jetë “moduli mësimor” i cili është më i përshtatshëm për trajtimin e aspekteve praktike, karakteristike për sektorin e Formimit Profesional publik. Pra, ***nënmodeli për këtë sektor të jetë tërësisht me bazë modulare***.
- Ndërsa për sektorin e Arsimit Profesional publik, rekomandohet që ***nënmodeli të jetë i kombinuar***, pra të përmbajë lëndë mësimore për kulturën e përgjithshme dhe për aspektet e teorisë profesionale, si dhe module mësimore për aspektet e praktikës profesionale.
- Procesi i hartimit të kurikulit të AFP-së në të dy nivelet (sidomos në atë qendror) duhet të bazohet në një ***metodologji*** të përcaktuar mirë, që merr në konsideratë analizën e faktorëve të ndryshëm (sidomos analizën e profesionit) dhe parashikon përfshirjen e aktorëve të ndryshëm të interesuar në këtë proces, sidomos përfshirjen e partnerëve socialë. Kjo metodologji duhet të institucionalizohet, për më tepër në nivelin qendror të AFP publik.
- Për të mundësuar përshtatjen e kualifikimeve të Arsimit Profesional ndaj kërkesave lokale të tregut dhe mundësive reale të ofruesve, rekomandohet që ***përmbajtja*** e kurikulave të tyre të karakterizohet nga:
 - (i) formim profesional ***i gjerë*** (bazë) në nivele të ulëta dhe specializim gradual në nivele më të larta;
 - (ii) prirje për ***integrim*** midis lëndëve dhe midis teorisë e praktikës;

- (iii) prirje për referim ndaj kompetencave “*kyçe*” (që përgatisin për jetën dhe arsimimin e mëtejshëm) dhe kompetencave *profesionale* (që përgatisin për punësim);
 - (iv) kulturë e përgjithshme *unike dhe standarde* (nga pikëpamja përmbajtësore dhe kohore) për të gjitha drejtimet/profilet e të njëjtit nivel;
 - (v) raport teori profesionale/praktikë profesionale *të individualizuar*, pra që është i ndryshëm për nivele/drejtime/profile të ndryshme (por brenda disa kufijve të përcaktuar në nivel qendror).
- Rekomandohet që kurikuli në nivel ofruesi të hartohet bazuar në skeletkurikulin përkatës dhe të ketë një *strukturë të pranuar* edhe nga institucionet e tjera të angazhuara në AFP.

Bërja funksionale e një modeli kurikular me karakteristikat e mësipërme do të kërkojë dhe ndryshime të marrëdhënieve institucionale të angazhuarve, krijimin e mekanizmave të rinj sidomos në nivel ofruesi, ndryshimin e kuadrit ligjor/normativ përkatës, ndryshimin e procedurave financiare, etj.

Një model i tillë kurikular do t’i japë një shtysë edhe ndryshimeve të tjera të planifikuara dhe që janë në proces zbatimi në AFP në Shqipëri.

8. Referencat:

- Bejtja.P, Konini.M, Mustafai.A – “*Fjalor i termave të Arsimit dhe Formimit Profesional*” - Tiranë, 2002.
- Bejtja.P, Mustafai.A – “*Metoda modulare e të mësuarit*” – Gazeta “Mësuesi”, Tiranë, 1996
- Bejtja.P, Mustafai.A – “*Metoda modulare në arsimin dhe formimin profesional*” – “Revista Pedagogjike”, Tiranë, 1996.
- Curtis.F, Crunkilton.J - “*Curriculum development in vocational and technical education*”, 1999.
- Instituti i Kurikulave dhe Standardeve - Buletinet “*Arsimi dhe Formimi Profesional*”, Nr. 1 – 10 – Tiranë, 2003 – 2007.
- Ministria e Arsimit dhe e Shkencës – “Plane mësimore, programe mësimore dhe skeletkurikula për profile profesionale të ndryshme” - Tiranë.
- Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta – “Programe modulare për kurse trajnimi afatshkurtër” – Tiranë.
- Programi CARDS i BE – “Rekomandime për një model të ri të kurikulës së AFP në Shqipëri” – Tiranë, 2004.
- Scottish Vocational Education Council - “*A Guide for Teachers*”, Glasgow, 1992.
- Scottish Vocational Education Council - “*Guide to unit Writing*”, Glasgow, 1993.
- Technical Instructor Training Institute, Nepal – “*Fjalor për kurikulin, planifikimin, trajnimin*”, përkthim, Tiranë, 2002.
- Technical Instructor Training Institute, Nepal – “*Skill Cards*” – Nepal, 2001-2005.
- <http://www.bibb.com>
- <http://www.sqa.org.uk>
- <http://www.scotland.gov.uk>
- <http://www.sfeu.ac.uk>
- <http://www.fetac.ie>
- <http://www.etf.europa.eu>

PROPOZIM

Për një model unik të kurikulave të Arsimit dhe Formimit Profesional publik në Shqipëri.

Mars 2008

Sektori i SSTM

Përmbajtja

1. Hyrje
2. Nevoja për një model unik të kurikulave të AFP publik
3. Tiparet e modelit unik të kurikulave të AFP publik.
4. Struktura e modelit unik të kurikulave të AFP publik.
5. Metodologjia e hartimit të kurikulave të AFP publik.
6. Paraqitje tabelore e modelit të ri kurikular në AFP publik.
7. Kërkesat për futjen e modelit të ri kurikular në AFP publik.

1. Hyrje

Një nga detyrat e Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional (AKAFP) është dhe hartimi i Skeletkurikulave të AFP publik. Kjo detyrë do të përmbushet nga Sektori i Skeletkurikulave dhe Standardeve të Trajnimit të Mësuesve të AFP-së (SSTM) në këtë Agjenci.

Në këtë kontekst, Sektori i SSTM ka ndërmarrë nismën për konceptimin dhe propozimin e një modeli unik të kurikulave të AFP publik, që do të jetë objekt i veprimtarisë së Sektorit në këtë fushë.

Si bazë për konceptimin e këtij modeli janë marrë në konsideratë:

- (a) përvojat e mëparshme dhe ato aktuale të kurikulave të AFP-së në Shqipëri, përfshirë dhe pilotimet e viteve të fundit;
- (b) përvojat e ndryshme në drejtim të teorisë dhe praktikës së kurikulave të AFP-së në Evropë dhe më gjerë;
- (c) realiteti dhe perspektivat e ndryshimeve në AFP publik në Shqipëri, si dhe ndikimet tyre në kurikulat e AFP-së.

Një burim i fuqishëm informacioni dhe argumentesh në mbështetje të modelit unik kurikular që propozohet janë edhe raportet e tri studimeve të kryera paraprakisht nga Sektori i SSTM:

- (i) “Monitorimi i zbatimit të modelit të kurikulit të AFP”, pilotuar nga Programi CARDS i BE.
- (ii) Studimi për “Gjendjen e kurikulit të AFP publik në Shqipëri”.
- (iii) Studimi për “Modelet kurikulare të AFP në botë”.

Për përgatitjen e këtij propozimi janë shfrytëzuar dhe informacione të tjera nga botime, dokumente zyrtare, interneti, si dhe nga kontaktet direkt me të angazhuar të ndryshëm në AFP në Shqipëri (drejtues dhe specialistë të dikastereve dhe institucioneve mbështetëse të AFP, drejtues, mësues, instruktorë, nxënës/kursantë të shkollave/qendrave të AFP, partnerë socialë dhe ekspertë ndërkombëtarë).

Ky model trajtohet në tri këndvështrime: (i) koncepti kurikular; (ii) struktura kurikulare dhe (iii) metodologjia për hartimin e kurikulit.

Për të pasqyruar dallimet që kanë midis tyre Arsimit Profesional dhe Formimit Profesional, modeli kurikular unik që propozohet për AFP publik në Shqipëri është i strukturuar në dy

nënmodele që do të kenë të përbashkëta aspektet metodologjike, por do të ndryshojnë nga pikëpamja strukturore dhe përmbajtësore.

2. Nevoja për një model unik të kurikulave të AFP publik

Në strukturën dhe përmbajtjen e tregut të punës së vendit tonë po ndodhin ndryshime të shpejta, të cilat ndikojnë dukshëm edhe në sistemin e AFP-së, i cili duhet të jetë gjithnjë e më fleksibël dhe i orientuar nga nevojat, për t'iu përshtatur këtyre ndryshimeve.

Vitet e fundit janë kryer disa pilotime në drejtim të përmirësimit të sistemit të AFP, të cilat janë fokusuar kryesisht në aspektet e ndryshme të kurikulave përkatëse. Pavarësisht ndikimeve pozitive që këto pilotime kanë pasur, grupi studimor që ka përgatitur këtë propozim mendon se ***ka nevojë për konceptimin dhe zbatimin e një modeli unik të kurikulave të AFP publik në Shqipëri***. Këtë propozim grupi studimor e mbështet në argumentet e mëposhtme:

- pilotimet e kryera në drejtim të kurikulave, përgjithësisht kanë qenë afatshkurtër dhe në shumë raste nuk kanë siguruar vazhdimësi të efekteve pozitive, të cilat kanë ardhur duke u “shuar” pas përfundimit të veprimtarisë nga projekti;
- modelet kurikulare të pilotuara zakonisht kanë pasur fushë veprimi të kufizuar, pra në një apo disa shkolla/qendra, ose në një apo disa profile mësimore/kurse dhe pjesa më e madhe e sektorit të AFP-së ka ngelur jashtë këtyre zhvillimeve;
- pjesa më e madhe e shkollave profesionale ende përdorin modelin “tradicional” të kurikulave që bart shumë probleme;
- pilotimet e kryera kanë zhvilluar modele kurikulare me koncepte, struktura dhe metodologji të ndryshme, të cilat në shumë raste kanë krijuar paqartësi dhe vështirësi në zbatim;
- në disa raste, modelet kurikulare të suksesshme diku tjetër, kanë hasur vështirësi dhe pengesa gjatë pilotimit në AFP shqiptar, për shkak të veçorive që ka ky sistem në vendin tonë;
- zgjatja e arsimit të detyruar nga 8, në 9 vite mësimore ka imponuar ndryshime të konsiderueshme në strukturat dhe përmbajtjet e Arsimit Profesional, të cilat kërkojnë dhe rikonceptimin e kurikulave përkatëse;
- nisma për institucionalizimin e një Kornize Shqiptare të Kualifikimeve (përfshirë dhe kualifikimet profesionale) në kontekstin e një Kornize Evropiane të Kualifikimeve, kërkon që edhe kurikulat e AFP-së të rikonceptohen për t'iu përshtatur më mirë këtyre zhvillimeve rajonale dhe Evropiane;
- krijimi i Agjencisë Kombëtare të AFP-së me përgjegjësi të drejtpërdrejtë në “hartimin e skeletkurikulave të AFP-së”, që nënkupton edhe konceptimin e një modeli dynivelësh (me skeletkurikula dhe kurikula shkollore) të kurikulave të AFP-së;
- krijimi i Sektorit të Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale në AKAFP, i cili po harton përshkrime të kualifikimeve, dokumente këto, që janë të përfshira në modelet kurikulare ekzistuese dhe duhet të mos përfshihen në modelin që propozohet;
- konceptimi dhe zbatimi i një modeli unik të kurikulave të AFP publik do të lehtësojë veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të AFP-së dhe të aktorëve të tjerë, si nga pikëpamja metodologjike, ashtu edhe nga pikëpamja e burimeve;
- një model unik i kurikulave të AFP publik do të institucionalizojë vendosjen e një koncepti dhe kuptimi të përbashkët të kurikulave të AFP-së në Shqipëri, duke pakësuar paqartësinë e aktorëve të ndryshëm në këtë drejtim;

- një model unik i kurikulave të AFP publik do të institucionalizojë përfshirjen e aktorëve të ndryshëm në procesin kurikular, sidomos të atyre aktorëve që përfaqësojnë interesat e botës së punës;
- një model unik i kurikulave të AFP publik do të institucionalizojë rritjen e autonomisë kurikulare të shkollave/qendrave profesionale dhe do të përmirësojë përshtatshmërinë e kurikulave kundrejt nevojave lokale dhe kushteve konkrete;
- një model unik i kurikulave të AFP publik do të institucionalizojë një metodologji kurikulare (të paktën në nivel qendror) e cila do të pasqyrojë arritjet më pozitive në këtë drejtim;
- një model unik i kurikulave të AFP publik do të institucionalizojë struktura kurikulare të AFP-së që do të jenë në përputhje me strukturat e kualifikimeve profesionale të zyrtarizuara;
- një model unik i kurikulave të AFP publik do të krijojë hapësira të mjaftueshme për autonomi strukturore, metodologjike dhe përmbajtësore, për shkollat/qendrat profesionale publike dhe sektorin e AFP jopublik;
- një model unik i kurikulave të AFP publik do të përmirësojë tiparet e vlerësimit të nxënësve/kursantëve duke e bërë atë më të orientuar nga “kriteret”, si dhe do të rrisë reputacionin dhe njohjen e certifikatave të AFP-së;
- një model unik i kurikulave të AFP publik do të formalizojë procedurat financiare (aktualisht, të ndryshme për modele të ndryshme) si dhe supozohet që do të lehtësojë shpenzimet publike për këtë proces;
- një model unik i kurikulave të AFP publik do të lehtësojë procedurat e akreditimit të ofruesve të AFP-së duke ndihmuar aspektet e garantimit të cilësisë në këtë sektor;
- një model unik i kurikulave të AFP publik do të kontribuojë në rritjen e transparencës së certifikatave të AFP-së, si dhe në procesin e njohjes dhe integritet të AFP- së shqiptar në kuadrin e zhvillimeve rajonale dhe evropiane.

Në përgjithësi, zbatimi i një modeli unik për kurikulat e AFP publik do të synojë të shmangë dhe problematikën që, në shkallë të ndryshme, shfaqet në modelet që zbatohen aktualisht në këtë sektor. Kjo do të ndikojë që AFP-ja në Shqipëri të bëhet më i orientuar nga kërkesat e tregut për kompetenca pune, duke krijuar mobilitet më të madh të brendshëm dhe të jashtëm. Në këtë mënyrë AFP do të bëhet më tërheqës dhe me akses për të gjitha kategoritë e interesuara.

Modeli kurikular i AFP publik që propozohet më poshtë është në përputhje të plotë edhe me objektivat e Strategjisë Kombëtare të AFP-së në Shqipëri.

3. Tiparet e modelit unik të kurikulave të AFP publik

Mbështetur në përvojat pozitive të modeleve aktuale të AFP-së në Shqipëri (përfshirë dhe pilotimet), në përvojat pozitive të vendeve të tjera në këtë fushë, si dhe duke konsideruar gjendjen dhe prirjet e zhvillimit të këtij sektori në vendin tonë, grupi i punës propozon që modeli unik kurikular i AFP publik të karakterizohet nga këto tipare kryesore:

koncept kurikular relativisht i gjerë, që nuk kufizohet vetëm me trajtimin e përmbajtjeve mësimore (programet lëndore apo modulet), por konsiderohet si një projekt pedagogjik i plotë, duke përfshirë dhe mjaft elemente të tjera kurikulare. Gjithashtu, hartimi i kurikulit shihet si një proces i vazhdueshëm dhe jo si një akt i vetëm, me përfshirje të shumë aktorëve dhe faktorëve;

- **strukturë** kurikulare **dynivelëshe**: (a) nivelin qendror që përfaqësohet nga dokumente kurikulare të standardizuara dhe normative, dhe (b) nivelin e ofruesit që bazohet në nivelin qendror, si dhe e zbërthen/përshtat atë sipas kërkesave dhe kushteve specifike;
- **referencë** e fuqishme ndaj nevojave për kualifikime profesionale si dhe zhvillimeve në tregun e punës. Kjo do të bëjë që kurikulat e AFP-së të jenë më tepër të orientuara nga “**output-et**”, pra nga kompetencat e punës, standardet e punës dhe veprimtaria praktike;
- **referencë** ndaj “**kompetencave kyçe**” që synojnë njëkohësisht si formimin profesional, ashtu edhe formimin e përgjithshëm të nxënësve për të përballuar sfidat e jetës;
- **kalim gradual** nga formimi profesional bazë në nivele të ulëta, drejt formimit profesional më të specializuar në nivele të larta;
- **fleksibilitet** kurikular i konsiderueshëm për të krijuar mundësi të gjera përzgjedhjeje dhe **mobiliteti** vertikal dhe horizontal në strukturat e sistemit të AFP-së;
- **përshtatshmëri** kurikulare e lartë, pra, bazuar në dokumentet kurikulare standarde të nivelit qendror, ofruesit e AFP të kenë **pavarësi** që të hartojnë programe në përputhje me nevojat lokale dhe me kushtet reale për zbatim;
- **fokusim** më i madh te **arritjet** e nxënësve dhe **vlerësimi** i tyre, sidomos te dokumentet kurikulare të nivelit qendror;
- **organizim modular** i pjesës së kurikulit që u referohet kompetencave profesionale praktike, duke ruajtur strukturën lëndore për aspektet teorike të tij;
- **proces** kurikular **ciklik**, i bazuar në **analizën e profesioneve** dhe me përfshirje të aktorëve të interesuar, si nga sfera e arsimit, ashtu dhe bota e punës;
- **formate unike** (standarde) të dokumenteve kurikulare në nivel qendror dhe formate të **shumëllojshme** (të pastandardizuara) të dokumenteve në nivel ofruesi të AFP.

Këto tipare do të mishërohen në konceptin, strukturën, metodologjinë dhe përmbajtjen e modelit kurikular që propozohet për AFP publik në Shqipëri

4. Struktura e modelit unik kurikular të AFP publik

Në mënyrë që kurikuli i AFP publik në Shqipëri të bartë tiparet e mësipërme, grupi i punës propozon që formati i tij të jetë i strukturuar si më poshtë:

➤ Të jetë i ndarë në dy nivele:

(a) **Kurikuli i nivelit qendror**: Përbëhet nga dokumente që përfaqësojnë “standardin kombëtar” për kualifikimin përkatës dhe që shërbejnë si bazë për hartimin e dokumenteve kurikulare në nivel ofruesi. Ndahet në dy pjesë kryesore:

(i) Korniza kurikulare, që përmban informacionin thelbësor, të përbashkët për të gjitha kualifikimet profesionale të një niveli të caktuar të kornizës së kualifikimeve profesionale. Përbëhet nga informacione kurikulare të standardizuara dhe normative, detyruese për të gjitha kualifikimet profesionale të këtij niveli. Të tilla janë: qëllimet e kualifikimeve të nivelit, kriteret e pranimit, kohëzgjatjet, raportet kulturë e përgjithshme/kulturë profesionale, përmbajtjet e kulturës së përgjithshme, sistemi i vlerësimit dhe provimeve, certifikatat, etj.

(ii) Skeletkurikuli, për një kualifikim të caktuar në një nivel të dhënë, që mbështetet në kornizën kurikulare përkatëse dhe përmban informacionin kurikular thelbësor dhe të standardizuar, për këtë kualifikim. Është i fokusuar kryesisht te arritjet e nxënësve/kursantëve. Të tilla informacione janë: Qëllimet e kualifikimit, profili profesional i nxënësit/kursantit në përfundim të kualifikimit, mundësitë e punësimit dhe arsimimit të mëtejshëm, plani mësimor (lëndët, modulet dhe shpërndarjet kohore të tyre), programet e

përgjithshme të lëndëve teorike profesionale, përshkruesit e moduleve praktike, udhëzime për mësimdhënien, vlerësimin, provimet dhe certifikimin, etj.

(b) **Kurikuli në nivel ofruesi** (shkolle/qendre): Përbëhet nga dokumente kurikulare që mbështeten në kurikulin qendror të kualifikimit dhe e zhvillojnë atë më tej, duke iu referuar kryesisht aspekteve përmbajtësore dhe didaktike. Këto dokumente kurikulare janë:

(i) Programet e hollësishme të lëndëve të teorisë profesionale.

(ii) Planet e instruksionit të moduleve praktike.

Ato pasqyrojnë veçoritë rajonale në lidhje me profesionet përkatëse si dhe kushtet konkrete të shkollës/qendrës përkatëse.

➤ **Të jetë i strukturuar në dy nën-modele:**

Sa më sipër i referohet kryesisht strukturës kurikulare të kualifikimeve profesionale afatgjata, që përfshihen në sistemin e Arsimit Profesional. Për të pasqyruar veçoritë e kualifikimeve profesionale (kurseve) afatshkurtër që përfshihen në sistemin e Formimit Profesional, formati i mësipërm do të ketë disa ndryshime, të cilat çojnë në krijimin e dy nën-modele strukturore.

(a) Nën-modeli për **kualifikimet afatgjata** (i përshkruar më sipër).

(b) Nën-modeli për **kualifikimet afatshkurtër**. Ndahet në dy pjesë kryesore:

(i) Kurikuli në nivel qendror, përbëhet nga: (i) Programi përgjithshëm i kursit (profili profesional - karakteristikat kryesore dhe mundësitë e punësimit, objektivat e kursit, kohëzgjatja, kërkesat e pranimi, informacion për modulet e kursit, radha e moduleve, vlerësimi dhe certifikimi), dhe (ii) Përshkruesit e moduleve të kursit.

(ii) Kurikuli në nivel qendre formimi, përbëhet nga planet e instruksionit të moduleve përkatëse.

➤ **Kurikulat afatgjata (dhe afatmesme), të jenë me strukturë lëndore-modulare:**

Kurikulat afatgjata (shkollimet profesionale) do të jenë të kombinuara, pra do të kenë për bazë dy lloje elementesh kurikulare:

(i) Programet e lëndëve mësimore teorike (të përgjithshme dhe profesionale). Struktura e programeve të lëndëve të përgjithshme (akademike) do të përcaktohet nga MASH. Programet e lëndëve të teorisë profesionale, në nivel ofruesi, do të përbëhen nga: emërtimi dhe kodi, hartuesi dhe miratuesi, drejtimi, profili, niveli, klasa, synimet e përgjithshme të lëndës, kohëzgjatja e lëndës, temat e lëndës (çështjet, kohëzgjatjet, objektivat, metodat e mësimdhënies, instrumentet e vlerësimit, si dhe kushtet për çdo temë).

(ii) Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale, në nivel qendror, do të përbëhen nga: emërtimi dhe kodi, hartuesi dhe miratuesi, drejtimi, profili, niveli, klasa, qëllimi, kohëzgjatja, kërkesat e pranimi, rezultatet e të mësuarit dhe përmbajtjet/procedurat e vlerësimit për çdo rezultat, udhëzime metodologjike dhe kushtet.

➤ **Kurikulat afatshkurtër, të jenë me strukturë modulare:**

Këto kurikula do të jenë të ndërtuara nga module mësimore praktike-teorike, dhe përshkruesit e moduleve do të jenë me strukturë të njëjtë me ato të moduleve për kualifikimet afatgjata (shih më sipër).

Për më tepër hollësi në lidhje me strukturën e modelit kurikular që propozohet për AFP publik në Shqipëri, shih edhe Tabelën në vijim.


5. Metodologjia modelit unik kurikular të AFP publik

Pavarësisht veçorive strukturore dhe përmbajtësore që kanë dy nën modelet kurikulare të AFP që propozohen, procesi i hartimit të tyre nuk ka ndryshime të dukshme nga pikëpamja metodologjike. Pasi ka analizuar teoritë dhe përvojat praktike në lidhje me ecuritë metodologjike në lidhje me hartimin e kurikulave të AFP, grupi studimor propozon ecurinë e mëposhtme, që në literaturë njihet me emërtimin **Modeli PADDIE**. Ky model metodologjik kalon në gjashtë faza dhe procese kryesore, të cilat i japin edhe emrin atij:

1. Faza e planifikimit (**P**lanning)
2. Faza e analizës (**A**nalysis).
3. Faza e skicimit (**D**esign).
4. Faza e hartimit (**D**evelopment).
5. Faza e zbatimit (**I**mplementation).
6. Procesi i vlerësimit (**E**valuation).

Akronimi **PADDIE** është krijuar nga bashkimi i shkronjave të para të secilës prej këtyre fazave (në gjuhën angleze).

Paraqitje skematike e procesit PADDIE



Më poshtë bëhet një përshkrim më i detajuar i secilës fazë të modelit metodologjik PADDIE për hartimin e kurikulave të AFP-së.

1. **Planifikimi** i procesit të hartimit të kurikulit të AFP-së konsiderohet si fazë paraprake dhe përgatitore. Gjatë kësaj faze planifikohen aspektet organizative, burimet njerëzore dhe materiale, aspektet kohore, etj. Ky planifikim bëhet i nevojshëm edhe për faktin se hartimi i kurikulit të plotë për një kualifikim profesional konsiderohet një sipërmarrje që kërkon kohë, burime njerëzore, burime materiale dhe financime të konsiderueshme.

2. **Analiza** është njëra prej fazave më kritike të hartimit të kurikulit të AFP-së. Nëpërmjet këtij procesi bëhet:

i) Analizimi i nevojave për kualifikimin profesional në fjalë, si dhe marrja e vendimit nëse duhet ofruar ky kualifikim ose jo.

ii) Analizimi i profesionit përkatës (funksionet, detyrat, mjetet, etj.) dhe përcaktimi i detyrave më të rëndësishme që do të përmbushë profesionisti i ardhshëm, i standardeve të realizimit, i kushteve të realizimit dhe i kritereve të tjera që nevojiten për përmbushjen e çdo detyre pune. Me fjalë të tjera, analiza e profesionit përcakton kompetencat që duhet të përvetësohen gjatë kualifikimit. Rekomandohet që në mungesë të burimeve të tjera të informacionit, të hartohen analiza profesioni me metodën DACUM. Rezultatet e kësaj analize shërbejnë si bazë për proceset e mëtejshme.

iii) Analizimi i kurikulave të mëparshme dhe kurikulave të vendeve të tjera, si dhe i burimeve të tjera të informacionit për këtë kualifikim profesional.

iv) Analizimi i informacionit të Kornizës kurikulare për nivelin në të cilin bën pjesë kualifikimi profesional i dhënë.

v) Analizimi i përshkruesve të kualifikimit profesional të dhënë.

vi) Analizimi i faktorëve të ndryshëm, që supozohet se ndikojnë në kurikulin që do të hartohet (kushtet e shkollave, moshë e nxënësve, niveli i mësuesve, struktura e kualifikimeve, mundësitë e shkollimit të mëtejshëm, etj).

3. **Skicimi**, bazohet në rezultatet e fazës së analizës dhe përcakton:

a) Elementet bazë të Skeletkurikulit, për kualifikimin profesional afatgjatë.

b) Elementet bazë të Programit të përgjithshëm të kursit, për kualifikimin afatshkurtër.

Pra, skicimi është fazë që zbatohet për hartimin e kurikulave të nivelit qendror. Referuar strukturave të kurikulave qendrore, të përshkruara më lart, gjatë fazës së skicimit përgjithësisht kryhen veprimet e mëposhtme:

- Saktësohet emërtimi i kualifikimit profesional të dhënë.
- Formulohen qëllimet e përgjithshme të kualifikimit.
- Përcaktohen kërkesat e pranimit.
- Përcaktohen mundësitë e punësimit dhe të shkollimit të mëtejshëm.
- Përcaktohen kompetencat e përgjithshme dhe kompetencat profesionale.
- Përcaktohen raportet teori profesionale/praktikë profesionale.
- Hartohet drafti i parë i planit mësimor për kualifikimet afatgjata, si dhe drafti i parë i programit të përgjithshëm të kursit, për kualifikimet afatshkurtër.
- Hartohen objektivat dhe temat kryesore të lëndëve si dhe përcaktohen rezultatet mësimore të moduleve profesionale.
- Formulohen rekomandime që kanë të bëjnë me organizimin dhe kushtet e procesit mësimor dhe të procesit të vlerësimit të nxënësve.

Duhet theksuar që të gjitha elementet e hartuara në fazën e skicimit janë akoma jo-përfundimtare dhe do të marrin formën e plotë dhe përfundimtare vetëm në fund të proceseve të tjera.

4. Hartimi mbështetet në rezultatet e fazave të mëparshme të analizës dhe të skicimit. Në modelin kurikular që propozohet, hartimi kryhet nga vetë shkollat/qendrat, për kurikulat e nivelit të ofruesit. Në këtë fazë hartohen programet e detajuara të lëndëve teorike profesionale dhe planet e instruksionit të moduleve praktike. Kjo bëhet duke u mbështetur në dokumentet e hartuara në nivel qendror (Përshkruesi i kualifikimit përkatës, Korniza kurikulare e nivelit përkatës, Skeletkurikuli i kualifikimit përkatës ose Programi i përgjithshëm i kursit përkatës). Gjithashtu, merren në konsideratë kërkesat e tregut lokal të punës, si dhe kushtet konkrete të shkollës/qendrës. Më tej mund të hartohen planet ditore, javore dhe mujore, si dhe materiale të tjera mësimore, doracakë, udhëzues, teste, materiale mbështetëse audio-vizuale të tilla si pankarta, makete, transparente, kaseta video, etj.

5. **Zbatimi** i kurikulit nënkupton realizimin e procesit mësimor në shkolla/qendra, në përputhje me këtë kurikul (më saktësisht, në përputhje me kurikulin në nivel ofruesi). Gjatë kësaj faze verifikohet nëse funksionojnë siç duhet në praktikë ato që janë planifikuar në këtë projekt pedagogjik. Një pjesë e madhe e dokumenteve kurikulare, sidomos ato që përgatiten nga mësuesi ose instruktori, përgatiten gjatë fazës së zbatimit. Gjatë kësaj faze duhet të merret informacion i vazhdueshëm (feedback) për problemet që ndeshen, si dhe të merren masa për përmirësimin e kurikulit.

6. Vlerësimi i kurikulit nuk do të konsiderohet si një “fazë” e veçantë, por si një proces i vazhdueshëm i cili fillon që me fazën e analizës dhe vazhdon deri në zbatim, pra gjatë tërë ciklit të jetës së kurikulit të hartuar për kualifikimin profesional përkatës. Përgjithësisht, vlerësimi duhet të jetë i bazuar në kritere të paracaktuara. Informacioni i marrë nga procesi i vlerësimit do të shërbejë për të mundësuar përmirësimin e cilësisë së këtij kurikuli, në se do të rezultojë e nevojshme. Vlerësimi i kurikulit do të jetë jo vetëm i brendshëm (nga vetë hartuesit), por edhe jashtëm (nga institucione që nuk marrin pjesë në hartim). Prosesi i vlerësimit do të mbështetet edhe nga dy mekanizma të rëndësishëm:

(i) Validimi, (verifikimi i vlefshmërisë), me anë të cilit do të verifikohet nëse kurikuli i hartuar i përgatit nxënësit për ato kompetenca profesionale të cilat i kërkon tregu aktual dhe perspektiv i punës. Validimi do të jetë një lloj vlerësimi i jashtëm i bazuar në kritere, pra do të jenë specialistët e profesionit ata që do të gjykojnë nëse kurikuli duhet të zbatohet apo duhet të rishikohet. Për Skeletkurikulin e një kualifikimi, validimi do të bëhet në përfundim të draftit të hartuar, dhe do të shërbejë si bazë për miratimin ose rishikimin. Ndërsa për kurikulin në nivel ofruesi, validimi i një programi/plani instruksioni do të kryhet nga kryetari i departamentit mësimor, mësues dhe instruktorë të tjerë, ekspertë të profesionit, etj.

(ii) Miratimi, që do të jetë një akt zyrtar me anë të cilit një autoritet lejon zbatimin e kurikulit të hartuar, pasi procesi i validimit ka konfirmuar që ky kurikul i kënaq kriteret e paracaktuara. Ashtu sikurse validimi, edhe miratimi do të bëhet në dy nivele: (a) në nivel qendror, pra për Skeletkurikulin ose Programin e përgjithshëm të kursit, përkatësisht nga MASH dhe MPÇSSHB, dhe (b) Në nivel ofruesi, për programet/planet e instruksionit, nga drejtori i shkollës/qendrës dhe kryetari i Departamentit mësimor. Në përgjithësi, miratimi i dokumenteve kurikulare në AFP do të bëhet: (a) kur është hartuar rishtazi dhe parashikohet të zbatohet; (b) kur është rishikuar (ndryshuar) për arsye të ndryshme; (c) kur i ka mbaruar afati i vlefshmërisë pas miratimit të mëparshëm.

Sa më sipër paraqet procedurat metodologjike që propozohet të zbatohen kryesisht për hartimin e dokumenteve kurikulare të nivelit qendror. Për sa i përket kurikulave në nivel ofruesi, hartimi i tyre në thelb nuk ndryshon metodologjikisht me ato të nivelit qendror, megjithatë pavarësia e shkollave dhe qendrave nga kjo pikëpamje sigurisht që do të jetë më e madhe.

6. Paraqitje tabelore e modelit të ri kurikular në AFP publik.

Më poshtë bëhet një paraqitje në formë tabelore e modelit kurikular të AFP publik që propozohet, si dhe e ndërlidhjes midis elementeve/proceseve kurikulare dhe aktorëve që angazhohen në to.

MODELI KURIKULAR PER ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL PUBLIK

A. Paraqitje e nënmodelit kurikular të Arsimit Profesional (AP) Publik

| Elementi kurikular | Proceset | Aktorët |
|--|---|---|
| KORNIZA KURIKULARE (për nivelin përkatës) <ul style="list-style-type: none"> -Emërtimi i nivelit profesional. -Institucioni miratues dhe viti. -Qëllimet e kualifikimeve të nivelit. -Përshkrimi i nivelit. -Kriteret e pranimit. -Kohëzgjatjet e kualifikimeve të nivelit. -Raportet kulturë e përgjithshme/kulturë profesionale të kualifikimeve të nivelit. -Programet e detajuara të kulturës së përgjithshme. -Sistemi i vlerësimit dhe provimeve. -Të dhëna për certifikatat. -Të dhëna të tjera normative, etj. | <ul style="list-style-type: none"> -<u>Hartimi i Kornizës</u> - Analiza e tregut. - Analiza e KSHK. - Analiza e përshkrimit të nivelit në KSHK. - Analiza e nevojave të shoqërisë për kualifikime. - Analiza e programeve të cikleve të tjera arsimore. - Hartimi i qëllimeve të kualifikimeve të nivelit. - Hartimi i programeve të kulturës së përgjithshme. - Përcaktimi i aspekteve normative të kornizës. - Validimi dhe miratimi. | <ul style="list-style-type: none"> - Grup pune i veçantë nga MASH (pjesëmarrës nga MASH, AKAFP, IKT, AVA, universitetet, shkollat, partnerë socialë, etj). |

| Elementi kurikular | Proceset | Aktorët |
|--|---|--|
| SKELETKURIKULI (për një kualifikim) <ul style="list-style-type: none"> Emërtimi i kualifikimit profesional (drejtimi, profili, niveli dhe kodë përkatës). Institucionet hartuese dhe miratuese, si dhe viti i miratimit. Qëllimet e kualifikimit profesional. Profili profesional i nxënësit në përfundim të kualifikimit (kompetencat profesionale dhe ato të përgjithshme). Kërkesat e pranimit. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm. Plani mësimor (lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale, modulet praktike dhe shpërndarjet kohore të tyre) Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale: <ul style="list-style-type: none"> - <i>Emërtimi i lëndës dhe kodi.</i> - <i>Kohëzgjatja e lëndës (për çdo klasë).</i> - <i>Synimet e përgjithshme të lëndës.</i> - <i>Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës (temat) dhe kohëzgjatjet e rekomanduara për çdo temë.</i> | <ul style="list-style-type: none"> <u>Hartimi i Skeletkurikut:</u> - Analiza e përshkrimit të profesionit përkatës. - Analiza e përshkrimit të nivelit përkatës në KSHK. - Analiza e programeve të tjera, të ngjashme. - Hartimi i qëllimeve të kualifikimit. - Hartimi i profilit profesional. - Hartimi i planit mësimor - Përpilimi i kërkesave të pranimit, mundësive të punësimit dhe arsimimit. - Hartimi i programeve të përgjithshme të lëndëve. - Hartimi i përshkruesve të moduleve praktike. - Përpilimi i kriterëve të vlerësimit dhe provimeve. - Hartimi i udhëzimeve | <ul style="list-style-type: none"> - Grup pune i AKAFP (koordinator, moderator, mësues, instruktorë, konsulentë). |

| | | | |
|--|---|--|--|
| | Përshkruesit e moduleve praktike: <ul style="list-style-type: none"> - <i>Emërtimi i modulit dhe kodi.</i> - <i>Drejtimi, profili, niveli, klasa.</i> - <i>Institucionet hartuese/miratuese, viti.</i> - <i>Qëllimi i modulit.</i> - <i>Kohëzgjatja e modulit.</i> - <i>Niveli i parapëlqyer për pranim.</i> - <i>Rezultatet e të mësuarit (RM).</i> - <i>Përmbajtjet, instrumentet dhe kriteret e vlerësimit për secilin RM.</i> - <i>Udhëzime për zbatimin e modulit.</i> - <i>Kushtet për zbatimin e modulit.</i> | didaktike. <ul style="list-style-type: none"> - Përpilimi i kushteve të duhura për zbatim. | <ul style="list-style-type: none"> - Specialistë të profesionit (AKAFP). - Specialistë të kurikulave të AP (MASH). |
| | Kriteret për vlerësimin dhe provimet. | - <u>Validimi i skelet-kurikulit.</u> | |
| | Të dhëna për certifikatën që jepet. | - <u>Miratimi i skelet-kurikulit.</u> | |
| | Udhëzime të përgjithshme didaktike. | | |
| | Kushtet e përgjithshme për realizimin. | | |

| Elementi kurikular | | Proceset | Aktorët |
|---|---|--|--|
| KURIUKLI SHKOLLOR (për një kualifikim) | Programet e detajuara të lëndëve teorike profesionale: <ul style="list-style-type: none"> - <i>Shkolla që e zbaton.</i> - <i>Mësuesi i lëndës, që e zbaton.</i> - <i>Miratuesit dhe viti shkollor.</i> - <i>Emërtimi i lëndës, kodi, niveli, drejtimi, profili, klasa.</i> - <i>Kohëzgjatja e lëndës.</i> - <i>Synimet e përgjithshme të lëndës (sipas skeletkurikulit).</i> - <i>Temat dhe kohëzgjatjet përkatëse.</i> - <i>Objektivat e çdo teme.</i> - <i>Çështjet (nën temat) e çdo teme dhe kohëzgjatjet përkatëse.</i> - <i>Metodat e rekomanduara dhe kushtet e nevojshme për çdo temë.</i> | <u>Hartimi i programeve të detajuara të lëndëve profesionale:</u> <ul style="list-style-type: none"> - Analiza e skelet-kurikulit. - Analiza e burimeve të tjera të informacionit. - Analiza didaktike e lëndës. <u>Miratimi i i programeve të detajuara të lëndëve profesionale.</u> | <ul style="list-style-type: none"> - Mësuesi/grupi i mësuesve që trajtojnë lëndën. - Konsulentë. - Drejtori i shkollës. - Kryetari Departamentit Mësimor. |
| | Planet e instruksionit (mësimdhënies) për çdo modul praktik: <ul style="list-style-type: none"> - <i>Emërtimi i modulit dhe kodi.</i> - <i>Hartuesi dhe miratuesi (viti).</i> - <i>Niveli, drejtimi, profili, klasa.</i> - <i>Rezultatet e të mësuarit (RM)</i> - <i>Veprimtaritë mësimore për çdo RM dhe kohëzgjatjet përkatëse.</i> - <i>Metodat mësimore dhe të vlerësimit për çdo veprimtari mësimore</i> - <i>Kushtet konkrete për realizimin e çdo veprimtarie mësimore.</i> | <u>Hartimi i planeve të instruksionit për modulet praktike:</u> <ul style="list-style-type: none"> - Analiza e skelet-kurikulit. - Analiza e i burimeve të tjera të informacionit. - Analiza didaktike e përshkruesit të modulit. <u>Miratimi i planeve të mësimdhënies për modulet praktike.</u> | <ul style="list-style-type: none"> - Mësuesi/grupi i mësuesve që trajtojnë modulin. - Konsulentë. - Drejtori i shkollës. - Kryetari Departamentit Mësimor. |

B. Paraqitje e nën modelit kurikular të Formimit Profesional (FP) Publik

| Elementi kurikular | | Proceset | Aktorët |
|--|--|---|--|
| PROGRAMI I PERGJITHSHEMI I KURSIT | <p><u>Përshkrimi i përgjithshëm i kursit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Emërtimi i kursit profesional dhe kodi përkatës. - Institucionet që e hartojnë/miratojnë dhe viti. - Profili profesional i kursantit - Mundësitë e punësimit dhe formimit të mëtejshëm. - Qëllimet e kursit. - Kohëzgjatja e kursit. - Kërkesat e pranimit në kurs. - Informacion për modulet e kursit (emërtimi, kodi, kohëzgjatja, rezultatet mësimore). - Radha e realizimit të moduleve. - Informacion për vlerësimin dhe certifikimin. | <p><u>Hartimi i Përshkrimit të përgjithshëm të kursit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Analiza profesionit përkatës (analiza e punës). - Analiza e detyrave të punës. - Analiza didaktike. | <ul style="list-style-type: none"> - Grup pune nga MPÇSSHB, AKAFP ose të tjerë (koordinator, moderator, instruktorë, konsulentë). |
| | <p><u>Përshkruesit e moduleve praktike:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Emërtimi i modulit, niveli dhe kodi.</i> - <i>Institucionet hartuese/miratuëse, viti.</i> - <i>Qëllimi i modulit.</i> - <i>Kohëzgjatja e modulit.</i> - <i>Niveli i parapëlqyer për pranim.</i> - <i>Rezultatet e të mësuarit (RM).</i> - <i>Përmbajtjet, instrumentet dhe kriteret e vlerësimit për secilin RM.</i> - <i>Udhëzime për zbatimin e modulit.</i> - <i>Kushtet për zbatimin e modulit.</i> | <p><u>Hartimi i përshkruesve të moduleve praktike:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Analiza e Përshkrimit të përgjithshëm të kursit. - Analiza e moduleve të tjera të ngjashme. - Analiza e informacioneve të tjera. - Analiza didaktike e çdo moduli. <p>- <u>Validimi i Programit të përgjithshëm të kursit.</u></p> <p>- <u>Miratimi i Programit të përgjithshëm të kursit</u></p> | <ul style="list-style-type: none"> - Po i njëjti grup pune si më lart. - Konsulentë nga partnerët socialë. - MPÇSSHB ose SHKP |

| Elementi kurikular | | Proceset | Aktorët |
|---|--|---|--|
| KURIKULI NE NIVEL OFRUESI (qendre) | <p>Planet e instruksionit (mësimdhënies) për çdo modul:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Emërtimi i modulit dhe kodi.</i> - <i>Hartuesi dhe miratuesi (viti).</i> - <i>Niveli, drejtimi, profili, klasa.</i> - <i>Rezultatet e të mësuarit (RM)</i> - <i>Veprimtaritë mësimore për çdo RM dhe kohëzgjatjet përkatëse.</i> - <i>Metodat mësimore dhe të vlerësimit për çdo veprimtari mësimore</i> - <i>Kushtet konkrete për realizimin e çdo veprimtarie mësimore.</i> | <p><u>Hartimi i planeve të instruksionit për modulet:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Analiza e Përshkrimit të përgjithshëm të kursit. - Analiza e i burimeve të tjera të informacionit. - Analiza didaktike e përshkruesit të modulit. <p><u>Miratimi i planeve të instruksionit për modulet praktike.</u></p> | <ul style="list-style-type: none"> - Instruktori/grupi i instruktorëve që trajtojnë modulin. - Konsulentë. - Drejtori i qendrës. - Kryetari i Departamentit Mësimor. |

7. Kërkesat për futjen e modelit të ri kurikular në AFP publik.

Konceptimi i një modeli strukturor dhe metodologjik të ri për kurikulat e AFP publik në Shqipëri është vetëm hapi i parë dhe ndoshta më i lehti në procesin e reformës kurikulare. Zbatimi i këtij modeli të ri kërkon përmbushjen e disa kërkesave dhe kushteve që prekin aspekte të ndryshme, siç renditen më poshtë:

- a) Rishikimi, saktësimi dhe institucionalizimi i Listës Kombëtare të Profesioneve si dhe i përshkrimeve përkatëse, sipas niveleve dhe drejtimeve, bazuar në analizën e punës.
- b) Rishikimi, saktësimi dhe institucionalizimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve Profesionale (KKKP), si pjesë e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), që lidhen ngushtë me sistemin e certifikatave kombëtare për kualifikimet profesionale.
- c) Përcaktimi i strukturës së re të AP, pas ndryshimeve që do të sjellë rritja e kohëzgjatjes së arsimit të detyruar.
- d) Krijimi i mbështetjes së nevojshme institucionale nëpërmjet:
 - Fuqizimit të Sektorit të SSTM në AKAFP, si përgjegjës në nivel kombëtar për hartimin dhe rishikimin e Skeletkurikulave të kualifikimeve profesionale.
 - Fuqizimit të Sektorit të AP në MASH për të kryer dhe funksionet e miratimit të Skeletkurikulave profesionale në nivel qendror.
 - Fuqizimit të sektorëve të Trajnimit dhe Inspektimit në DAR-et dhe ZA-të me specialistë të AP-së.
 - Themelimit në shkollat profesionale të Departamenteve mësimore, me funksione kurikul zhvilluese (dhe trajnuese të mësuesve/instrukturëve), për të mundësuar hartimin dhe rishikimin e kurikulave të AP-së në nivel shkolle.
- e) Krijimi i kuadrit të nevojshëm ligjor/normativ/financiar nëpërmjet:
 - Përcaktimit të përgjegjësive institucionale, pjesërisht të paqarta, të institucioneve të ndryshme që veprojnë në drejtim të kurikulave të AFP-së.
 - Përgatitjes dhe vënies në funksionim të “Rregullores për strukturën dhe procedurat e hartimit, rishikimit dhe miratimit të kurikulave të kualifikimeve profesionale në nivel qendror”.
 - Përgatitja dhe vënia në funksionim e “Rregullores për strukturën dhe procedurat e hartimit, rishikimit dhe miratimit të kurikulave të kualifikimeve profesionale në nivel shkolle/qendre”.
 - Vënia në funksionim e “Rregullores financiare për hartimin, rishikimin dhe miratimin e kurikulave të AFP-së”.
 - Parashikimi nga dikasteret përgjegjëse i buxheteve publike për proceset e hartimit, rishikimit dhe miratimit të elementeve të modelit të ri kurikular.
- f) Zhvillimi i burimeve njerëzore të nevojshme nëpërmjet:
 - Trajnimit të koordinatorëve/moderatorëve të kurikulave të kualifikimeve profesionale në nivel qendror.
 - Trajnimit të drejtuesve të shkollave dhe qendrave si dhe kryetarëve të Departamenteve mësimore.
 - Trajnimit të mësuesve dhe instruktorëve në shkolla dhe qendra për të njohur, zhvilluar dhe zbatuar modelin e ri kurikular në nivel ofruesi.
 - Trajnimit të specialistëve të AP në DAR-et dhe ZA-të në lidhje me modelin e ri kurikular dhe zhvillimet në AFP.
 - Përgatitja e udhëzuesve metodologjikë dhe materialeve të tjera në mbështetje të angazhuarve me modelin e ri kurikular.

Këto janë vetëm disa nga kërkesat për zbatimin e një modeli kurikular modern në AFP dhe në mënyrë më të detajuar ato do të saktësohen “në punë e sipër”.

PROPOZIM

Për krijimin e Departamenteve Mësimore në Shkollat Profesionale

Qershor 2007

Alqi Mustafai, AKAFP

Nevoja për krijimin e Departamenteve Mësimore në shkollat profesionale.

Shumë nga nismat reformuese dhe pilotimet e zbatuara në Arsimin Profesional kanë pasur ndikime pozitive në procesin mësimor në shkollat profesionale, por vazhdimësia e tyre me përfundimin e mbështetjes nga donatorët, ka qenë e pa garantuar. Një nga arsytet ka qenë dhe mungesa e “mekanizmave” në nivel shkollor, që do të bartnin dhe bënë të mundur jetëgjatësinë e ndryshimeve pozitive të pilotuara.

Departamentet Mësimore do të jenë “njësi profesionale” në çdo shkollë profesionale dhe do të përbëhen nga mësuesit dhe instruktorët që trajtojnë lëndë, module dhe praktika mësimore profesionale të një drejtimi/profilu mësimor të caktuar.

Departamenti Mësimor do të jetë njësi bartëse dhe zbatuese e ndryshimeve reformuese që kanë të bëjnë me procesin mësimor, të fokusuara kryesisht në aspektet **kurikulare** dhe aspektet e **trajnitit të vazhdueshëm** (in-service) të anëtarëve të Departamentit.

Departamenti Mësimor i shkollës profesionale do të drejtohet nga **Përgjegjësi i Departamentit Mësimor**, i cili është mësues i shkollës që do të ketë status, funksione dhe detyra të përcaktuara.

Krijimi dhe funksionimi i Departamentit Mësimor në shkollën profesionale bëhet në përputhje me kuadrin ligjor/normativ dhe Rregulloren përkatëse.

Numri i Departamenteve Mësimore (dhe i përgjegjësve respektivë) bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara nga MASH.

Funksionet dhe detyrat e Përgjegjësit të Departamentit Mësimor.

Përgjegjësi i Departamentit Mësimor në shkollën profesionale do të kryejë këto **funksione** kryesore si dhe detyra që lidhen me to:

1. Koordinimin dhe moderimin e procesit të hartimit dhe të përshtatjes së vazhdueshme të kurikulit mësimor në nivel shkollor.

Për kryerjen e këtij funksioni, Përgjegjësi i Departamentit Mësimor do të përmbushë këto **detyra** që kanë të bëjnë me kurikulin shkollor që trajton Departamenti Mësimor përkatës:

- Të analizojë gjendjen dhe problematikën e kurikulit shkollor.
- Të analizojë gjendjen dhe prirjet e tregut lokal të punës, si dhe zhvillimet në profesionin/profesionet që trajton Departamenti Mësimor përkatës.
- Të njohë mësimdhënësit e Departamentit Mësimor si dhe drejtuesit e shkollës profesionale me gjendjen dhe problematikën e kurikulit shkollor, me prirjet e tregut lokal të punës, si dhe me zhvillimet në profesionet përkatëse.
- Të planifikojë dhe detajojë hapat e nevojshme për hartimin e kurikulit shkollor (veprimtaritë, produktet, përgjegjësitë, afatet, shpenzimet e nevojshme, etj.).
- Të koordinojë procesin e hartimit dhe përshtatjes së vazhdueshme të kurikulit shkollor.

- Të moderojë dhe mbështesë mësimdhënësit e tjerë të Departamentit Mësimor në procesin e hartimit dhe përshtatjes së vazhdueshme të kurikulave shkollore, bazuar në Skeletkurikulat, zhvillimet në profesionet përkatëse dhe kushtet e mundësitë e shkollës profesionale.
- Të mbajë lidhje të vazhdueshme me institucionet kombëtare (qendrore) për aspekte kurikulare.
- Të administrojë dokumentacionin kurikular të Departamentit Mësimor përkatës (në hard-copy dhe në format elektronik).
- Të miratojë (së bashku me drejtorin e shkollës profesionale) dokumentacionin kurikular në nivel shkollë (programet mësimore shkollore dhe planet e instruksionit të moduleve mësimore).

2. Koordinimin dhe mbështetjen e procesit të trajnimit të vazhdueshëm (in-service) të mësimdhënësve specialistë, në nivel shkollor.

Për kryerjen e këtij funksioni, Përgjegjësi i Departamentit Mësimor do të përmbushë këto **detyra** që kanë të bëjnë me trajnimin e vazhdueshëm të mësimdhënësve të Departamentit Mësimor përkatës:

- Të analizojë gjendjen dhe problematikën e procesit mësimor në kuadrin e Departamentit Mësimor përkatës.
- Të analizojë nevojat për trajnim të vazhdueshëm të mësimdhënësve të Departamentit Mësimor përkatës.
- Të njohë mësimdhënësit e Departamentit Mësimor si dhe drejtuesit e shkollës profesionale me gjendjen dhe problematikën e procesit mësimor.
- Të hartojë dhe detajojë programin vjetor të veprimtarive për trajnimin në nivel shkollë të mësimdhënësve të Departamentit Mësimor përkatës (veprimtaritë, përgjegjësitë, afatet, shpenzimet e nevojshme, etj.).
- Të koordinojë realizimin e veprimtarive për trajnimin në nivel shkollë të mësimdhënësve të Departamentit Mësimor përkatës.
- Të kryejë veprimtari trajnuese për mësimdhënësit e tjerë të Departamentit Mësimor, për aspekte të ndryshme të metodologjive mësimore, të metodologjive kurikulare, të profesioneve përkatëse, etj.
- Të mbështesë (me këshilla, udhëzime, literaturë dhe forma të tjera) mësimdhënësit e tjerë të Departamentit Mësimor në procesin e zhvillimit të tyre profesional.
- Të mbajë lidhje të vazhdueshme me institucionet e tjera (kombëtare ose rajonale) të angazhuara në trajnimin e vazhdueshëm të mësimdhënësve të arsimit profesional.
- Të administrojë dokumentacionin që ka të bëjë me trajnimin e vazhdueshëm të mësimdhënësve të Departamentit Mësimor përkatës (në hard-copy dhe në format elektronik).

Kërkesat për Përgjegjësin e Departamentit Mësimor.

Përgjegjësi i Departamentit Mësimor në shkollat profesionale duhet të përmbushë këto **kërkesa** kryesore:

- Të jetë i emëruar dhe të japë mësim në shkollën profesionale ku vepron Departamenti Mësimor që do të drejtojë.
- Të jetë i diplomuar në drejtimin/profilin profesional që trajton Departamenti Mësimor përkatës.
- Të ketë përvojë mësimdhënieje (teorike dhe praktike) në arsimin profesional jo më pak se 10 vjet.

- Të zotërojnë metodologjitë për hartimin e kurikut shkollor dhe teknikat e trajnimit të mësuesve.
- Të zotërojnë përdorimin e kompjuterit personal, internetit dhe mediave e mjeteve të tjera didaktike.
- Të zotërojnë gjuhën angleze.
- Të ketë aftësi të mira organizative, të komunikimit dhe të punës në grup.
- Të gëzojnë respektin e mësuesve të tjerë dhe të nxënësve të shkollës.

Aspekte të statusit të Përgjegjës të Departamentit Mësimor.

Përgjegjësi i Departamentit Mësimor do të gëzojë këto kushte:

- Do të ketë ngarkesë mësimore të reduktuar (50% – 75% të ngarkesës mësimore normale).
- Do t'i krijohet mundësia që të shpërndajë optimalisht ngarkesën mësimore që të krijojë hapësirë për të kryer detyrat e tjera.
- Do t'i krijohen kushte për të ushtruar funksionet dhe zbatuar detyrat (një zyrë e pajisur me kompjuter, printer, fotokopjues, internet, etj.).
- Do t'i krijohen mundësi të trajnohet për aspekte të ndryshme që lidhen me veprimtarinë e tij si Përgjegjës i Departamentit Mësimor.
- Do t'i vihen në dispozicion anëtarët e Departamentit Mësimor për të kryer veprimtaritë e planifikuara.
- Do t'i vihen në dispozicion mjedise të shkollës për të kryer veprimtaritë e planifikuara.
- Do të mbështetet financiarisht dhe materialisht (nga buxheti i shkollës dhe burime të tjera) për të kryer veprimtaritë e planifikuara.

Disa kritere për përcaktimin e numrit të Departamenteve Mësimore (dhe të Përgjegjësve) në shkollat profesionale.

Dy janë kriteret bazë që do të konsiderohen për të përcaktuar numrin e Departamenteve Mësimore (dhe numrin e Përgjegjësve) në një shkollë profesionale:

Madhësia e shkollës (pra, numri i mësuesve specialistë dhe instruktorëve të praktikave).

Numri i drejtimeve/profileve profesionale që ofron shkolla profesionale.

Këto dy kritere analizohen për raste të ndryshme:

Kur shkolla ka më pak se 10 mësues/instruktorë specialistë dhe:

- kur ka vetëm 1 drejtim/profil mësimor, do të ketë 1 Përgjegjës me 50% të ngarkesës mësimore.
- kur ka 2 ose më shumë drejtime/profile mësimore, do të ketë 2 Përgjegjës me 75% të ngarkesës mësimore secili (drejtimet/profilet do të grupohen në 2 ndarje).

Kur shkolla ka më shumë se 10 mësues/instruktorë specialistë dhe:

- kur ka vetëm 1 drejtim/profil mësimor, Departamentet Mësimore do të përbëhen nga grupe prej 11-15 mësuesish/instruktorësh (që trajtojnë lëndë/praktika të përafërta), ku çdo Departament ka Përgjegjës me 50% të ngarkesës mësimore, si dhe një grup prej 5-8 mësuesish/instruktorësh, me Përgjegjës që ka 75% të ngarkesës mësimore.
- kur ka 2 ose më shumë drejtime/profile mësimore, Departamentet Mësimore do të përbëhen nga grupe prej 11-15 mësuesish/instruktorësh (të njëjtit drejtim/profil) me Përgjegjës që kanë 50% të ngarkesës mësimore, si dhe grupe prej 5-8 mësuesish/instruktorësh (të njëjtit drejtim/profil) me Përgjegjës që kanë 75% të ngarkesës mësimore.

Nisur nga fakti që Arsimi Profesional në Shqipëri ka rreth 40 shkolla profesionale (shumica e të cilave janë me më pak se 10 mësues/instrukturë të profesioneve, llogaritet që nevojiten rreth 25 norma të plota mësimore për të mundësuar veprimtarinë e rreth 50-60 mësuesve në rolin e Përgjegjësve të Departamenteve Mësimore, me 50% ose 75% të ngarkesës mësimore. Llogaritjet e sakta do të kryhen duke analizuar çdo shkollë profesionale në veçanti.

Pjesa e dytë

**Materiale që i referohen aspekteve të trajnimit të
mësuesve të AP në lidhje me skeletkurikulat e reja të
Arsimit Profesional**

PROGRAMI I TRAJNIMIT

“Hartimi i kurikulit shkollor ne Arsimin Profesional”

Maj 2009

Sektori i SSTM

Organizues: Agjencia Kombëtare e AFP-së dhe Instituti i Kurikulave dhe Trajnimeve

Pjesëmarrës: Mësues dhe instruktorë të shkollave Teknike-Profesionale

Kohëzgjatja: 2 ditë (6 seanca trajnimi)

Objektivat e trajnimit

- Të njohë mësuesit dhe instruktorët e AP-së me zhvillimet e fundit në reformën e AP-së dhe me strukturën e re të AP-së, që bëhet funksionale në shtator 2009)
- Të aftësojë mësuesit dhe instruktorët e AP-së që të analizojnë skeletkurikulat e drejtimeve profesionale, që bëhen funksionale në shtator 2009.
- Të aftësojë metodologjikisht mësuesit dhe instruktorët e AP-së që të përgatisin programe dhe plane të detajuara për lëndët profesionale dhe modulet e praktikave profesionale, që bëhen funksionale në shtator 2009.

Përmbajtja e trajnimit:

Dita I.

Seanca I (50 min)

- Hyrje – Qëllimi i seminarit – Prezantime – Udhëzime të përgjithshme
- Zhvillimet e fundit në Reformën e AP-së
- Struktura e re e AP-së

Seanca II (50 min)

- Kuptimi për Skeletkurikulat e AP-së
- Struktura e Skeletkurikut në AP
- Struktura e propozuar e Kurikut shkollor në AP

Seanca III (60 min)

- Udhëzime për hartimin e elementeve të Kurikut shkollor
- Objektivat-Metodologjitë-Përmbajtjet-Instrumentet e vlerësimit dhe Kushtet e mësimit në AP
- Udhëzime praktike për metodologjinë e hartimit të Kurikut shkollor.

Dita II.

Seanca I (60 min)

- Udhëzime për hartimin e programit të detajuar teorik të lëndës profesionale
- Praktikim (në grupe) i pjesëmarrësve për hartimin e programit të detajuar teorik të lëndës profesionale.

Seanca II (60 min)

- Udhëzime për hartimin e planit të detajuar të mësimdhënies së modulit profesional praktik
- Praktikim (në grupe) i pjesëmarrësve për hartimin e planit të detajuar të mësimdhënies së modulit profesional praktik.

Seanca III (40 min)

- Prezantime nga pjesëmarrësit i punëve në grupe (programeve e planeve të detajuara).
- Pyetje-sqarime-diskutime dhe propozime.
- Hapat e mëtejshme.
- Konkluzionet e seminarit të trajnimit.

Shënime:

- Midis seancave do të ketë pushime të shkurtra 10-15 minutëshe.
- Pjesëmarrësve do t'u jepen kopje të "Udhëzuesit për hartimin e kurikulave të AP", materiale të shkruara dhe CD me materiale dhe modele të Skeletkurikulave dhe Kurikulave shkollore.

Zhvillimet e arsimit të mesëm Profesional dhe Teknik, objektivat dhe reformimi

Ilia Paluka, Drejtor i AKAFP

Arsimi i mesëm Profesional dhe Teknik (APT) është një nga prioritetet e Qeverisë dhe sigurisht dhe prioritet për punën e MASH. Objektiva kryesorë të këtij prioriteti janë; përmirësimi i cilësisë dhe rritja e përqindjes së tërheqjes së nxënësve në këtë lloj arsimimi.

Vështrim i përgjithshëm mbi zhvillimet në APT

Në rrjetin e APT, funksionojnë 41 shkolla, në 28 prej tyre ka vetëm degë të arsimit profesional, të tjerat janë të shkolla të bashkuara me shkolla social-kulturore, të mesme të përgjithshme dhe arsim të detyruar.

Një pjesë e shkollave të APT, janë me konvikte ku janë sistemuar rreth 20% të nxënësve.

Gjithsej në shkollat profesionale dhe ato social-kulturore studiojnë 19.831 nxënës, të cilët përbëjnë rreth 19% të nxënësve që frekuentojnë arsimin e mesëm.

Vetëm në arsimin profesional janë 12.594 nxënës.

Shkollat e APT, janë lokalizuar kryesisht në qytete dhe vetëm 3 prej tyre, me drejtim kryesor bujqësi-agrobiznes, ndodhen në zonat rurale.

Reformime institucionale dhe përmirësime ligjore

Krahas rivlerësimit të çështjeve tradicionale si kurikulat, trajnimi i mësuesve dhe i instruktorëve, pajisja e shkollave, tashmë reformimi i AMTP në Shqipëri, është orientuar dhe fokusuar drejt një “Reforme sistematike”, që përfshin probleme kryesore të afrimit të AFTP shqiptar me atë evropian, si:

- Hartimi dhe miratimi i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve Profesionale (KSHKP). Drafti i hartuar është në përshtatje me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve. Është në proces për miratime të mëtejshme;
- Arritja e konsensusit me të gjithë grupet e interesit dhe institucionet përgjegjëse shtetërore për Draft-Projektligjin e ri “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën Shqipërisë”, mbështetur në Ligjin Nr. 8872, datë 29.03.2002, “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën Shqipërisë”. Drafti ka përfunduar dhe janë duke u ndjekur procedurat për miratim në Qeveri e Parlament;
- Fuqizimi i rolit të Këshillit Kombëtar të AFP-së, si një organizëm këshillimor trepalësh (qeveri, punëdhënës, punëmarrës), në mbështetje të zhvillimit të politikave reformuese të AFP;
- Zhvillimi i vazhdueshëm i Agjencisë Kombëtare të AFP-së, për të kryer funksione ndër sektoriale që aktualisht nuk mbulohej nga dikasteret dhe institucionet e AFP-së;
- Krijimi i një mekanizmi institucional për kualifikim (pre-service) për bazat e pedagogjisë dhe psikologjisë, të mësuesve dhe instruktorëve të rinj të AFP-së;
- Fuqizimi i Bordeve të shkollave me përfshirjen e partnerëve socialë.

Parë në këtë optikë, reformimi i sistemit të AFP-së, duke kërkuar edhe ndryshime thelbësore në vizionin, qëndrimet dhe sjelljen e të gjithë aktorëve të angazhuar në këtë sektor, synon përtej ndryshimeve thjesht institucionale *orientimin nga tregu i punës dhe nga praktika, rritjen e fleksibilitet të formimit të specialistëve të rinj me kualifikimet dhe shkathtësitë e*

shprehitë e nevojshme, duke i veshur këtij sistemi dimensionin e realitetit, efektivitetit dhe konkurrencës së tregut.

Prioritetet

Prioriteti1: Veprimtari që synojnë rritjen e cilësisë në arsimin e mesëm teknik-profesional dhe në qendrat e formimit për të rritur dhe zbatimin e tyre praktik:

- a) Zhvillime kurikulare (përmirësime dhe përshtatje);
- b) Vlerësime të brendshme dhe të jashtme;
- c) Konsultime të nxënësve dhe kursantëve për karrierën;
- d) Trajnime gjatë punës të mësuesve të shkollave dhe qendrave të AFP-së;
- e) Hartimi i udhëzuesve për mundësitë e punësimit, etj.

Prioriteti 2: Bashkëpunimi dhe përfshirja e të interesuarve në AFP-së për zhvillimin dhe zbatimin e ofertave mësimore dhe formuese në shkolla dhe qendra:

- a) Përfshirja e partnerëve në hartimin, përmirësimin dhe zbatimin e AFP-së;
- b) Shqyrtimi i kërkesave dhe ofertave për AFP-së;
- d) Veprimtari të përbashkëta në përgatitjen e trajnerëve në bashkëpunim me ndërmarrjet ;
- e) Orientimi dhe përshtatja me tregun e punës;
- f) Zhvillimi i veprimtarive për arsimimin profesional të të rriturve;
- e) Çdo veprimtari që mbështet forcimin e bashkëpunimit midis aktorëve të AFP-së (partnerët socialë).


Si përfundim, mund të themi se qëllimi strategjik i reformës së AFPT-së është krijimi i një sistemi unik dhe cilësor të AFP-së, të aftë për të kontribuar në zhvillimin e vazhdueshëm të aftësive profesionale dhe qytetarisë aktive të rinjve dhe të rriturve, nëpërmjet ofrimit të kualifikimeve profesionale, në përputhje me kërkesat e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit, përmes një **reforme në sistem**.

Struktura e Sistemit Arsimor për AP-në

Arsimi i Mesëm Teknik-Profesional zgjat 4 vjet dhe është i organizuar me 3 nivele:

- Niveli I- Drejtimi i Kualifikimit profesional, zgjat 2 vjet dhe përgatit/certifikon punonjës gjysmë të kualifikuar.
- Niveli I- Profili i Kualifikimit, zgjat 1 vit dhe përgatit/certifikon punonjës të kualifikuar.
- Niveli III- Drejtime/profile, zgjat 1 vit dhe përgatit/certifikon teknik/menaxher.

Struktura e Sistemit Arsimor në Shqipëri, 2009



Kjo strukturë është më fleksibël, lejon ndryshime të pjesshme dhe është më e përshtatur me dinamikën e zhvillimit të tregut.

Në planet mësimore të shkollave profesionale është bërë kujdes që në përfundim të katër viteve në shkollat profesionale, për lëndët e formimit të përgjithshëm, të realizohet rreth 72% e kurikulës bërthamë të gjimnazeve (që zgjasin 3 vjet).

Lëndët "Gjuhë shqipe dhe letërsi" dhe "Matematikë" do zhvillohen me program të plotë të kurikulës bërthamë të gjimnazit, gjë që siguron hyrjen në provime të detyruara.

Në përfundim të çdo niveli nxënësi pajiset me Dëftesë dhe Certifikatë të aftësive profesionale dhe në përfundim të katër viteve në këto shkolla, nxënësit pajisen me Certifikatë të aftësive profesionale dhe Diplomën e maturës profesionale, që i lejojnë të ndjekin studimet në arsimin e lartë.

Përparësitë e strukturës së re janë:

- Ofron 3 nivele profesionale, në përputhje me KSHK (nivelet 2, 3 dhe 4);
- Siguron dalje në tregun e punës pas çdo niveli;
- Siguron mundësi vazhdimësie kualifikimi dhe shkollimi të mëtejshëm.
- Fleksibilitet dhe përshtatshmëri me sektorë të tjerë arsimorë

Hartimi i elementeve të kurikulit shkollor në Arsimin Profesional

Sektori i SSTM

Elementet bazë të kurikulit të nivelit shkollor (programeve lëndore të detajuara dhe planeve të mësimdhënies së moduleve profesionale) janë: (i) Objektivat mësimore; (ii) Përmbajtjet mësimore; (iii) Metodatat mësimore; (iv) Instrumentet e vlerësimit dhe (v) Kushtet për realizimin e mësimimit.

1. Përcaktimi i Objektiveve mësimore

Projektimi ose planifikimi i suksesshëm i çdo pune, kërkon që paraprakisht të parashikohen rezultatet që duhet të arrihen. “T’i hysh një pune pa menduar fundin, është si të hipësh në një anije pa timon” (S. Frashëri). **Rezultatet e pritshme** në arsim paraqiten në trajtë hierarkie (vartësie) dhe shprehen me emërtime të ndryshme, si qëllimet, synimet, objektivat, etj.

Për t’i përshkruar në mënyrë të mjaftueshme rezultatet e pritshme mësimore në dokumentet kurikulare të nivelit shkollor, hartohen objektivat mësimore. Këto objektiva janë të veçanta dhe kanë prirje të jenë të matshme objektivisht. Ato shprehin rezultatet e pritshme të një veprimtarie mësimore afatshkurtër, prandaj zakonisht formulohen në nivelin e temave të lëndëve ose në nivelin e rezultateve mësimore të moduleve (shih shembujt).

Objektivat specifike burojnë nga qëllimet dhe synimet më të përgjithshme dhe i specifikojnë më tej ato, duke treguar se çfarë duhet të dijë ose të bëjë nxënësi në fund të një veprimtarie mësimore afatshkurtër. Në rastin e moduleve mësimore, objektivat specifike janë emërtuar si Rezultate Mësimore (RM) të cilat, së bashku me Kriteret e Vlerësimit (KV), tregojnë se ç’nivel do të arrijë nxënësi në fund të trajtimit të modulit si dhe mundësojnë matjen e shkallës së përmbushjes nga ana e tij (shih shembullin).

Mënyra se si objektivat mësimore pasqyrohen në kurikulin shkollor ndikon mjaft në mbarëvajtjen e procesit mësimor. Ato shërbejnë si orientuese dhe detyruese për përzgjedhjen e elementeve të tjera të kurikulit, të tilla si përmbajtjet mësimore, metodatat mësimore, metodatat dhe instrumentet e vlerësimit, kushtet dhe mediat për realizimin e mësimimit, etj.

Shembull: Objektivat e temës: Sistemi i vajisjes së motorit:

Në përfundim të temës, nxënësi duhet:

- të tregojë qëllimin e sistemit të vajisjes
- të përshkruajë llojet e sistemeve të vajisjes dhe veçoritë e tyre.
- të shpjegojë qarkullimin e vajit në sistemin me vajisje të detyruar
- të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e pompës së vajit, filtrave të vajit dhe radiatorit të vajit.
- të përshkruajë materialet për vajisje.

Shembull: Rezultati Mësimor: Nxënësi kryen punime me prerje

Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të:

- Interpretojë drejt skicën ose vizatimin e detalit.
- Përzgjedhë drejt gjysmë fabrikantin.
- Përzgjedhë drejt veglat e punës.
- Shtrëngojë siç duhet copën në mengene.
- Kryejë sharritje me sharrë dore.
- Kryejë prerje me gërshërë.
- Kryejë prerje me daltë.

Struktura e objektivit mësimor specifik.

Objektivi mësimor specifik zakonisht ka në përbërjen e tij tri elemente të rëndësishme: veprimtaria, objekti dhe kushtet e kërkesat.

(i) **Veprimtaria (V)** - tregon se **ÇFARE** duhet të realizohet nga nxënësi në fund të procesit mësimor. Gjatë hartimit të objektivave mësimore duhet të analizohet në mënyrë të kujdesshme veprimtaria që nxënësi do të realizojë. Këto folje duhet të ndihmojnë që objektivi mësimor të bëhet i matshëm (duke ndihmuar dhe për vlerësimin e nxënësit).

(ii) **Objekti (O)** - tregon se **KUJT** i drejtohet veprimtaria e parashikuar në objektivin mësimor. Për shembull, te objektivi: “të identifikojë parregullsitë e funksionimit të motorit”, objekt i këtij objektivi janë parregullsitë e motorit.

(iii) **Kushtet dhe kërkesat (K)** - përcaktojnë se: (a) në ç’kushte bëhet i mundur realizimi i objektivit dhe (b) cilat janë parametrat (standardet) që duhet të arrihen që objektivi që konsiderohet i realizuar. Kushtet përshkruajnë mjedisin, mjetet, pajisjet, materialet ndihmëse ose kohën që nxënësi duhet të ketë në dispozicion për realizimin e objektivit. Standardi përmban elementë sasiorë ose cilësorë që përcaktojnë nivelin e pranueshëm të realizimit të objektivit nga nxënësi.

Në shembujt e mëposhtëm tregohen objektiva mësimore specifike me të tri elementet përbërëse:

Shembuj të qëllimeve mësimore specifike, me tri elemente:

1. Të limojë (V) një detal metalik (O) në banko, sipas kërkesave të vizatimit të punës (K).
2. Të llogarisë (V) kostot e një produkti (O) me anë të programit kompjuterik përkatës (K).
3. Të vizatojë (V) detale konkrete (O) duke përdorur programin CAD (K).
4. Të montojë (V) elementet e parapërgatitur të një karrikeje prej druri (O), sipas skemës përkatëse dhe për një kohë prej 30 minutash (K)

Një objektiv mësimor mund të mos i përmbajë njëkohësisht të tri elementet e mësipërme, **p.sh.**, te qëllimi: “të regjistrojë (V) shitjet (O)”, mungon pjesa e kushteve dhe kërkesave, megjithatë objektivi mund të konsiderohet i qartë. Por një objektiv mësimor pa veprimtarinë dhe pa objektin nuk mund të ekzistojë.

Veprimtaria është mjaft e rëndësishme për një objektiv mësimor. Zakonisht, ai përmban vetëm një folje aktive që tregon veprimtarinë. Nëse janë dy ose më shumë folje, kjo do të thotë që janë dy ose më shumë objektiva, p.sh: “të diagnostikojë dhe zëvendësojë pjesët e dëmtuara të motorit”. Këtu janë dy folje me të cilat ndërtohen dy objektiva krejt të ndryshme: (i) të diagnostikojë motorin, dhe (ii) të zëvendësojë pjesët e dëmtuara të motorit.

Ka raste kur në formulimin e një objektivi mësimor mund të përdoren dy ose më shumë folje njëkohësisht dhe kjo atëherë kur i referohen të njëjtit objekt dhe kur veprimtaritë kanë lidhje logjike me njëra tjetrën, si p.sh te objektivi: “të çmontojë dhe montojë pjesët e motorit”.

Veprimtaria e objektivave mësimore specifike të shprehet mundësisht me folje veprorë që shprehin veprime që mund të demonstrohen nga nxënësi dhe mund të vlerësohen nga mësimmshënësi. Duhet të shmanget përdorimi i foljeve pasive, të papërcaktuara, me shumë interpretime, që demonstrohen dhe vlerësohen me vështirësi (shih tabelën më poshtë).

☞ Rekomandime për përdorimin e foljeve në formulimin e objektivave mësimore:

| Rekomandohet të përdoren foljet | | Rekomandohet të mos përdoren foljet |
|---------------------------------|------------------|-------------------------------------|
| të shpjegojë | të respektojë | të dijë |
| të tregojë | të përzgjedhë | të njohë |
| të argumentojë | të llogarisë | të kuptojë |
| të përshkruajë | të skicojë | të thellohet |
| të ilustrtojë | të vizatojë | të fokusohet |
| të dallojë | të montojë | të jetë i aftë |
| të interpretojë | të demontojë | të ketë dijeni |
| të demonstrojë | të diagnostikojë | të ketë njohuri |
| të formulojë | të sharrojë | të përqendrohet |
| etj... | etj... | etj... |

Në formulimin e qëllimit mësimor një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar dhe **objektit** të cilit i referohet objektivi. Ka raste kur objektivi nuk përmban vetëm një objekt, p.sh, te objektivi: “të qepë pantallonat dhe këmishën, sipas përmasave të klientit”, kemi dy objekte, pantallonat dhe këmishën. Meqenëse këto dy produkte realizohen me mënyra dhe procedura pune mjaft të ndryshme, rekomandohet që të formulohen dy objektiva të veçanta që i referohen këtyre dy objekteve të ndryshme: (i) “të qepë pantallonat, sipas përmasave të klientit”, dhe (ii) “të qepë këmishën, sipas përmasave të klientit”. Kjo lehtëson dhe qartëson, si organizimin e mësimin, ashtu edhe vlerësimin e nxënësve.

Kushtet dhe kërkesat janë elemente të rëndësishme të objektivit mësimor që e qartësojnë atë, si dhe e bëjnë të matshëm dhe të verifikueshëm. Ato përshkruajnë se në “ç’kushte”, “sa mirë” dhe në “ç’nivel” duhet ta përmbushë nxënësi veprimtarinë që shprehet në objektivin mësimor përkatës. Sa më shumë të përshkruhen kushtet dhe kërkesat, aq më specifik bëhet objektivi mësimor.

Objektivat mësimore ndahen sipas fushave të veprimtarive të cilave i referohen (shih shembujt):

a) objektiva të fushës njohëse, që kanë të bëjnë me të nxënit e njohurive nga ana e nxënësit. Realizimi i tyre kërkon angazhimin e kujtesës dhe të menduarit nga nxënësi. Planifikohen të përmbushen gjatë trajtimit të lëndëve teorike.

b) objektiva të fushës afektive, që lidhen me pikëpamjet dhe qëndrimet e nxënësit ndaj çështjeve të ndryshme duke angazhuar emocionet dhe ndjenjat dhe duke ndihmuar në zhvillimin e personalitetit të tij. Kanë të bëjnë me punën në grup, komunikimin, qëndrimin ndaj dukurive sociale, etj.

c) objektiva të fushës psikomotore, që kanë të bëjnë me fitimin e shkathtësive dhe shprehive mendore dhe lëvizore nga nxënësi, të nevojshme për realizimin e veprimtarive të ndryshme.

(a) Shembuj:

Objektiv i fushës njohëse: “Nxënësi të tregojë përbërësit e kostos së një veprimtarie hotelerie”.

Objektiv i fushës afektive: “Nxënësi të mirëpresë klientët gjatë pritjes së tyre në recepsion”.

Objektiv i fushës psikomotore: “Nxënësi të kryejë regjistrimin me kompjuter të klientëve të hotelit”

(b) Shembull: Objektiv mësimor kompleks:

“Nxënësi të riparojë defektet e mundshme në motorin e automjetit të klientit”.

- Pjesa njohëse: të tregojë cilat janë defektet në motor, shenjat dhe shkaqet e tyre.

- Pjesa afektive: të mirëpresë dhe të silltet si duhet me klientin që ka probleme në motor.

- Pjesa psikomotore: të diagnostikojë motorin, të zhërthejë motorin dhe të zëvendësojë pjesët

Planifikohen të përmbushen kryesisht gjatë veprimtarive mësimore në mjedise reale pune, reparte pune dhe laboratorë të shkollave.

Në shumicën e rasteve, në AFP, objektivat mësimore janë komplekse dhe ndërthuren me njëra-tjetrën. Realizimi i tyre kërkon angazhimin mendor, emocional dhe fizik të nxënësit duke çuar në krijimin e kompetencave profesionale (shih shembullin).

2. Përzgjedhja e përmbajtjeve mësimore

Përmbajtja mësimore në AP përfaqëson tërësinë e veprimtarive që kryejnë mësimdhënësit dhe nxënësit gjatë procesit mësimor (seancave mësimore), me qëllim përvetësimin e kompetencave të punës të parashikuara në shkollimin përkatës.

Në mënyrë më të zgjeruar mund të themi që:

- **Përmbajtja mësimore është një tërësi veprimtarish.** Kjo do të thotë që përmbajtja e përzgjedhur lidhet me karakterin psikik (mendor), me karakterin lëvizor dhe emocional (afektiv) të veprimtarive që zhvillojnë nxënësit gjatë shkollimit. Përmbajtjet që i referohen veprimtarive me karakter psikik lidhen me njohuritë, ato që i referohen karakterit lëvizor, lidhen me procedurat dhe proceset e punës të cilat zhvillojnë shprehje praktike, ndërsa përmbajtjet e karakterit emocional, zhvillojnë qëndrime e vlera lidhur me kompetencën përkatëse.
- **Përmbajtja mësimore ka të bëjë me veprimtarinë e mësimdhënësit.** Ajo shpreh veprimet që kryhen nga mësimdhënësi gjatë procesit mësimor, që të ndihmohet krijimi dhe zhvillimi i kompetencave të punës të nxënësit. Të tilla veprimtari të tij janë parashtrimi i fakteve, shpjegimi i koncepteve, ilustrimi i parimeve dhe i ligjeve, demonstrimi i procedurave dhe i proceseve të punës, mbikëqyrja e veprimtarive të nxënësit dhe udhëzimi i tij, etj.
- **Përmbajtja mësimore ka të bëjë me veprimtarinë e nxënësve.** Ajo shpreh veprimtaritë që kryhen nga nxënësi gjatë kohës së parashikuar të shkollimit, për të nxënë, me qëllim krijimin e kompetencave të punës të ai. Procese të tilla janë përvetësimi i njohurive, vëzhgimi i procedurave dhe i proceseve të punës, analiza, llogaritja, zgjidhja e problemeve, praktikimi i procedurave dhe i proceseve të punës, etj.

Përmbajtja mësimore është një element shumë i rëndësishëm që gjen pasqyrim të gjerë në dokumentet e ndryshme të kurikulit (të shkruar) përkatës. Pra, përmbajtja e kurikulit është pasqyrimi në kurikul i sistemit të njohurive, shprehive dhe qëndrimeve që do të përvetësohen nga nxënësit gjatë procesit mësimor përkatës.

Në kurikul përmbajtja përzgjidhet dhe organizohet në nivele të ndryshme. Organizimi i përmbajtjes në Skeletkurikul (në nivel qendror) është më e sintetizuar, mësuesi në shkollë e detajon më hollësisht në programet mësimore përkatëse.

Duke analizuar strukturën e skeletkurikulit, shihet që një nga mënyrat e organizimit të përmbajtjes është plani mësimor i cili përmban një grup sërë lëndësh dhe modulesh të renditura dhe të shpërndara nga pikpamja kohore dhe didaktike, në formën e një matrice. Lëndët dhe modulet e përzgjedhura në planin mësimor “mbushen” me përmbajtje të cilat mund të organizohet në mënyra të ndryshme. Në kurikulin zyrtar të AP-së në Shqipëri, përmbajtja e lëndëve teorike profesionale është organizuar në formën e programit mësimor ndërsa ajo e praktikave profesionale në formën e përshkruesit të modulit.

Programet e lëndëve të teorisë profesionale përmbajnë një sistem didaktik të njohurive (fakte, koncepte, ligje, parime, procedura, procese), që kanë lidhje me njëra-tjetrën dhe ndihmojnë formimin e nxënësit në një drejtim të caktuar.

Përshkruesit e moduleve (praktike) profesionale përmbajnë kryesisht një sistem didaktik shprehish dhe qëndrimesh të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë profesionale.

Pavarësisht se përdoret termi “hartim” i përmbajtjeve, në të vërtetë ajo që realisht ndodh kur hartohen kurikulat është “përzgjedhja” e përmbajtjeve. Për shembull, përzgjedhja e përmbajtjeve të skeletkurikutit të një profili mësimor realizohet nga grupi i hartimit të këtij skeletkurikuli. Ndërsa në zhvillimin e mëtejshëm të kurikutit shkollor është vetë mësimdhënësi ai që i zhvillon më tej në formën e programeve shkollore ato përmbajtje që planifikohen në skeletkurikul për lëndën ose modulën përkatës. Mësimdhënësi gjithashtu përzgjedh përmbajtjet për çdo seancë mësimore që do të trajtojë.

Dokumentet kryesore kurikulare ku pasqyrohen përmbajtjet mësimore të një shkollimi (profili mësimor) profesional janë: skeletkurikuli, programet e lëndëve, përshkruesit e moduleve, ditarët e mësuesve dhe planet e instruksionit, si dhe tekstet mësimore.

| Shembull: Përmbajtje të një teme | Shembull: Përmbajtje të një RM-je |
|--|---|
| <p>Tema: Parimet themelore të vizatimit teknik.</p> <p>Çështjet e temës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Formatet e vizatimeve teknike. - Llojet e vijave dhe përdorimi - Shkrimi teknik. - Përpjesa. - Simbolet në vizatim teknik. - Standardet, rëndësia e tyre për vizatimin teknik. | <p>RM: Nxënësi kryen matje dhe shënime.</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përzgjedhja e instrumenteve matëse e kontrolluese. - Matja me metër. - Matja me nonius. - Matja me mikrometër. - Matja me komparator. - Matja me këndmatës. - Matja me manometër. - Shënimi me instrumente shënues. |

Cilat janë elementet kryesore të përmbajtjes mësimore?

Përmbajtjet mësimore, të cilat më pas gjejnë pasqyrim në elementet e ndryshme kurikulare, janë të grupuara në disa lloje kryesore, që i referohen aspekteve të ndryshme të veprimtarive mësimore. Në tabelën e mëposhtme jepen grupet kryesore të përmbajtjeve dhe shembuj.

Përbërësit kryesorë të përmbajtjeve mësimore:

Koncepti: Pasqyrimi në mëndje i objekteve reale ose ideve për të cilat ka shembuj të shumtë specifikë (p.sh, libri, qeni, dalta, demokracia, këmbëngulja, etj.).

Fakti: Informacion specifik, unik, për objekte konkrete ose ngjarje të ndodhura (p.sh, plumbi është i rëndë, xhami është i thyeshëm, demokracia është e brishtë, etj).

Parimi (ose ligji): Një përkufizim (me formulë ose me tekst) që përcakton marrëdhëniet midis dy ose më shumë koncepteve (p.sh, Ligji i Omit: $U=IR$, ose: sa më e madhe shpejtësia e lëvizjes, aq më e vogël koha e përshkimit të rrugës)

Procedura: Një seri hapash (veprimesh) të bashkëlidhura që bëjnë të mundur përmbushjen e një detyre, si p.sh, procedura e ndërrimit të gomës së konsumuar (ngritja e mjetit në kriko, lirimi i bulonave të rrotës, heqja e rrotës, shfryrja e gomës, heqja e gomës së konsumuar, vendosja e gomës së re, fryrja e gomës, vendosja e rrotës, shtrëngimi i bulonave të rrotës, heqja e krikut)

Procesi: Përshkrimi i asaj se si funksionojnë gjërat, natyrore ose teknike (p.sh, përshkrimi i procesit të fotosintezës, ose përshkrimi i procesit të derdhjes së metaleve

Cilat janë kriteret e përzgjedhjes së përmbajtjeve mësimore?

Përzgjedhja e përmbajtjeve mësimore është një proces i vështirë që ndikohet nga shumë faktorë dhe ku përvoja e mëparshme dhe subjektivizmi i personave që angazhohen luan një rol të rëndësishëm. Megjithatë, literatura e sotme rekomandon disa kriterë bazë në të cilat duhet të mbështetet përzgjedhja e përmbajtjeve mësimore:

Listë kontrolli për përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore në kurikulat e AFP-së

| Kriteret për verifikimin e përzgjedhjes së përmbajtjeve mësimore | Po | Jo |
|---|----|----|
| A u mbështetën ato te orientimi i shkollës, drejtimi/profili dhe niveli i shkollimit? | √ | |
| A u mbështetën ato te analiza e profesionit përkatës? | √ | |
| A u mbështetën ato te kompetencat që do të fitojë nxënësi në përfundim të shkollimit? | √ | |
| A u mbështetën ato te objektivat mësimore përkatëse? | √ | |
| A janë renditur ato nga pikëpamja hierarkike? | √ | |
| A janë respektuar parimet didaktike në përzgjedhjen dhe renditjen e tyre? | √ | |
| A i konsiderojnë ato kushtet dhe mundësitë e shkollave? | √ | |
| A e konsiderojnë ato nivelin hyrës të nxënësve? | √ | |
| A e konsiderojnë ato nivelin e daljes së nxënësve? | √ | |

Përmbajtjet konsiderohen të përzgjedhura dhe renditura si duhet nëse përgjigja e të gjitha pyetjeve të mësipërme është “√”.

3. Përzgjedhja e metodave mësimore

Kuptimi për metodat mësimore dhe veçoritë e tyre në AFP

Një element mjaft i rëndësishëm dhe integruar për të gjithë elementet, aktorët, faktorët, që mundëson realizimin e procesit mësimor të çfarëdo natyre, është **“metoda mësimore”**.

Për metodat mësimore nuk ka një përkufizim universal. Një këndvështrim i gjerë për metodat në përgjithësi, i paraqet ato si “...mënyra ose rrugë për të realizuar diçka...”. Dikush tjetër mendon që metodat paraqesin “...rregullat e lojës...”. Një përkufizim më konkret pohon që “metoda është një procedurë ose proces përgjithësisht i pranuar, që kryhet nga mësuesi, nxënësi ose të dy bashkë dhe ka për qëllim rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të të nxënësve”.

Pavarësisht nga përkufizimet e ndryshme, tipar themelor i metodës mësimore është se ajo duhet të lehtësojë procesin e të nxënësve nga ana e nxënësve.

Nga sa më sipër, burojnë dy çështje të rëndësishme:

(i) një mësues duhet të **zotërojë** një llojshmëri të madhe metodash mësimore, që të jetë në gjendje të bëjë një përzgjedhje të përshtatshme të tyre. Në këtë aspekt, ai duhet të jetë i sigurt që vërtet është kompetent në përdorimin e kësaj metode.

(ii) një mësues duhet të ketë kushte që të **zbatojë** metodën përzgjedhur për procesin mësimor.

Në procesin e hartimit të skeletkurikulit në nivel qendror, grupi përgjegjës përzgjedh dhe

Shëmbull: Rekomandime të metodave mësimore në përshkruesin e modulit “Punime axhusterie”.

- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për përdorimin e veglave dhe pajisjeve për matje, shënim, fiksime, sharrim, prerje, limim dhe shpim.
- Nxënësit duhet të angazhohen në punë konkrete për përdorimin e veglave dhe pajisjeve për kryerjen e punimeve axhusterie. Gjithashtu ata duhet të angazhohen edhe në fiksimin, matjen, shënimin, prerjen, sharrimin, limimin dhe shpimin e gypave dhe kanaleve të plastikës, llamarinës dhe profileve të ndryshme metalike

rekomandon metodat që mund të përdoren për realizimin e qëllimeve dhe përmbajtjeve të parashikuara në lëndët dhe modulet mësimore.

Gjatë zhvillimit të mëtejshëm të kurikutit në shkollë, mësuesi përgjegjës duhet të jetë kërkues për të njohur, eksperimentuar e përvetësuar edhe metoda të reja, të cilat ai duhet t'i zbatojë në mënyrë krijuese, në përshtatje me mjedisin dhe kushtet konkrete në të cilat kryhet procesi mësimor.

Llojshmëria e metodave mësimore

Në tabelën e mëposhtme renditen metodat mësimore më të praktikueshme në arsim dhe me shenjë (✓) tregohet përshtatshmëria e secilës metodë në zhvillimin e njohurive, shprehive apo qëndrimeve të nxënësve.

| Metodat mësimore | Njohuritë | Shprehitë | Qëndrimet |
|------------------------------------|-----------|-----------|-----------|
| Debati | ✓ | | ✓ |
| Demonstrimi | | ✓ | |
| Detyra e klasës | ✓ | | |
| Detyra e shtëpisë | ✓ | | |
| Diskutimi | ✓ | | |
| Ekskursioni | ✓ | | ✓ |
| Eksperimentimi | ✓ | ✓ | |
| Hulumtimi | ✓ | | ✓ |
| Leksioni/ligjërata | ✓ | | |
| Leximi | ✓ | | |
| Loja me role | | ✓ | ✓ |
| Metoda e "akuariumit" | ✓ | | |
| Metoda me pyetje-përgjigje | ✓ | | |
| Praktika e pavarur | | ✓ | ✓ |
| Praktika e udhëzuar (e mbikëqyrur) | | ✓ | ✓ |
| Puna me projekte | ✓ | ✓ | ✓ |
| Puna në grup | | | ✓ |
| Seminari | ✓ | | |
| Simulimi | | ✓ | ✓ |
| Studimi i pavarur | ✓ | | |
| Vizita studimore | ✓ | | |

Në procesin mësimor bashkëveprojnë dy palë: mësimmhënësit dhe nxënësit, si rrjedhojë metodat mësimore janë të lidhura me veprimtarinë e këtyre subjekteve. Pra, ato i referohen veprimtarisë së mësimmhënësit (mësimmhënëia) ose veprimtarisë së nxënësve (të nxënësve), por në përgjithësi metodat mësimore janë komplekse dhe nënkuptojnë ndërveprimin e të gjithë aktorëve dhe faktorëve të pranishëm gjatë procesit mësimor.

Listë kontrolli për përzgjedhjen e metodave mësimore në kurikulat e AFP -së

| Kriteret për verifikimin e përzgjedhjes së metodave mësimore | Po | Jo |
|---|----|----|
| A u mbështetën ato te objektivat dhe përmbajtjet mësimore përkatëse? | ✓ | |
| A u mbështetën ato te kushtet për zbatimin e tyre? | ✓ | |
| A u mbështetën ato te natyra e veprimtarisë mësimore (njohuri, shprehi, qëndrim)? | ✓ | |
| A u mbështetën ato te koha në dispozicion? | ✓ | |
| A u mbështetën ato te madhësia e grupit të nxënësve? | ✓ | |

| | | |
|---|---|--|
| A u mbështetën ato te mosha e nxënësve? | √ | |
| A i përjashtojnë ato shkaqet për rreziqe? | √ | |

Metodat mësimore konsiderohen të përzgjedhura si duhet nëse përgjigja e të gjitha pyetjeve të mësipërme është “√”.

4. Përcaktimi i instrumenteve të vlerësimit të nxënësve

Kuptimi për vlerësimin e nxënësve.

Procesi i vlerësimit është gjykim i mbi “diçka” pas një informacioni të marrë në lidhje me të. Me fjalën “diçka” nënkuptohet një person, një objekt, një dukuri, etj. Ky gjykim bazohet në analizën e këtij informacioni i cili mund të merret me mënyra të ndryshme.

Në analogji me sa më sipër, procesi i vlerësimit të nxënësit është gjykim i mbi shkallën e përmbushjes së qëllimeve mësimore nga ana e tij, pas një informacioni të marrë në lidhje me këtë. Nxënësve u vlerësohen njohuritë, shprehjet dhe qëndrimet, ose në mënyrë të integruar, u vlerësohen kompetencat (ose performanca).

Marrja e informacionit për nivelin e përmbushjes së qëllimeve mësimore (pra, të përvetësimit të njohurive, shprehjeve ose qëndrimeve) bëhet me metoda dhe instrumente vlerësimi të ndryshme. Këto bëjnë krahasimin e arritjeve të nxënësit me *kriteret* (standartet) dhe më pas i lejojnë vlerësuesit të japë gjykimin përkatës.

Vlerësimi është procesi që krijon një lidhje organike midis Kurikulit dhe Mësimdhënies.

Cilat janë format e vlerësimit të nxënësve?

Vlerësimi i nxënësve është i shumëllojshëm dhe mund të klasifikohet nisur nga kriteret e ndryshme. Më poshtë jepen disa nga format e vlerësimit dhe kriteret mbi të cilat është bërë grupimi i tyre:

- Nisur nga kriteri i formalitetit, vlerësimi i nxënësit është *formal*, kur rezultatet e tij regjistrohen në dokumente zyrtare (regjistër, certifikatë) dhe *informal*, kur bëhet në mënyrë të rastësishme dhe rezultatet nuk regjistrohen në dokumente zyrtare.
- Nisur nga kriteri i momentit kur bëhet vlerësimi i nxënësit, ai mund të jetë *hyrës* (paraprak), kur kryhet në fillim të vitit shkollor ose kursit mësimor; *i vazhdueshëm*, kur kryhet përgjatë vitit shkollor ose kursit mësimor dhe jo gjithmonë shoqërohet me notë; *përmbledhës* (ndonjëherë përfundimtar), kur kryhet në fund të një kapitulli, viti shkollor, shkollimi ose kursi dhe zakonisht shoqërohet me notë.
- Nisur nga kriteri i objektivitetit, vlerësimi i nxënësit është *objektiv*, kur përgjigjet e pyetjeve kanë vetëm një përgjigje të saktë dhe *subjektiv*, kur kanë më shumë se një përgjigje të saktë (ose më shumë se një mënyrë për ta shprehur atë).
- Nisur nga kriteri i asaj që merret për bazë në procesin e vlerësimit të nxënësit, ai është vlerësim *i bazuar në kriteret*, kur i krahason arritjet e nxënësit me kriteret e paracaktuara dhe vlerësim *i bazuar në normën*, kur krahason arritjet e nxënësit me normën (mesataren) e arritjeve të një grupi, për të bërë renditjen e tij kundrejt anëtarëve të tjerë të grupit.
- Nisur nga kriteri i qëllimit për të cilin përdoret vlerësimi i nxënësit, ai është vlerësim *diagnostifikues*, kur jo vetëm përcakton shkallën e përmbushjes së qëllimeve, por tregon dhe shkaqet për mosrealizimet e mundshme dhe vlerësim *jo-diagnostifikues*, kur nuk i zbulon këto shkaqe.
- Nisur nga kriteri i elementit mësimor që vlerëson te nxënësi, ai është vlerësim që i referohet *njohurive*, vlerësim që i referohet *qëndrimeve* (*sjelljeve*) dhe vlerësim që i referohet *shprehjeve* (*produkteve ose proceseve të punës*).

- Nisur nga kriteri i gjerësisë së vlerësimit të nxënësit, ai është vlerësim *një-dimensional*, kur trajton vetëm një element mësimor (p.sh, njohuritë) dhe vlerësim *shumë-dimensional*, kur trajton dy apo më shumë elemente mësimore (p.sh, kompetencat e punës).
- Nisur nga kriteri i pozicionit të vlerësuesit kundrejt nxënësit, ka vlerësim *të brendshëm*, kur ai kryhet nga vetë mësuesi ose shkolla përkatëse dhe vlerësim *të jashtëm*, kur kryhet nga persona ose komisione jashtë shkollës.

Cilat janë metodat dhe instrumentet kryesore të vlerësimit të nxënësve?

Për të bërë të mundur vlerësimin e shkallës së përmbushjes (performancës) së qëllimeve mësimore nga ana e nxënësve është e nevojshme mbledhja e informacionit të strukturuar në lidhje me këtë. Ka metoda të shumta, të thjeshta dhe komplekse, që krijojnë mundësi për të mbledhur këtë lloj informacioni. Të tilla metoda janë: Pyetje-përgjigjet (me gojë dhe me shkrim), kontrolli i detyrave, vëzhgimi i qëndrimeve (sjelljeve), vëzhgimi i proceseve, kontrolli dhe matja e produkteve, etj. Në kuadrin e këtyre metodave janë zhvilluar me dhjetëra instrumente vlerësimi të cilat japin informacion të detajuar në lidhje me përmbushjen e kriterëve të vlerësimit nga ana e nxënësit. Këto instrumente vlerësimi janë të fokusuar te njohuritë, shprehitë dhe qëndrimet, të marra veçmas ose së bashku.

Në tabelën e mëposhtme jepet një listë e instrumenteve të vlerësimit më të zakonshme si dhe përdorimet e secilit prej tyre.

| Instrumentet e Vlerësimit | Vlerësimi i shprehive | | Vlerësimi i njohurive | Vlerësimi i qëndrimeve |
|---|-----------------------|-----------------------|-----------------------|------------------------|
| | Vlerësimi i procesit | Vlerësimi i produktit | | |
| Pyetje-përgjigje me gojë, të hapura. | | | ◆ | |
| Pyetje-përgjigje me gojë, të mbyllura. | | | ◆ | |
| Pyetje-përgjigje me shkrim, të hapura (ese). | | | ◆ | |
| Pyetje-përgjigje me shkrim, të mbyllura (me zgjedhje të shumëfishtë, me plotësim, me kombinim). | | | ◆ | |
| Detyra me shkrim (ushtrime, skica, problema) | | | ◆ | |
| Studime të rastit | ◆ | ◆ | ◆ | ◆ |
| Detyra praktike | ◆ | ◆ | | |
| Projekte praktike për vlerësim | ◆ | ◆ | ◆ | ◆ |
| Lojë me role | ◆ | ◆ | ◆ | ◆ |
| Listë kontrolli | ◆ | ◆ | ◆ | ◆ |
| Rubrika vlerësimi | ◆ | ◆ | ◆ | ◆ |
| Portofol vlerësimi | ◆ | ◆ | ◆ | ◆ |

Janë dy tipe instrumentesh vlerësimi që gjejnë përdorim të gjerë në praktikën e sotme:

- Pyetje – përgjigje** (me gojë dhe me shkrim) që përdoret me mjaft efektivitet për vlerësimin e aspekteve njohëse të arritjeve të nxënësve (niveleve të njohurive). Ju të gjithë jeni mjaft familjarë me këtë lloj instrumenti vlerësimi dhe variacionet e tij.
- Listë kontrolli**, që përdoret kryesisht për vlerësimin e aspekteve psikomotorë të arritjeve të nxënësve (niveleve të shprehive), por nuk i përjashton edhe aspektet e tjera (shih shembullin e mëposhtëm). Zakonisht përfshijnë proceset dhe produktet e punës.

Listë kontrolli për vlerësimin e nxënësve në një praktikë për instalimet e ujësjellësit.

| Lista e kontrollit për veprimet e nxënësve (nxënësi “kalon” nëse bën më pak se 3 gabime) | Nxënësi <u>A</u> | Nxënësi <u>B</u> | Nxënësi <u>C</u> | Nxënësi <u>D</u> |
|---|-------------------------|-------------------------|-------------------------|-------------------------|
| A i bëri kuotimet sipas skemës dhe standardit? | + | - | + | + |
| A i bëri matjet të sakta? | + | + | + | + |
| A i bëri shënimet sipas skemës dhe standardit? | - | + | + | - |
| A i hapi kanalet sipas skemës dhe standardit? | + | - | - | + |
| A i montoi gypat sipas skemës dhe standardit? | - | + | + | + |
| A i përdori si duhet mjetet e punës? | + | - | + | - |
| A i respektoi rregullat e sigurisë në punë? | + | + | + | + |
| Rezultati i vlerësimit | 1) | 2) | Kalon | Kalon |

Në këtë tabelë, mund të përfshihen edhe veprimtari praktike, njohuri ose qëndrime të tjera të nxënësve, të cilat janë të rëndësishme për të gjykuar mbi shkallën e përmbushjes së qëllimit mësimor nga nxënësit.

Karakteristikat e një vlerësimi të mirë.

Një vlerësim i mirë ka disa tipare të rëndësishme, si më poshtë:

- Vlerësimi duhet të jetë i **vlefshëm** (valid), pra të vlerësojë ato njohuri, shprehi ose qëndrime që janë të rëndësishme për formimin e nxënësit (vlefshmëria tregon se sa i referohet vlerësimi qëllimeve mësimore).
- Vlerësimi duhet të jetë i **besueshëm**, pra rezultati i vlerësimit duhet të tregojë realisht nivelin e arritjeve të nxënësit.
- Vlerësimi duhet të jetë i **pa-anshëm** (objektiv), pra rezultati i vlerësimit nuk duhet të ndikohet nga vullneti ose opinionin (subjektiviteti) i vlerësuesit.
- Një vlerësim duhet të jetë **praktik**, pra i mundshëm për tu realizuar në kushte të pranueshme, në një kohë të dhënë dhe me burime njerëzore e financiare të pranueshme.

Cilat janë kriteret për përzgjedhjen e metodave dhe instrumenteve të vlerësimit?

1) Listë kontrolli për verifikimin e instrumenteve të vlerësimit

| Kriteret për përzgjedhjen e instrumenteve të vlerësimit | Po | Jo |
|--|-----------|-----------|
| A është instrumenti në përputhje me aspektin që do të vlerësohet (njohuri, shprehi ose qëndrim)? | √ | |
| A është instrumenti në përputhje me qëllimet mësimore? | √ | |
| A është instrumenti në përputhje me përmbajtjet mësimore? | √ | |
| A është instrumenti në përshtatje me kushtet për vlerësimin? | √ | |
| A është parashikuar kohë e mjaftueshme për vlerësimin? | √ | |
| A siguron instrumenti informacion të mjaftueshëm për vlerësimin? | √ | |
| A është instrumenti i pranueshëm nga pikëpamja e shpenzimeve? | √ | |
| A është instrumenti i realizueshëm nga pikëpamja e administrimit? | √ | |

Instrumentet e vlerësimit konsiderohen të përzgjedhura si duhet nëse përgjigja e të gjitha pyetjeve të mësipërme është “√”.

5. Përcaktimi i kushteve/mjeteve për zbatimin e kurikut

Në AP, realizimi i suksesshëm i procesit mësimor kërkon krijimin e kushteve të përshtatshme në mjediset e ndryshme mësimore. Kushtet e përshtatshme krijojnë mundësi për angazhimin maksimal të shqisave të nxënësve (të parit, të dëgjuarit, të prekurit, të nuhaturit dhe të shijuarit) si dhe të vëmendjes së tyre, duke rritur efektivitetin e procesit mësimor dhe lehtësuar krijimin e ata, të kompetencave të punës.

Qëllimet e planifikimit dhe i sigurimit të kushteve dhe mjeteve të duhura mësimore janë:

- Të lehtësojë procesin e të nxënës.
- Të krijojë kushte të përafërta pune me mjedisin e punës.
- Të lehtësojë punën e mësimdhënësit.
- Të shmangë ndërprerjen e mësimin për arsye të mungesës së burimeve të nevojshme.
- Të lehtësojë drejtimin/menaxhimin e shkollave duke planifikuar buxhetet e nevojshme sipas lëndëve, moduleve për klasa dhe kurse të ndryshme.

(b) Çfarë janë mjetet mësimore?

Mjetet mësimore janë instrumente didaktike që janë prodhuar, përshtatur ose zgjedhur për nevojat e mësimin dhe që i shërbejnë jo vetëm ngritjes së cilësisë, por dhe ndryshimit të stilit të punës mësimore.

Roli i mjeteve mësimore për arritjen e kompetencave të nxënësit është i ndryshëm. Më poshtë po paraqesim disa nga këto funksione, si:

- Informimi për njohurinë apo shprehinë që do të mësohet.
- Konkretizimi.
- Ilustrimi.
- Demonstrimi.
- Shpjegimi.
- Sqarimi i përmbajtjeve mësimore.
- Nxitja e zhvillimit të aftësive mendore të nxënësit.
- Rritja e vëmendjes së nxënësit.
- Zhvillimi dhe përsosja e shprehive.
- Racionalizimi i punës.
- Rritja e efektivitetit.
- Krijimi i një bashkëpunimi më të gjerë midis nxënësit dhe mësuesit.
- Lehtësimi i punës së mësuesit.

Materialet dhe mjetet mësimore klasifikohen si më poshtë:

- **materiale tekstuale**, janë të gjitha materialet e shtypura të përgatitura ose të botuara (teksti mësimor; udhëzues profesionalë; buletinet; materialet e arkivuar; fletët e punës).
- **mjete vizuale** (pamore): fotografitë dhe pikturat; diafilmat dhe diapozitivët; dërrasa e zezë; flipçarti; pinbordi; fleshkartat; mjetet grafike; diagrami.
- **mjete auditive** (zanore): magnetofoni; kasetofoni; radioja; telefoni; qendra e zërit.
- **mjete audiovizuale** (pamore-dëgjimore): filmi; televizioni; vidioja; kompjuteri (interneti, e-maili).

Burimet mësimore përfshijnë gjithashtu:

Veprat e punës: Janë relativisht jo të shtrenjta, zakonisht të lëvizshme e në masa të vogla. Shembuj të veglave të punës janë çekiçat, sharrat, vizoret, gërshërët, etj.

Pajisjet/makinat e punës: Mund të kategorizohen në mësimore ose profesionale. Pajisjet mësimore janë projektorët e ndryshëm (slide apo head projectors), video, etj. Ndërsa kategoria e pajisjeve profesionale përfshin ato që janë specifike për një veprimtari profesionale të veçantë dhe nevojiten për të mësuar kompetencat e një profesioni. Disa shembuj janë: makineritë e ndryshme si torno, aparat saldimi, traktor, kompjuter, etj.

Materiale të konsumueshme: Këto materiale që konsumohen ose përdoren gjatë kohës së mësimin dhe mund të ndahen më tej në mësimore ose profesionale. Të parat përdoren për zhvillimin e materialeve mësimore si tabela, shënime të printuara, diapozitiva, etj. Shembuj të këtyre materialeve janë letrat, lapsat, shkumësat, etj.

Materialet profesionale i referohen veprimtarive profesionale dhe konsumohen gjatë mësimdhënies ose praktikimit të kompetencave (praktikës). Tuba, copa metalesh, tela, bojëra, materiale ndërtimi, etj., janë shembuj të materialeve profesionale.

Faktorë që ndikojnë në burimet që nevojiten.

Planifimi i nevojave për burimet mësimore kërkon një analizë të kujdesshme të faktorëve që ndikojnë llojet dhe sasinë e burimeve. Çdo planifikim duhet të bazohet në elementet e kurikulës si dhe në veprimtaritë specifike mësimore që do të zhvillohen gjatë vitit.

Gjatë planifikimit të nevojave për burimet mësimore duhet të merren parasysh:

Kurikula, metodat mësimore, numri i nxënësve, buxheti në dispozicion dhe cikli i buxhetit, mundësitë për praktikën.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten mjediset mësimore në të cilat realizohet arsimimi i nxënësve të AP si dhe mjetet kryesore të këtyre mjedisëve, të nevojshme për kryerjen me sukses të proceseve mësimore teorike dhe praktike.

| (c) Mjedisi mësimor | Mjetet mësimore |
|------------------------|--|
| Klasa | <ul style="list-style-type: none"> - Dërrasa e zezë dhe shkumësi - Tabela e bardhë dhe markeri - Pankarta, materiale pamore (postera) - Makete, modele - Projektor dhe transparente - Vidio-projektor, kaseta vidio, CD, disketa - Tabela flipçarti dhe “pinboard”-i - Magnetofon, kaseta audio, shirita magnetike - Vidio-monitor dhe kaseta vidio - Kompjuter, printer, fotokopjues, skaner, internet, CD, disketa - Tekstet mësimore, udhëzuesa, katalogë. |
| Laboratori | <ul style="list-style-type: none"> - Tavolina pune - Pajisje laboratorike - Materiale laboratorike |
| Reparti i punës | <ul style="list-style-type: none"> - Makina pune - Vegla dhe pajisje pune - Instrumenta pune dhe matëse - Bango pune - Materiale pune |
| Ferma | <ul style="list-style-type: none"> - Tokë punuese - Ndërtesa ferme, sera, stalla, etj - Makina bujqësore - Kafshë bujqësore - Materiale bujqësore |

| |
|-----------------------------|
| Mjedisi real i punës |
|-----------------------------|

| |
|---------------------------------------|
| - Mjedise, mjete e materiale për punë |
|---------------------------------------|

Struktura e Programit të detajuar të lëndës profesionale, për nivelin shkollor (shembull)

Alqi Mustafai, AKAFP

Shkolla Profesionale “Beqir Çela” – Durrës
Drejtimi profesional “Shërbime mjetesh transporti”, Niveli I
Mësuesi: XXXXXXXXXXXX YYYYYYYYYYYYYY.

Viti shkollor 2009-2010

Programi i detajuar i Lëndës Profesionale: “Njohuri për mjetet e transportit” (L-18-074-09)
Klasa 10 – 108 orë mësimore

| Nr | Temat/Koha | Çështjet | Koha | Objektivat mësimore kryesore | Metodat mësimore | Instrumentet e vlerësimit | Kërkesa për realizimin |
|----|---|--|-------|---|---------------------------------------|-------------------------------|---|
| 1 | Hyrje në transport (3 orë) | -Kuptimi për transportin | 1 orë | -Të përkufizojë transportin | -Shpjegim -Ilustrime | -Pyetje me gojë | -Pankarta |
| | | -Historiku i transportit | 1 orë | -Të përshkruajë etapat e zhvillimit të transportit | -Shpjegim -Ilustrime | -Pyetje me gojë | -Pankarta -Materiale të shkruara |
| | | -Rëndësia e transportit për shoqërinë e sotme | 1 orë | -Të argumentojë rëndësinë e transportit | -Shpjegim -Diskutime | -Pyetje me gojë dhe me shkrim | -Materiale të shkruara |
| 2 | Sistemet e transportit dhe klasifikimi i tyre (4 orë) | -Kuptimi dhe përbërësit e sistemeve të transportit (inputet, proceset, outputet dhe fodbeku) | 2 orë | -Të përkufizojë sistemin e transportit -Të përshkruajë përbërësit e sistemeve të transportit | -Shpjegim -Ilustrime -Diskutime | -Pyetje me gojë dhe me shkrim | -Pankarta -Materiale të shkruara -Projektor mësimor |
| | | -Klasifikimi i përgjithshëm i sistemeve të transportit | 1 orë | -Të rendisë llojet kryesore të sistemeve të transportit | -Shpjegim -Diskutime | -Pyetje me gojë | -Pankarta -Materiale të shkruara |
| | | -Transporti tokësor, ajror, ujor dhe lloje të tjera | 1 orë | -Të përshkruajë llojet kryesore të sistemeve të transportit | -Shpjegim -Diskutime | -Pyetje me gojë | -Pankarta -Materiale të shkruara |

| | | | | | | | |
|----------|--|--|-------|---|---|-------------------------------|-------------------------------------|
| 3 | Mjetet e transportit dhe klasifikimi i tyre (4 orë) | -Kuptimi për mjetet e transportit -Funksionet e mjeteve të transportit -Karakteristikat e mjeteve të transportit | 2 orë | -Të përkufizojë mjetet e transportit -Të renditë funksionet e mjeteve të transportit -Të përshkruajë karakteristikat e mjeteve të transportit | -Shpjegim -Shembuj -Ilustrime -Diskutime | -Pyetje me gojë | -Pankarta -Materiale të shkruara |
| | | -Klasifikimi i përgjithshëm i mjeteve të transportit | 2 orë | -Të rendisë llojet kryesore të mjeteve të transportit | -Shpjegim -Diskutime | -Pyetje me gojë | -Pankarta -Materiale të shkruara |
| | | -Veçoritë e mjeteve të transportit rrugor, detar, ajror, etj. | | -Të përshkruajë veçoritë e mjeteve rrugore, ujore, ajrore, etj. | -Shpjegim -Ilustrime -Diskutime | -Pyetje me gojë dhe me shkrim | -Pankarta -Materiale të shkruara |
| 4 | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |

Struktura e Planit të mësimdhënies së modulit, për nivelin shkollor (shembull)

Alqi Mustafai, AKAFP

Shkolla Profesionale “Beqir Çela” – Durrës
Drejtimi profesional “Shërbime mjetesh transporti”, Niveli I
Mësuesi: XXXXXXXXXXXX YYYYYYYYYYYYYY.

Viti shkollor 2009-2010

Plani i mësimdhënies i Modulit Profesional: “Punime axhusterie” (M-04-210-09)
Klasa 10 – 30 orë mësimore

| Nr | Rezultatet mësimore/Koha | Veprimtaritë mësimore | Koha | Instrumentet e vlerësimit | Vendi | Kërkesa për realizimin |
|----|---|--|-------|--|--------------------------------------|---|
| 1 | Nxënësi kryen matje dhe shënime mekanike (4 orë) | -Rikujtimi i rregullave të përdorimit dhe kujdesit për instrumentet matëse dhe shënuese -Demonstrim i matjes me metër -Praktikim i nxënësve për matje me metër | 1 orë | Listë kontrolli për matjen me metër, kalibër, mikrometër, komparator, këndmatës dhe manometër, dhe për shënimin. | Në klasë ose në repartin e praktikës | -Instrumente matëse (metër, kalibër, mikrometër, komparator, këndmatës dhe manometër. -Instrumente shënimi (pikues, shënues, shkumës). |
| | | -Demonstrim i matjes me kalibër e mikrometër -Praktikim i nxënësve për matje me kalibër e mikrometër | 1 orë | | | |
| | | -Demonstrim i matjes me komparator, këndmatës dhe manometër -Praktikim i nxënësve për matje me komparator, këndmatës dhe manometër | 1 orë | | | |
| | | -Demonstrim i kryerjes së shënimeve me instrumentat shënuese -Praktikim i nxënësve për kryerjen e shënimeve me instrumentat shënuese | 1 orë | | | |

| | | | | | | |
|---|--|---|-------|---|--|---|
| 2 | Nxënësi kryen punime limimi të sipërfaqeve metalike, të brendshme dhe të jashtme. (6 orë) | -Rikujtim i rregullave të përdorimit dhe të kujdesit për limat dhe pajisjet e tjera të limimit. -Shpërndarja e skicave të detaleve për limim | 1 orë | <u>Listë kontrolli</u> për procesin e limimit të sipërfaqeve të rrafshata, të profiluara dhe me kënd, si dhe për rregullat e sigurisë | Në repartin e praktikës së axhusterisë | -Lima të llojeve të ndryshme -Instrumente matëse -Instrumente shënuese -Vegla shtrënguese (morseta) -Skica detalesh për limim |
| | | -Demonstrim i limimit të sipërfaqeve të rrafshata -Praktikim i nxënësve për limim të sipërfaqeve të rrafshata | 1 orë | | | |
| | | -Demonstrim i limimit të sipërfaqeve të profiluara -Praktikim i nxënësve për limim të sipërfaqeve të profiluara | 2 orë | | | |
| | | -Demonstrim i limimit të sipërfaqeve me kënd -Praktikim i nxënësve për limim të sipërfaqeve me kënd | 2 orë | | | |
| 3 | Nxënësi kryen punime të prerjes së copave metalike me vegla dore | | | | | |
| 4 | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |

Udhëzues përmbushjeje për hartimin e Programit të detajuar të lëndës profesionale

Mirela Andoni, IKT

Për të hartuar në nivel shkolle një program të lëndës profesionale, mësuesi përkatës duhet të zbatojë hapat e mëposhtëm:

- **Studimi i programit të lëndës në skeletkurikul:**
 1. orët totale të planifikuara;
 2. synimet e paraqitura në skeletkurikul për lëndën përkatëse;
 3. tematikat e planifikuara;
 4. orët në dispozicion për secilën tematikë;
 5. kompetencat profesionale të nivelit të parë;
 6. përmbajtjet e programeve të tjera të planifikuara në nivelin e parë;

- **Studimi i temës së parë/ të dytë/ etj.....**
 1. analiza e synimeve të planifikuara për tu përmbushur nga nxënësi për temën e parë;
 2. përcaktimi i njohurive dhe aftësive që do të trajtojë mësuesi për temën e parë;
 3. studimi i literaturës, përvojave, etj., në lidhje me temën e parë;
 4. planifikimi i tematikave (çështjeve) të hollësishme që duhet të trajtojë mësuesi për temën e parë;
 5. përcaktimi i afateve kohore për secilën çështje që do të trajtohet;
 6. planifikimi i objektivave për secilën çështje specifike;
 7. përcaktimi i metodave që duhet të përdorë për të arritur objektivat përcaktuara (planifikimi i projekteve, detyrave, veprimtarve praktike që do të përdorë) për secilën çështje, bazuar në kushtet dhe njohuritë e mësuesit;
 8. planifikimi i kushteve mësimore (mediave pedagogjke) për realizimin e mësimit;
 9. përcaktimi i mënyrës së vlerësimit dhe instrumenteve të vlerësimit, për çdo çështje.

- **Zhvillimi i programit të detajuar të lëndës, bazuar në formatin e dhënë;**
 1. renditja e temave dhe orëve përkatëse sipas programit të lëndës në skeletkurikul;
 2. renditja e çështjeve dhe veprimtarive që do të zhvillojë mësuesi për secilën temë;
 3. vendosja e kohës për secilën çështje apo veprimtari;
 4. zhvillimi i objektivave mësimore specifike për secilën çështje apo veprimtari;
 5. renditja e metodave mësimore të nevojshme për të realizimin e objektivave të planifikuara;
 6. shkrimi i instrumenteve të vlerësimit që do të përdoren nga mësuesi për vlerësimin e nxënësit në lidhje me objektivat e përcaktuara.
 7. shkrimi i bazës materiale të nevojshme për realizimin e objektivave të përcaktuara

**Udhëzues përmbushjeje
për hartimin e Planit të mësimdhënies së modulit profesional**

Mirela Andoni, IKT

Për të hartuar në nivel shkolle një plan mësimdhënieje për një modul të praktikës profesionale, mësuesi përkatës duhet të zbatojë hapat e mëposhtëm:

- **Studimi i modulit përkatës në skeletkurikul:**
 1. orët totale të planifikuara;
 2. qëllimi i përgjithshëm i modulit
 3. RM-të e planifikuara;
 4. përmbajtjet e planifikuara për çdo RM;
 5. kompetencat profesionale të nivelit përkatës
 6. përmbajtjet e programeve dhe moduleve të tjera të planifikuara në nivelin përkatës.

- **Studimi i RM së parë/ të dytë/ etj.....**
 1. analiza e përmbajtjeve të planifikuara dhe kriterëve të vlerësimit, për tu përmbushur nga nxënësi për RM 1;
 2. përcaktimi veprimtarive që do të zhvillojë mësuesi/ nxënësi për RM 1;
 3. studimi i literaturës, përvojave, etj., në lidhje me RM 1;
 4. analiza dhe përcaktimi i afateve kohore për secilin RM dhe veprimtari mësimor që do të trajtohet;
 5. planifikimi i vendit dhe i kushteve mësimore (mediave pedagogjke) për realizimin e mësimit;
 6. përcaktimi i mënyrës së vlerësimit dhe i elementeve të instrumentit të vlerësimit.

- **Zhvillimi i planit të mësimdhënies së modulit, bazuar në formatin e dhënë;**
 1. renditja e RM-ve sipas përshkruesit të modulit në skeletkurikul
 2. vendosja e orëve përkatëse për çdo RM;
 3. renditja e veprimtarive mësimore që do të trajtohen për secilin RM;
 4. vendosja e kohës (orëve) për secilën veprimtari mësimor
 5. vendosja e vendit ku do të zbatohet veprimtaria mësimore
 6. vendosja e kushteve mësimore (mediave pedagogjke) për realizimin e veprimtarive mësimore.
 7. vendosja e instrumenteve të vlerësimit dhe e elementeve përkatëse që do të vlerësohen prej tij (për RM-të ose veprimtaritë mësimore).

Zhvillimi i materialeve mesimore per Modulet e praktikes profesionale

Mirela Andoni, IKT

(Shembull)

Më poshtë jepet një shembull i përgatitjes së materialeve të shkruara në mbështetje të trajtimit të një moduli praktik:

Titulli i modulit: Procese përgatitore për përpunimin e miellit për prodhime brumi.

Qëllimi: Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer veprimtari përgatitore për prodhimin e bukës, makaronave, biskotave, si dhe për ambalazhimin e tyre.

RM 1:

RM 2: Nxënësi kryen procese përgatitore për prodhimin e makaronave (15 orë)

Përmbajtja:

- a) Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për prodhimin e makaronave.
- b) Pastrimi i mjedisit dhe pajisjeve sipas vendeve të punës.
- c) Transportimi i lëndës së parë.
- d) Ndërrimi i trafilave.
- e) Mbikëqyrja e ambalazhimit të makaronave.
- f) Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

- Nxënësi duhet të jetë i aftë:
- Të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për prodhimin e makaronave sipas procedurave përkatëse.
- Të pastrojë mjedisin dhe pajisjet e mjetet e punës sipas kërkesave higjeno-sanitare.
- Të transportojë lëndën e parë.
- Të ndërrojë trafilat.
- Të mbikëqyrë ambalazhimin e makaronave.
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Referuar elementeve të përshkruesit të modulit të mësipërm, përgatiten materialet mbështetëse të mëposhtme:

RM 2: Nxënësi kryen procese përgatitore për prodhimin e makaronave (15 orë)

Udhëzime për përmbajtjet e veprimtarive mësimore të kësaj RM-je:

a) Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për prodhimin e makaronave.

- Veshja e uniformës së punës (doreza, kostum, këpucë, kapuç)
- Ajrosja e ambientit ku do të kryhet veprimtaria praktike.

- Mbikëqyrja e kushteve teknike.
- Vendosja e pajisjeve të punës dhe mjeteve ndihmëse në vendet e duhura.
- Vendosja e lëndës së parë në vendin e caktuar.
- Kontrolli i gjendjes fizike të pajisjeve. (sistemi i komandimit dhe kontrollit, dozatorët e miellit, ujit dhe shtesave ushqimore, shneku, trafilat, insertet, pajisja prerëse së bashku me thikat tubat e kalimit të avullit trafilat, insertet, zbutësi i ujit, makineria e paketimit etj)
- Vendosja e detergjenteve në vendin e caktuar.

Instrumenti i vlerësimit: Vëzhgim me listë kontrolli që përmban këto elemente:

- Vish uniformën e punës sipas rregullores së fabrikës së makaronave (doreza, bluzë dhe pantallona të bardha, këpucë, kapuç.)
- Kryej ajrosjen e ambientit ku do të kryhet veprimtaria praktike e prodhimit të makaronave.
- Kontrolllo gatishmërinë e pajisjeve (trafilat, insertet, prerëset me thika në vendin e punës sipas kushteve teknike.
- Vendos pajisjet e punës dhe mjetet ndihmëse në vendet e duhura.
- Vendos lëndën e pare (semolinën) në vëndin e caktuar.
- Kontrolllo gjendjen fizike të pajisjeve. (dozatorët e miellit, ujit dhe shtesave ushqimore, shneku, trafilat, insertet, pajisja prerëse së bashku me thikat tubat e kalimit të avullit , zbutësin e ujit, makinën robot të paketimit, etj.)
- Vendos detergjentet në vendin e caktuar (larg lëndëve të para dhe ndihmëse).

b) Pastrimi i mjedisit dhe pajisjeve sipas vendeve të punës.

- Kontrolli i pastërtisë dhe i higjienës së ambientit (dysHEME, mure, tavane, dritare, dyer dhe porta, kanale shkarkimi të mbetjeve teknologjike).
- Kontrolli i pastërtisë dhe higjienës së pajisjeve (sistemi i panelit elektronik, dozatorët e miellit, ujit dhe shtesave ushqimore, vaskat, helikat e presës, trafilat, insertet, makineria e larjes së trafilave, makina “robot“ e paketimit, etj.)
- Kontrolli i qarqeve për brejtës dhe i vendeve për insekte të ngordhura.
- Plotësimi i kartës ditore mbi numrin e brejtësve dhe insekteve.
- Përgatitja sipas librit të udhëzimit të solucionëve larëse dhe dezinfektuese (p.sh; tretësirë 1-2% NaOH në temperaturën 50-60°C).
- Pastrimi i pjesëve të pajisjeve nga ndotjet e ngurta (koshi ushqyes konik, dozuesi, sitat vibruese, trafilat, insertet, etj.)
- Pastrimi i linjës nga pluhurat me anë të aspirimit
- Pastrimi i impiantit të ujit, lëndës së parë, të shtesave përmirësuese si dhe i të gjithë rrugëve të furnizimit.
- Larja e ambientit me solucione larës dhe ujë të rrjedhshëm.
- Dezinfektimi i ambientit me preparate dezinfektues, në vendet me kontakt brumi dhe mbetje produktesh për të shmangur zhvillimin e mikroorganizmave.
- Larja e pjesëve të pajisjeve me detergjent jo aromatikë pas pastrimit (trafilat, insertet, thikat, etj.).
- Shpëlarja me ujë të rrjedhshëm të pijshëm, deri në asnjësimin e plotë të detergjenteve higjienizues dhe dërgimi i mostrës së ujit të shpëlarjes në laborator, (prova e alkalinitetit)
- Vendosja e mjeteve ndihmëse dhe pjesëve të pajisjeve në gjendje gatishmërie për punë (trafila të lara, inserte të pastra dhe inserte të përdorura për raste defektesh, thika prerëse, etj.).

Instrumenti i vlerësimit: Vëzhgim me listë kontrolli që përmban këto elemente:

- Kontrolllo pastërtinë dhe higjienën e ambientit (dyshe, mure, tavane, dritare, dyer dhe porta, kanale shkarkimi të mbetjeve teknologjike).
- Kontrolllo pastërtinë dhe higjienën e pajisjeve, (sistemin e panelit elektronik, dozatorët e miellit, ujit dhe shtesave ushqimore, vaskat, helikat e presës, trafilat, insertet, makineria e larjes së trafilave, makina “robot“ e paketimit. etj)
- Verifiko qarqet për brejtës dhe vendet për insekte të ngordhura.
- Plotëso kartën ditore mbi numrin e brejtësve dhe insekteve të gjetura.
- Përgatit sipas librit të udhëzimit solucionet larëse dhe dezinfektuese (p.sh; tretësirë 1-2% NaOH në temperaturën 50-60°C).
- Aktivizo sistemin pastrimit (me fryrje ajri ose me dush me presion)për larjen e pjesëve të pajisjeve nga ndotjet e ngurta (koshi ushqyes konik, dozuesi, sitat vibruese, trafilat, insertet, etj.)
- Aktivizo sistemin e aspirimit për pastrimin e linjës nga pluhurat,
- Ndiz pajisjet për pastrimin e impiantit të ujit, te rrugëve të kalimit të lëndës së parë, të shtesave përmirësuese si dhe i të gjithë rrugëve të furnizimit.
- Laj ambientin me solucion larës dhe ujë të rrjedhshëm.
- Dezinfekto ambientin me preparate dezinfektuese, në vendet me kontakt brumi dhe mbetje produktesh për të shmangur zhvillimin e mikroorganizmave.
- Laj pjesët e pajisjeve me detergjent jo aromatikë pas pastrimit. (trafilat, insertet, thikat, etj).
- Ndiz makinerinë për shpëlarjen në formë dushi me ujë të rrjedhshëm të pijshëm, deri në asnjësimin e plotë të detergjenteve higjienizues dhe dërigo mostrën e ujit të shpëlarjes në laborator, (prova e alkalinitetit)
- Vendos në raftet mjetet ndihmëse dhe pjesët e pajisjeve që tashmë janë në gjendje gatishmërie për punë (trafila të lara , inserte të pastra dhe inserte të papërdorura për raste defektesh, thikave prerëse, etj.).

c) Transportimi i lëndës së parë.

- Shkarkimi i thasëve me miell nga mjetet e transportit.
- Verifikimi i llojit të miellit nëpërmjet të dhënave të etiketës.(krahasuar me të dhënat e llojit të miellit të porositur).
- Numërimi i thasëve me miell.
- Vendosja në peshë e thasëve me miell për kontrollin e peshës.
- Heqja nga pesha dhe vendosja e thasëve me miell në vendin e caktuar sipas radhës së furnizimit
- Ngjitja në thasë e etiketës me të dhënat e marrjes në dorëzim: data e pranimit, lloji i produktit, data e prodhimit dhe skadencës, subjekti prodhues, etj.
- Vendosja e thasëve me miell në ambientin e caktuar sipas llojit, cilësisë së produktit, radhës së përdorimit, të dhënave të etiketave dhe datës së pranimit.

Instrumenti i vlerësimit: Vëzhgim me listë kontrolli që përmban këto elemente:

- Shkarko thasët me miell nga mjetet e transportit.
- Lexo etiketën mbi të dhënat e llojit të miellit të ardhur
- Numëro thasët me miell.
- Vendos në peshore thasët me miell për kontrollin e peshës.
- Zhvendos thasët me miell nga peshorja për në vendin e caktuar sipas rradhës së furnizimit

- Ngjit në thasë etiketat me të dhënat e marrjes në dorëzim: data e pranimit, lloji i produktit, data e prodhimit dhe skadencës, subjekti prodhues (te plotësuar nga specialisti) etj.
- Radhit thasët me miell në ambientin e caktuar sipas llojit, cilësisë së produktit, radhës së përdorimit, të dhënave të etiketave dhe datës së pranimit.

d) Ndërrimi i trafilave.

- Ndalimi punës së presës në linjën e makaronave.
- Ndalimi i punës së thikave prerëse.
- Ulja e thikave poshtë me anë të çelësit të komandimit përkatës.
- Nxjerrja e trafilës ekzistuese me anë të çelësit të komandimit përkatës
- Vendosja e trafilës në tavolinën mbajtëse.
- Çmontimi i trafilës nga koka e presës.
- Çmontimi pjesëve të trafilës për pastrim (guarnicioni, rrjeta, disku, kapaku i trafilës.
- Vendosja e trafilës në vaskën e larjes të pajisur me dush)
- Kontrolli i inserteve për shkallën e konsumimit të tyre
- Vrojtimi për dëmtime të jashtme në sipërfaqen e trafilës.
- Zëvendësimi i inserteve të dëmtuara, me të reja.
- Montimi i pjesëve të lara të trafilës (ose marrja e një trafile të larë nga turni paraardhës).
- Vendosja e trafilës në ashensor.
- Vënia në punë e ashensorit, për ngritjen e trafilës deri në pozicionin përballë folesë së saj.
- Kontrolli i temperaturës në folenë e trafilës.
- Vendosja e trafilës në folenë e saj.
- Ngritja e thikave në pozicionin lart me anë të çelësit të komandimit përkatës
- Ndezja e linjës.

Instrumenti i vlerësimit: Vëzhgim me listë kontrolli që përmban këto elemente:

- Ndalo punën e presës në linjën e makaronave.
- Ndalo punën e thikave të presës.
- Uli thikat poshtë me anë të çelësit të komandimit përkatës.
- Çmonto trafilën nga koka e presës.
- Nxirr trafilën ekzistuese nga testata me anë të çelësit të komandimit përkatës
- Vendos trafilën në tavolinën përkatëse.
- Çmonto pjesët e trafilës për pastrim (guarnicioni, rrjeta, disku, kapaku i trafilës).
- Kontrolllo shkallën e konsumimit të inserteve
- Vendos pjesët e trafilës në makinerinë e larjes të pajisur me dush)
- Ndiz makinën e larjes së trafilave, për larjen e tyre.
- Fik makinën e larjes së trafilave (me anë të çelësit përkatës
- Monto pjesët e lara të trafilës (ose merr një trafile të larë nga turni paraardhës).
- Vendos trafilën e larë e të montuar në vëndin e caktuar të raftin përkatës.
- Përzgjidh (në radhën e trafilave të lara në raft) trafilën e pastër dhe me formë sipas formatit të planifikuar për prodhimin e rradhës (për formë të caktuar makaronash)
- Vendos trafilën në ashensor.
- Vër në punë ashensorin, për ngritjen e trafilës deri në pozicionin përballë folesë së saj.
- Kontrolllo temperaturën në folenë e trafilës (40°C).
- Vendos trafilën në folenë e saj

- Vendos thikat në pozicionin lart me anë të çelësit të komandimit përkatës
- Ndiz linjën për aktivizimin e trafilitës së ndërruar në linjën e makaronave.

e) Mbikëqyrja e ambalazhimit të makaronave.

- Leximi i udhëzuesit mbi ambalazhimin dhe rregullat e ambalazhimit (paketim-etiketim-ambalazhim).
- Përgatitja e vendit të punës ku do të kryhet procesi i ambalazhimit të makaronave.
- Vëzhgimi i përzgjedhjes së qeses dhe kartonit special të paketimit (të pajisur me film me veprim anti-mikrobik) dhe ambalazhimit sipas udhëzuesit
- Vëzhgimi i vendosjes së kutive të kartonit pranë pajisjes “robot” të paketimit të makaronave.
- Përgatitja e aparatit të automatizuar të paketimit për vendosjen e qeses (gradimi i dozatorit për dozimin e makaronave, i temperaturës, i gjerësisë dhe gjatësisë së qeses dhe vendosja e pozicionit të ngjitjes) si dhe përgatitja e kutive të kartonit.
- Ndezja e aparatit të paketimit.
- Prova boshe e punës së aparatit.
- Përzgjedhja e pakove të padëmtuara.
- Rreshtimi me kujdes i pakove të makaronave në kutitë e kartonit.
- Vëzhgimi i vendosjes së kutive të ambalazhit në paleta në lartësi të caktuar.
- Vëzhgimi i vendosjes së ambalazheve të mbyllura në vende të caktuara në magazinë. (sipas datës së prodhimit dhe cilësisë, në vende të caktuara sipas radhës së qarkullimit).
- Vëzhgimi i lënies së hapësirave të caktuara sipas kartës teknologjike të ruajtjes së produktit që mbahet në ruajtje.

Instrumenti i vlerësimit: Vëzhgim me listë kontrolli që përmban këto elemente:

- Lexo udhëzuesin mbi ambalazhimin dhe rregullat e ambalazhimit (paketim-etiketim-ambalazhim).
- Përgatit vendin e punës ku do të kryhet procesi i ambalazhimit të makaronave.
- Vëzhgo përzgjedhjen e qeses dhe kartonit special të paketimit (të pajisur me film me veprim anti-mikrobik) dhe ambalazhimit sipas udhëzuesit
- Vendos kutitë e kartonit pranë pajisjes “robot” të paketimit të makaronave.
- Vendos qesen e paketimit (gradimi i dozatorit për dozimin e makaronave, i temperaturës, i gjerësisë dhe gjatësisë së qeses dhe vendosja e pozicionit të ngjitjes) si dhe përgatitja e kutive të kartonit.
- Ndiz aparatit e paketimit.
- Kryej provën boshe të punës së aparatit.
- Përzgjidh pakot e padëmtuara.
- Rreshto me kujdes pakot e makaronave në kutitë e kartonit.
- Vëzhgo vendosjen e kutive të ambalazhit në paleta në lartësi të caktuar.
- Vendos ambalazhet e mbyllura në vende të caktuara në magazine (sipas datës së prodhimit dhe cilësisë, në vende të caktuara sipas radhës së qarkullimit).
- Vëzhgo vendosjen e makaronave të ambalazuara (vëzhgo lënien e hapësirave të caktuara sipas kartës teknologjike të ruajtjes së produktit që mbahet në ruajtje).

f) Zbatimi rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

- Leximi i udhëzuesit mbi rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në repartet e prodhimit të makaronave.

- Paraqitja në repart me librezën shëndetësore.
- Veshja e uniformës, dorezave, këpucëve, kapuçit.
- Leximi i detyrave për secilin punëtorë në raste zjarri.
- Verifikimi i pajisjeve në çdo repart me mjetet e shuarjes së zjarrit.
- Kontrolli i instalimeve elektrike (tela të zhveshur, të varur, priza të dëmtuara etj.).
- Kontrolli pamor i pllakave (për dëmtime të mundshme),mureve, kanaleve, etj.
- Mbulimi i pjesëve të lëvizshme dhe i makinerive

Instrumenti i vlerësimit: Vëzhgim me listë kontrolli që përmban këto elemente:

- Lexo udhëzuesit mbi rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në repartet e prodhimit të makaronave.
- Paraqitu në repart me librezën shëndetësore.
- Vish uniformën, dorezat, këpucët dhe kapuçin.
- Lexo detyrat për secilin punëtor në raste zjarri.
- Verifiko pajisjet në çdo repart me mjetet e shuarjes së zjarrit.
- Kontrolllo instalimet elektrike (tela të zhveshur, të varur, priza të dëmtuara etj.).
- Bëj kontrollin pamor të pllakave (për dëmtime të mundshme), mureve, kanaleve, etj.
- Mbulo pjesët e lëvizshme dhe makineritë.